

20180821465

## LIGJ PËR ARSIMIN E LARTË\*

### Kapitulli i parë

#### DISPOZITAT THEMELORE

#### Lënda e rregullimit

##### Neni 1

Me këtë ligj rregullohen autonomia e universitetit dhe liria akademike, kushtet dhe procedura për themelim, ndryshimet e statusit dhe shuarja e institucioneve të arsimit të lartë, veprimtaria e tyre, sistemi për sigurim dhe vlerësim të cilësisë së arsimit të lartë, bazat për organizim, menaxhim, zhvillim dhe financim të veprimtarisë së arsimit të lartë, të drejtat dhe obligimet e studentëve, njohja e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë dhe mbikëqyrja e punës së institucioneve të arsimit të lartë.

#### Lista e nocioneve

##### Neni 2

(1) Shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:

1. "Autonomia e universitetit dhe e institucioneve tjera të arsimit të lartë" përfshin liri akademike, vendimmarrje të mëvetësishme dhe menaxhim dhe pacenueshmëri të hapësirës universitare;

2. "Akreditimi i projektit për themelimin e institucionit të arsimit të lartë" është miratimi i aktvendimit nga Bordi për akreditim të arsimit të lartë me të cilin pranohet, përkatësisht jepet mendim për projektin në të cilin janë përfshirë dhe arsyetuar kushtet për themelimin e institucionit të arsimit të lartë;

3. "Akredimi i programit studimor" është miratim i aktvendimit nga Bordi për akreditim të arsimit të lartë me të cilin aprovohet realizimi i programit studimor të institucionit të arsimit të lartë në pajtim me ligjin;

4. "Arsimi i lartë" është arsim i cili realizohet përmes programeve studimore të universiteteve dhe shkollave të larta të mëvetësishme profesionale;

5. "Kualifikimi i arsimit të lartë" është rezultat formal nga procesi i vlerësimit dhe vërtetimit se janë arritur rezultate nga mësimi në pajtim me standardet e përcaktuara pas programit të përfunduar studimor të ciklit të parë, të dytë ose të tretë të arsimit të lartë, të fituar në institucionin e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë ose në vend tjetër, që është akredituar dhe ka leje për kryerje të veprimtarisë së arsimit të lartë;

6. "Dokumenti për program pjesërisht të mbaruar studimor" është certifikatë ose dokument tjetër për kredi të marra studimore, vite të mbaruara, semestra, provime, module, pjesë të programit studimor, përkatësisht për obligime të mbaruara për program studimor për fitim të arsimit të lartë, që e lëshon institucioni i arsimit të lartë sipas rregullave të shtetit përkatës;

---

\* Me këtë ligj bëhet harmonizimi me direktivat evropiane në sferën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, që e rregullojnë kohëzgjatjen minimale të studimeve të arsimit të lartë për profesione të sektorëve në Bashkimin Evropian si vijon: 1. DIREKTIVA 2005/36/EC TË PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT nga 7 shtatori 2005 për njohjen e kualifikimeve profesionale CELEX numër 32005L0036; 2. DIREKTIVA 2013/55/BE TË PARLAMENTIT EVROPIAN DHE TË KËSHILLIT nga 20 nëntori 2013 ndryshim i DIREKTIVËS 2005/36/EC TË PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT nga 7 shtatori 2005 për njohjen e kualifikimeve profesionale CELEX numër 32013L055.

7. "Diploma" është dokument publik i lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë me të cilin dëshmohet arsimit të lartë i fituar i ciklit të parë, të dytë ose të tretë, nevojitet për vazhdimin e arsimit ose për fillimin e kryerjes së profesionit përkatës;

8. "Shtojcë e diplomës (Diploma Supplement)" është pjesë përbërëse e diplomës që përmban të dhëna për poseduesin e diplomës, informata që e caktojnë kualifikimin më afërsisht, nivelin e kualifikimit (emërtimin profesional, përkatësisht shkencor) sistemin dhe përmbajtjen e studimeve dhe rezultatet e arritura, si dhe të dhënat për mundësitë akademike dhe profesionale të cilat i jep kualifikimi për studime të mëtutjeshme dhe status profesional, informata plotësuese sipas natyrës së programit studimor dhe burimin e tyre, datën dhe nënshkrimin dhe informata për sistemin nacional të arsimit të lartë;

9. "Mësimi i përjetoshëm (Lifelong Learning)" është formë e mësimit të vazhdueshëm gjatë gjithë jetës për përsosje, plotësim, thellim dhe modernizim të dijes;

10. "Evaluimi" është vlerësim i cilësisë së arsimit të lartë që përfshin procedura për vlerësim të cilësisë në institucionet për arsim të lartë, të kuadrit akademik dhe të programeve të tyre studimore sipas procedurave dhe standardeve të pranuar dhe udhërrëfyesit (drejtimeve) për sigurim të cilësisë të miratuara nga institucionet evropiane për sigurim të cilësisë në arsimin e lartë dhe organizatat dhe asociacionet tjera që kanë rol për t'i vendosur dhe zbatuar standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurim të cilësisë së hapësirës evropiane për arsim të lartë;

11. "Njësia e universitetit" është fakultet, akademi e arteve dhe shkollë e lartë profesionale si institucion i arsimit të lartë në përbërje të universitetit, me të drejta dhe detyrime të përcaktuara me këtë ligj dhe statutin e universitetit. Njësi të universitetit janë edhe institutet shkencore me të drejta dhe obligime të përcaktuara me Ligjin për veprimtari shkencore-hulumtuese, këtë ligj dhe statutin e universitetit;

12. "Diplomë e përbashkët (Joint Degree)" është diploma e cila fitohet me mbarimin e programit studimor që bashkërisht e pranojnë dhe e realizojnë dy ose më shumë universitete në vend ose universiteti nga vendi dhe institucioni i akredituar i arsimit të lartë nga vendi i huaj, përkatësisht njësia e tij e akredituar dhe e regjistruar në Republikën e Maqedonisë, sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj;

13. „Sistemi kreditor" është sistem për akumulimin dhe transferin e kredive në bazë të transparencës së rezultateve nga mësimi dhe proceset e mësimit në arsimin e lartë;

14. "Sistem për transfer të kredive" është procedurë e përbashkët që vendoset sipas Sistemit evropian për transfer të kredive - SETK ose Sistemit evropian të bartjes dhe akumulimit të pikëve (anglisht": European Credit Transfer and Accumulation System) dhe paraqet sistem numerik për vlerësim cilësor të punës së studentëve që është investuar për marrje të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave që janë paraparë me programin për studim, përkatësisht me lëndën konkrete në kuadër të atij programi, i përfshin pikët për zotërim të lëndës në tërësi, të gjitha lëndët në një semestër, vitin akademik dhe studimin e plotë dhe bartjen e tyre nga një institucion në institucion tjetër të arsimit të lartë;

15. "Kredi" është masa kuantitative për shprehje të vëllimit të mësimit në bazë të vëllimit të punës të cilën studenti mesatarisht e kryen, përkatësisht ngarkimi i studentit në të cilin llogariten ligjëratat, seminarët, ushtrimet, format tjera të punës së organizuar studimore dhe mësimi i mëvetësishëm me qëllim të arritjes së rezultateve të pritura nga procesi i mësimit. Kredia i ndahet studentit dhe regjistrohet në dosje të tij kur do ta përmbushë obligimin studimor;

16. "Klasifikimi ndërkombëtar i Fraskatit" është klasifikim i fushave shkencore-hulumtuese në dy nivele (niveli i parë dhe i dytë) i Organizatës për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik (OECD), të përfshirë në Doracakun e Fraskatit nga viti 2015;

17. "Korniza nazionale e kualifikimeve" është standard i detyrueshëm nacional me të cilin rregullohet marrja dhe shfrytëzimi i kualifikimeve në Republikën e Maqedonisë dhe instrumentit për vendosjen e sistemit të kualifikimeve të arritura në Republikën e Maqedonisë me të cilat jepen bazat për qartësi, qasje, kalueshmëri, arritje dhe cilësi të kualifikimeve, të rregulluar me Ligjin për kornizën nationale të kualifikimeve.

18. "Mësimi joformal" janë aktivitete të organizuara dhe programe për mësim dhe aftësim, që nuk janë pjesë e programeve studimore për marrje të arsimit të lartë me qëllim të avancimit të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave për nevoja shoqërore dhe profesionale dhe për të cilat nuk lëshohet diplomë;

19. "Participimi" është shuma e mjeteve monetare që e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë, që paguhet nga studentët e regjistruar në institucionin publik të arsimit të lartë, arsimit të cilëve financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë;

20. "Anëtari shoqëruar i universitetit" është institucioni veprimtaria themelore e të cilit është funksionalisht e lidhur me veprimtarinë e arsimit të lartë;

21. "Veprimtari aplikative" është aplikimi i rezultateve shkencore, njohurisë profesionale dhe kryerja e punëve tjera të larta profesionale të mësimdhënësve, punëtorëve shkencorë dhe bashkëpunëtorëve nga sfera shkencore, artistike dhe profesionale për të cilin është akredituar institucioni i arsimit të lartë;

22. "Institucioni i arsimit të lartë privat-publik joprofitabil " është institucion i arsimit të lartë i themeluar nga fondacioni joprofitabil me mjete publike nga burime të huaja dhe vendore që realizon interes publik. Mjetet e fituara në këtë institucion shfrytëzohen vetëm dhe ekskluzivisht për kryerje të veprimtarisë së arsimit të lartë. Ky institucion nuk krijon dhe nuk ndan profit.

23. „Rezultatet nga mësimi" janë deklarata për atë se çfarë di, çfarë kupton dhe për çfarë është i aftësuar të bëjë studenti, si rezultat i procesit të mësimit;

24. "Publikimi shkencor referent", në kuptim të këtij ligji është:

(a) revistë shkencore në të cilën punimet të cilat publikohen i nënshtrohen recensionit dhe e cila është indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime e qasshme në internet, si Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër të revistave të cilën do ta përcaktojë Këshilli Nacional për Arsim të Lartë ose

b) revistë shkencore në të cilën punime të cilat publikohen i nënshtrohen recensionit dhe e cila ka bord redaktues ndërkombëtar, në të cilin marrin pjesë anëtarë nga të paktën tre vende me ç'rast numri i anëtarëve të një vendi nuk mund të tejkalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve ose

v) revistë shkencore në të cilën punimet të cilat publikohen i nënshtrohen recensionit dhe e cila publikohet në vend anëtar të Bashkimit Evropian dhe/ose OECD ose

g) libër ose pjesë e librit me recension i publikuar në vend anëtar të Bashkimit Evropian dhe / ose OECD ose

d) përmbledhje e punimeve shkencore të recensuara të prezantuara në tubime akademike ndërkombëtare ku anëtarët e komitetit programor ose shkencor janë nga të paktën tre vende ose

gj) përkthime të veprave kapitale në fusha të cilat i përcakton Këshilli nacional për arsim të lartë dhe veprimtari kërkimore-shkencore.

25. "Institucion i pavarur i arsimit të lartë" është universitet ose shkollë profesionale e lartë e l]pavarur;

26. "Program studimor" është përmbledhje e komponentëve mësimorë nga një ose më tepër sfera studimore, të bazuara mbi rezultatet e mësimit, të cilat pranohen për ndarjen e kualifikimit konkret, e cila i jep mundësi personit i cili e ka kryer të njëjtën të kryejë ndonjë veprimtari profesionale ose t'i vazhdojë studimet;

27. "Sfera studimore" është një nga sferat e përkufizuara në Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Arsimit të UNESCO (MSKOB, ISCED);

28. "Doracaku i Fraskatit" është Doracak me udhëzime për grumbullimin dhe publikimin e të dhënave për hulumtime dhe zhvillim eksperimental të Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD) të vitit 2015,

29. "Ciklet e arsimit të lartë" janë tre cikle të njëpasnjëshme të arsimit të lartë të identifikuara me procesin e Bolonjës ( i pari - studimet universitare, i dyti - studimet pasuniversitare dhe cikli i tretë studimet e doktoraturës) në të cilat janë shpërndarë të gjitha kualifikimet e arsimit të lartë të cilat arrihen në hapësirën e vetme evropiane të arsimit të lartë dhe

30. "Taksa shkollore" është shuma e mjeteve monetare për mbulimin e shpenzimeve për studim të cilin studenti, arsimit të lartë nuk financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, ka obligim t'ia paguajë institucionit të arsimit të lartë privat ose publik.

### **Parimet themelore të arsimit të lartë**

#### **Neni 3**

(1) Veprimtaria e arsimit të lartë është me interes publik dhe ka rëndësi të veçantë për Republikën e Maqedonisë si pjesë e hapësirës ndërkombëtare dhe të hapësirës së vetme evropiane arsimore, shkencore dhe artistike.

(2) Veprimtaria e arsimit të lartë bazohet në parimet në vijim:

1. Autonomi dhe liri akademike;
2. Unitet në mësim dhe në punën shkencore-hulumtuese respektivisht punën artistike;
3. Transparenca ndaj publikut dhe qytetarëve;
4. Respektimi i vlerave humaniste dhe demokratike të traditës nacionale dhe evropiane dhe vlerave të trashëgimisë kulturore;
5. Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe garantimi i parimit të barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi;
6. Avancimi i mobilitetit akademik të kuadrit mësimorë dhe studentëve;
7. Pjesëmarrje e studentëve në menaxhimin dhe vendimmarrjen, veçanërisht në lidhje me çështjet që janë të rëndësishme për kualitetin e mësimin dhe standardin e studentëve;
8. Synimi drejt dijes universale imperativ i të cilës është shkenca, liria dhe e vërteta;
9. Sigurimi i sistemit për mësim të përjetshëm dhe
10. Sigurimi i kualitetit dhe efikasitetit të studimit.

### **Qëllimet e arsimit të lartë**

#### **Neni 4**

(1) Qëllimet e arsimit të lartë janë:

1. ngritje e nivelit të përgjithshëm arsimor dhe shkencor-hulumtues, si dhe niveli i krijimit artistik në Republikën e Maqedonisë;
2. krijim, mbrojtje dhe transmetim i njohurive shkencore, profesionale dhe artistike dhe shkathtësive;
3. zhvillim i shkencës, nxitje e zhvillimit teknologjik dhe përparim i krijimtarisë artistike dhe zbatim i njohurive shkencore në zhvillimin e shoqërisë;
4. Sigurim i brezit të ri shkencor, profesional dhe artistik;
5. mundësimi që çdo individ në kushte të barabarta të fitojë arsim të lartë dhe të arsimohet gjatë gjithë jetës;
6. zhvillimi i personaliteteve të lira, kritike dhe kreative;
7. përforcimi i punësimit, kompetitivitetit dhe konkurrencës së të rinjve dhe të moshuarve;

8. zhvillimi i përgjegjësisë civile të bashkësia akademike.

(2) Qëllimet e arsimit të lartë realizohen përmes:

1. organizimit të studimeve sipas programeve të akredituara studimore;
2. realizimit të kërkimeve fundamentale, zhvillimore dhe aplikative dhe kryerjes së veprimtarisë aplikative dhe krijimtarisë artistike;
3. mbrojtjes së autonomisë së universitetit dhe lirisë akademike;
4. përmirësimit të vazhdueshëm të kualitetit dhe relevantës së mësimit dhe të mësuarit;
5. sigurimit të mbështetjes së mjaftueshme dhe të qëndrueshme financiare për zhvillim të sigurt dhe pa pengesa të procesit arsimor, shkencor-hulumtues dhe artistik;
6. procesit demokratik inkluziv i vendosjes i cili pamundëson përqendrimin e fuqisë;
7. respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe garantimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit;
8. sigurimi i pjesëmarrjes së studentëve në menaxhim dhe vendimmarrje;
9. mundësimin dhe promovimin të mobilitetit të anëtarëve të bashkësisë akademike të institucioneve të huaja të arsimit të lartë dhe zhvillimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me institucione të arsimit të lartë;
10. zhvillimi i bashkëpunimit shkencor ndërkombëtar;
11. afirmimi i konkurrencës në arsim dhe hulumtimet shkencore;
12. pjesëmarrjes në planifikim, përcaktimin e zhvillimit të sistemit të përgjithshëm arsimor;
13. rritja e kapitalit intelektual në Republikën e Maqedonisë;
14. promovimit të përgjegjësisë nacionale dhe globale dhe
15. realizimit të konceptit të mësimit të përjetshëm.

### **Bashkësia akademike**

#### Neni 5

(1) Bashkësinë akademike e përbëjnë personat e përzgjedhur në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë, mësimorë-profesionalë dhe tituj bashkëpunëtorë dhe studentët.

(2) Profesorët e rregullt mbeten anëtarë të bashkësisë akademike edhe pas pensionimit të tyre.

### **Qasshmëria në arsimin e lartë**

#### Neni 6

(1) Qytetarët e Republikës së Maqedonisë kanë në kushte të barabarta të drejtën e arsimit në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë.

(2) Shtetasit e huaj munden, duke zbatuar parimin e reciprocitetit, mund të arsimohen në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë nën kushte të barabarta si shtetasit e Republikës së Maqedonisë.

(3) Shtetasit e huaj, pa zbatuar parimin e reciprocitetit, mund të arsimohen në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë, në kushtet të cilat i përcakton më afër institucioni i arsimit të lartë.

(4) Qytetarët pa shtetësi kanë të drejtën e arsimit të lartë me kushte të barabarta si edhe shtetasit e Republikës së Maqedonisë.

#### Kapitulli i dytë

### **AUTONOMIA E UNIVERSITETIT DHE INSTITUCIONET TJERA TË ARSIMIT TË LARTË**

#### **Përmbajtja dhe mbrojtja e autonomisë**

#### Neni 7

(1) Arsimi i lartë në Republikën e Maqedonisë bazohet në autonominë, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe me këtë ligj.

(2) Institucionet e arsimit të lartë e kryejnë veprimtarinë e tyre mbi parimin e autonomisë akademike.

(3) Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë përfshin edhe përgjegjësinë e anëtarëve të bashkësisë akademike ndaj komunitetit shoqëror në të cilin veprojnë.

(4) Autonomia akademike garanton lirinë intelektuale të anëtarëve të bashkësisë akademike dhe natyrën krijuese të procesit kërkimor dhe edukativ, si vlera dhe aftësi të nivelit të lartë.

(5) Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë përfshin lirinë akademike, autonominë e menaxhimit, moscenueshmërinë e hapësirës, autonominë financiare, autonominë kadrovike dhe paprekshmërinë e autonomisë.

(6) Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë gëzon mbrojtje gjyqësore dhe institucioni i arsimit të lartë ka të drejtë të ngrejë procedurë në gjykatën kompetente në rast të shkeljes së saj.

### **Liria akademike**

#### **Neni 8**

(1) Liria akademike u takon të gjithë anëtarëve të bashkësisë akademike dhe përfshin:

1. lirinë e shprehjes, ruajtjen dhe nxitjen e mendimit kritik dhe vetëdijes te anëtarët e bashkësisë akademike;

2. liri në punën shkencore hulumtuese, në krijimin artistik, në zbatimin dhe ndërmjetësimin e njohurive;

3. rregullim i mëvetësishëm i organizimit të brendshëm dhe punimi me statut, i miratuar në përputhje me ligjin;

4. liria e realizimit të mësimi, zbatimi i hetimeve shkencore, veprimtaria artistike, respektivisht krijimtaria dhe veprimtaria aplikative, duke përfshirë lirinë e shpalljes dhe paraqitjen publike të rezultateve shkencore dhe arritjeve artistike;

5. liria e studimit, përcaktimi i rregullave të studimit, format dhe llojet e veprimtarive mësimore-arsimore dhe të kontrollit të njohurive të studentëve;

6. liria për të zgjedhur programet e studimit, në përcaktimin e përmbajtjes dhe të raportit të lëndëve mësimore të detyrueshme dhe zgjedhore, përmbajtjen e lëndëve mësimore dhe përgatitjen dhe përzgjedhjen e librave shkollorë dhe veglave tjera ndihmëse mësimore;

7. liria për të zgjedhur metodën e interpretimit të përmbajtjeve mësimore;

8. përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për studimet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, si dhe llojet e tjera të arsimit;

9. përgatitja, miratimi dhe realizimi i programeve shkencore-mësimore dhe projekteve artistike dhe punës aplikative;

10. dhënia e titujve profesionalë, akademikë dhe shkencorë në pajtim me ligjin, si dhe dhënia e titujve akademikë të nderit;

11. përcaktimi i kushteve të veçanta dhe procedura për përzgjedhje në tituj shkencorë mësimorë, mësimorë-profesionalë, mësimorë dhe bashkëpunëtorë dhe

12. përzgjedhje në tituj shkencorë mësimorë, mësimorë-profesionalë, mësimorë dhe bashkëpunëtorë.

### **Autonomia e menaxhimit**

#### **Neni 9**

Autonomia në menaxhimin me institucionet e arsimit të lartë shprehet në:

1. planifikimin, realizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së arsimit të lartë;

2. vendosja dhe rregullimi i organizimit të brendshëm;

3. miratimi i statutit dhe akteve tjera të përgjithshme të institucioneve të arsimit të lartë;

4. zgjedhja, emërimi dhe revokimi i organeve në pajtim me ligjin, statutin dhe aktet tjera të përgjithshme;
5. menaxhimi dhe shfrytëzimi i pronës në pajtim me dedikimin për të cilin është marrë;
6. vendosja për format e bashkëpunimit me organizatat tjera;
7. bashkimi në organizata dhe forume adekuate në vend dhe jashtë vendit;
8. realizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, lidhja e marrëveshjeve dhe pjesëmarrja në organizatat dhe asociacionet ndërkombëtare dhe
9. vendosja për çështje tjera të përcaktuara me ligj, statut dhe akte tjera të përgjithshme.

### **Autonomia financiare**

#### Neni 10

(1) Institucionet publike të arsimit të lartë disponojnë në mënyrë të pavarur me fondet e marra nga participimi i studentëve dhe / ose taksa shkollore e studentëve, si dhe me të ardhurat tjera personale.

(2) Disponimi me mjetet nga paragrafi (1) i këtij neni rregullohet me akt të përgjithshëm të institucionit publik të arsimit të lartë dhe / ose të njësisë së institucionit të arsimit të lartë.

(3) Institucionet private të arsimit të lartë disponojnë në mënyrë të pavarur me të ardhurat personale në mënyrën e përcaktuar me statutin e institucioneve të arsimit të lartë.

(4) Institucionet e arsimit të lartë mund të krijojnë fonde dhe të krijojnë forma të tjera të organizimit të të ardhurave personale, nga donacionet dhe burimet e tjera me qëllim të kryerjes së veprimtarisë shkencore-hulumtuese, artistike, botuese dhe aplikative.

(5) Institucionet e arsimit të lartë vendosin në mënyrë të pavarur për akumulimin e mjeteve financiare.

### **Autonomia kadrovike**

#### Neni 11

(1) Institucionet e arsimit të lartë janë autonome në vendosjen e nevojës për punësim ose angazhimin e personave në tituj shkencorë mësues, mësues-profesionalë, shkencorë, mësues dhe bashkëpunëtorë, në përzgjedhjen e personave dhe përcaktimin e kushteve për punësim dhe angazhim në përputhje me ligjin.

### **Pacenueshmëria e hapësirës akademike**

#### Neni 12

(1) Hapësira e institucioneve të arsimit të lartë është e pacenueshme.

(2) Policia dhe organet tjera të sigurisë shtetërore nuk mundën pa pëlqimin e rektorit, dekanit respektivisht drejtorit ose të personit të autorizuar prej tyre, të hyjnë në këtë hapësirë, përveç për pengim të kryerjes së veprës penale që i paraprinë drejtpërdrejt ose të veprës penale, për mbajtjen e kryerësit të saj, si dhe në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

(3) Veprimet e organeve të ndjekjes që ndërmerren me vendim gjyqësor mund të zbatohen vetëm në prani të personit të autorizuar të institucionit të arsimit të lartë.

### **Pacenueshmëria e autonomisë**

#### Neni 13

(1) Autonomia e institucionit të arsimit të lartë nuk mund të priset me:

- pjesëmarrje të pathirrur në institucionin e arsimit të lartë dhe

- kryerjes së veprimtarisë së arsimit të lartë dhe veprimtarisë tjetër që i rrezikojnë të drejtat e anëtarëve të bashkësisë akademike.

(2) Në institucionet e arsimit të lartë ndalohet organizimi partiak dhe veprimi, si dhe shfaqja e shenjave partiake.

(3) Në institucionet e arsimit të lartë ndalohet organizimi dhe veprimi fetar, si dhe shfaqja e shenjave fetare, përveç në institucionet e arsimit të lartë të bashkësive fetare të themeluara me ligj.

(4) Autonomia nuk guxon të interpretohet në mënyrë që përfshin shkelje të të drejtave të njeriut.

### **Zgjidhja e qetë e kontesteve**

#### **Neni 14**

(1) Kontestet midis anëtarëve të bashkësisë akademike, si dhe kontestet ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe njësisë të tyre zgjidhen me marrëveshje, në organe të përbashkëta dhe në mënyrë tjetër të mirëkuptimit.

(2) Gjatë zgjidhjes së kontesteve nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të pengohet zhvillimi i rregullt i veprimtarisë së përcaktuar me statut.

(3) Nëse kontesti nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të zgjidhet në ndonjërin nga mënyrat e parashikuara në paragrafin (1) të këtij neni, kontesti zgjidhet në mënyrë gjyqësore.

#### **Kapitulli i tretë**

### **INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE VEPRIMTARIA E TYRE**

#### **Llojet e institucioneve të arsimit të lartë**

#### **Neni 15**

(1) Veprimtarinë e arsimit të lartë e kryejnë institucionet e arsimit të lartë si në vijim:

1. universiteti;
2. fakulteti, akademia e arteve dhe shkolla e lartë profesionale që janë pjesë e universitetit (në tekstin e mëtejshëm: njësiti e universitetit) dhe
3. shkolla e pavarur e lartë profesionale.

(2) Universiteti dhe shkolla e pavarur e lartë profesionale janë institucione të pavarura të arsimit të lartë.

(3) Institucionet e arsimit të lartë mund të jenë publike, institucione private publike jofitimprurëse dhe institucione private jofitimprurëse.

(4) Me emërtimin universitet, fakultet, akademi e artit, shkollë e lartë profesionale ose shkollë e pavarur e lartë profesionale mund të punojnë vetëm institucionet e arsimit të lartë që janë themeluar në pajtim me këtë ligj.

(5) Universiteti dhe Shkolla e e lartë e pavarur profesionale kanë cilësinë e personit juridik.

(6) Njësiti e universitetit kanë të drejta dhe detyrime të përcaktuara me këtë ligj, me aktin e themelimit të universitetit dhe me statutin e universitetit.

(7) Njësiti e universitetit mund të kenë cilësinë e personit juridik nëse përcaktohet me statutin e universitetit në të cilën përbërje janë themeluar sipas statutit të tyre.

(8) Njësiti universitare që nuk kanë cilësinë e personit juridik duhet të veprojnë në qarkullim juridik nën emërtimin e universitetit në përbërje të të cilit dhe nën emërtimin e vet, sipas autorizimeve të përcaktuara në statutin e universitetit.



(9) Njësitë e universitetit që kanë cilësinë e personit juridik paraqiten në qarkullimin juridik me emërtimin e universitetit në përbërjen e të cilit janë dhe nën emërtimin e vet, në emër të tyre dhe për llogari të tyre me të drejta dhe detyrime të përcaktuara me ligj, statutin e universitetit dhe me statutin e tyre.

(10) Njësitë e universitetit, të cilat kanë cilësinë e personit juridik, nuk mund ta realizojnë këtë në kundërshtim me këtë ligj dhe me interesat e universitetit në përbërjen e të cilit janë themeluar.

(11) Njësitë e universiteteve publike që kanë cilësinë e personit juridik kanë llogari nëpërmjet të cilës disponojnë me mjete buxhetore, si dhe një ose më shumë llogari të veçanta përmes të cilave ata disponojnë lirshëm me mjetet e fituara nga burime të tjera. Me statut apo akt tjetër të përgjithshëm të universitetit publik nuk mund t'u kufizohet liria njësive për të disponuar me mjetet e llogarive të veçanta.

(12) Njësitë e universiteteve publike që nuk kanë cilësinë e personit juridik mund të kenë llogari nëpërmjet të cilës disponojnë me mjetet buxhetore, si dhe një ose më shumë llogari të veçanta përmes të cilave disponojnë lirshëm me mjetet e fituara nga burime të tjera.

(13) Njësitë e universiteteve që kanë një ose më shumë llogari të veçanta marrin pjesë në financimin e veprimtarive me interes të përbashkët të universitetit, në përputhje me statutin e universitetit. Njësitë organizative në përbërje të universitetit mund të kenë të drejta të caktuara në qarkullimin juridik edhe në aspektin e menaxhimit dhe udhëheqjes, në vëllim dhe kushte të përcaktuara nga themeluesi.

Për obligimet e njësive organizative përgjigjet në mënyrë të pakufizuar universiteti që i ka themeluar.

(14) Në përbërje të universitetit mund të ketë edhe anëtarë shoqërues. Kushtet e pranimit dhe të drejtat dhe obligimet e anëtarëve shoqërues rregullohen me ligj dhe / ose me statutin e universitetit.

(15) Në përbërje të universitetit mund të ketë edhe institucione shkencore, si njësi ose si anëtarë shoqërues të universitetit.

### **Statuti i institucionit të arsimit të lartë**

#### **Neni 16**

(1) Akti themelor i institucionit të arsimit të lartë është statuti.

(2) Me statutin rregullon më afërsisht organizimi i brendshëm, mënyra e kryerjes së veprimtarisë së arsimit të lartë, autorizimet dhe mënyra e punës dhe vendimmarrja si dhe çështje të tjera me rëndësi për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë.

(3) Për statutin e universitetit publik dhe shkollave të larta të pavarura profesionale pëlqim jep Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, ndërsa për institucionin privat të arsimit të lartë themeluesi, me pëlqim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

### **Vula, shenjat dhe karakteristika tjera të institucionit të arsimit të lartë**

#### **Neni 17**

(1) Universiteti, respektivisht shkolla e pavarur e lartë profesionale ka vulë.

(2) Vula përmban emërtimin dhe selinë e universitetit, respektivisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

(3) Vula e njësisë universitare, përveç emërtimit të vet, detyrimisht e përmban edhe emrin e universitetit në përbërje të të cilit është.

(4) Në vulën e çdo institucioni të arsimit të lartë përfshihet emri i Republikës së Maqedonisë dhe emërtimi i institucionit të arsimit të lartë.

(5) Në mes të vulës së institucioneve të arsimit të lartë është edhe stema e Republikës së Maqedonisë.

(6) Forma dhe përmbajtja e vulës, si dhe pamja e shenjave dhe karakteristikave të tjera dhe mënyra e shfrytëzimit të tyre, përcaktohet me statutin e institucionit të arsimit të lartë.

## **Universiteti**

### **Neni 18**

Universiteti është një institucion i pavarur i arsimit të lartë i cili siguron unitet në punën dhe zhvillimin e arsimit të lartë, shkencës, artit dhe profesionizmit dhe drejtpërdrejtë dhe përmes njësive të veta nga fusha të ndryshme të studimit, përcjell njohuri për shumë fusha shkencore, përkatësisht artistike dhe disiplina.

## **Veprimtaria e universitetit**

### **Neni 19**

(1) Veprimtaria kryesore e Universitetit është të arsimojë studentë dhe ta zhvillojë shkencën dhe artin.

(2) Universiteti i integron funksionet e njësive të veta (integrimi funksional) dhe me organet e veta e siguron veprimin e tyre të harmonizuar përmes:

1. realizimit të zhvillimit të vetëm strategjik,
2. miratimit të standardeve, normativave dhe rregullave për organizimin dhe kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë, shkencore-hulumtuese dhe artistike,
3. realizimit të Sistemit evropian për transfer të kredive (SETK),
4. realizimit të veprimtarisë aplikative dhe të lartë profesionale,
5. veprimit të harmonizuar në sektorin financiar, në investime dhe në planet zhvillimore,
6. profilimit të kërkimeve shkencore dhe krijimtarisë artistike dhe mbështetjen e tyre financiare,
7. përcaktimit të kushteve të posaçme për zgjedhje dhe për avancim në tituj shkencorë mësimorë, mësimorë profesionalë, mësimorë bashkëpunëtorë,
8. bashkëpunimit me universitetet në vend dhe jashtë vendit,
9. udhëheqjes së politikëse për mobilitet të studentëve, të mësimdhënësve, të bashkëpunëtorëve dhe të kuadrit administrativ,
10. krijimit të rregullave për shfrytëzim racional të resurseve njerëzore dhe materiale,
11. organizimit të studentëve dhe zhvillimit të aktiviteteve të tyre jashtë mësimore,
12. krijimit të sistemit për sigurim dhe kontroll të kualitetit,
13. vendosjes së standardeve në mësim,
14. vendosjes së sistemit informativ,
- (15) vendosjes së sistemit të bibliotekës,
16. realizimit të veprimtarisë botuese,
17. botimit të diplomave,
18. organizimit të takimeve shkencore dhe artistike,
19. transferimit të mjeteve të njësitë e universitetit dhe të organizatat universitare për aktivitete kulturore dhe sportive,
20. lëshimit të formularëve dhe dokumenteve tjera për nevojat e studentëve,
21. organizimit të shërbimit profesional respektivisht administrativ teknik,
22. mbajtjes dhe ruajtjes së dokumentacionit universitar,
23. kujdesit për mbrojtjen dhe avancimin e standardit të studentëve dhe të punësuarve,

24. krijimit të programit për këmbimin e shërbimeve dhe produkteve shkencore dhe profesionale me personat fizikë dhe juridikë vendas dhe të huaj,

25. sigurimit të pronës së universitetit dhe njësive të tij,

26. veprimtarisë aplikative dhe

27. kryerjes së veprimtarive dhe punëve tjera të përcaktuara me ligj dhe me statutin e universitetit.

(3) Veprimtaritë e integruara, obligimet dhe kompetencat e universitetit përcaktohen me Statutin e Universitetit.

### **Fakulteti, akademia e arteve dhe shkolla e lartë profesionale**

#### **Neni 20**

(1) Fakulteti është institucion i arsimit të lartë që kryen veprimtari të arsimit të lartë, veprimtari shkencore hulumtuese dhe veprimtari aplikative të lartë profesionale në fushën studimore dhe shkencore hulumtuese, sipas programit studimor të një ose më shumë sferave mësimore-shkencore të përafërta ose të lidhura ndërmjet veti, respektivisht artistike ose sfera profesionale, të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimeve.

(2) Akademia e Arteve si fakultet është institucion i arsimit të lartë që kryen veprimtari të arsimit të lartë dhe artistike dhe punë shkencore hulumtuese në një ose më shumë fusha të përafërta, përkatësisht të lidhura ndërmjet veti arsimore dhe artistike dhe kujdeset për zhvillimin e tyre.

Nëse akademia e arteve e mban emërtimin "fakultet", zbatohen dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me fakultetin.

(3) Shkolla e lartë e pavarur profesionale është institucion i arsimit të lartë që kryen veprimtari të arsimit të lartë ose artistike si studime profesionale deridiplomike, studime profesionale specialistike dhe veprimtari aplikative në fushën e një ose më shumë profesioneve të përafërta, përkatësisht të lidhura mes veti (sfera profesionale).

(4) Shkolla e lartë profesionale si njësi e universitetit është institucion i arsimit të lartë që kryen veprimtari të arsimit të lartë ose artistike si studime deridiplomike profesionale, studime specialistike profesionale dhe veprimtari aplikative nga fusha e një ose më shumë profesioneve të përafërta, përkatësisht të lidhura mes veti (sfera profesionale).

(5) Shkolla e lartë profesionale mundet, në kushtet e përcaktuara me ligj, të kryejë punë shkencore-hulumtuese, përkatësisht artistike, nëse kjo përcaktohet në statutin e universitetit si njësi universitare, respektivisht me aktin e saj themelues, nëse është e themeluar si shkollë e lartë e pavarur profesionale.

### **Veprimtaria e njësive të universitetit**

#### **Neni 21**

(1) Njësia e universitetit në suaza të veprimtarisë së vet:

1. e planifikon realizimin dhe zhvillimin e veprimtarive për të cilat është themeluar në suaza të mjeteve buxhetore, aktiviteteve të vetëfinancimit, donacioneve dhe të ngjashme,

2. kryen veprimtari të arsimit të lartë, shkencore-hulumtuese, aplikative, respektivisht artistike në një ose më shumë disiplina shkencore dhe profesionale të përafërta, përkatësisht të lidhura mes veti dhe sfera artistike,

3. realizon bashkëpunim ndërkombëtar me institucione të arsimit të lartë dhe institucione shkencore të përafërta në përputhje me statutin e universitetit dhe të njësisë,

4. organizon takime shkencore dhe artistike, simpoziume, seminare, këshillime dhe lloje të tjera të takimeve,

5. në kuadër të sistemit unik informativ-të bibliotekës të përcaktuar nga universiteti, e organizon punën e bibliotekës dhe organizon veprimtari informative-të bibliotekës dhe veprimtari të dokumentacionit,

6. lëshon certifikata dhe dokumente të tjera për studimet e përfunduara dhe llojet e tjera të arsimit, sipas kushteve të përcaktuara në statutin e universitetit,

7. propozon dhe ndërmerri masa për avancimin dhe mbrojtjen e standardit të studentëve dhe të punësuarve,

8. realizon studime të ndryshme për përsosje, thellim ose zgjerim të njohurive dhe arsim të vazhdueshëm,

9. këmben shërbime shkencore, artistike dhe profesionale dhe prodhime me persona fizikë dhe juridikë vendas dhe të huaj,

10. realizon veprimtari botuese dhe

11. kryen punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe statut të universitetit.

(2) Fakulteti mund të kryejë edhe veprimtari të arsimit të lartë për studime profesionale, të cilat në pajtim me këtë ligj i kryhen shkolla e lartë profesionale, në pajtim me statutin e universitetit.

(3) Njësitë e universitetit kanë ueb faqe në të cilën detyrimisht publikohen:

1. Statuti i njësisë (me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet) dhe aktet tjera me të cilat rregullohen marrëdhëniet e brendshme,

2. Aktvendimi për akreditimin e secilit program studimi veçmas dhe aktvendimi për të filluar punën për çdo program studimi veçmas,

3. Akti për sistematizim,

4. Rregullore për punën e këshillit shkencor mësimor, respektivisht këshillit shkencor,

5. Rregullore për punë dhe kompensime të njësisë,

6. Raport dhe vendim për zgjedhjen e fundit në titull për çdo mësimdhënës dhe bashkëpunëtor të publikuar në Buletin,

7. Orari i detyrave të punës për vitin rrjedhës shkollor, më së voni 10 ditë para fillimit të vitit shkollor,

8. Llogari përfundimtare, më së voni në afat prej 10 ditësh nga dita e miratimit,

9. Raport vjetor, më së voni në afat prej 10 ditësh nga dita e miratimit,

10. Tema të pranuar për përpunimin e punimeve të magistraturës, më së voni në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit,

11. Temat e pranuar për përpunimin e punimeve të doktoraturës, më së voni në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit,

12. Aktet të cilat i miraton njësia në pajtim me ligjet tjera dhe

13. Kodeksi etik.

(4) Shkolla e lartë e pavarur profesionale dhe instituti shkencor që kryejnë veprimtari të arsimit të lartë publikojnë në ueb faqen e vet aktet, dokumentet dhe njoftimet nga paragrafi (3) i këtij neni.

### **Veprimtaria e shkollës së lartë të pavarur profesionale**

#### **Neni 22**

(1) Shkolla e lartë e pavarur profesionale mund të kryejë aktivitete të arsimit të lartë si studime profesionale në ciklin e parë të arsimit dhe studime specialistike profesionale të ciklit të dytë të arsimit në pajtim me këtë ligj.

(2) Për shkollën e lartë të pavarur profesionale nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohen në mënyrë adekuate dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me universitetin, respektivisht me njësitë e tij.

## **Instituti shkencor si kryerës i veprimtarisë së arsimit të lartë**

### **Neni 23**

(1) Instituti shkencor si institucion i pavarur ose në përbërje të universitetit, mund të kryejë aktivitete të arsimit të lartë për studimet e shkallës së dytë dhe të tretë vetëm në suaza të sferës shkencore për të cilën është themeluar pas pesë viteve të themelimit, nëse evaluimi i punës shkencore-hulumtuese ka përfunduar me sukses, nëse është akredituar për kryerje të këtij lloji të studimeve dhe ka aktvendim për fillimin e punës.

(2) Instituti shkencor në përbërje të universitetit si njësi e tij mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë në ciklin e dytë dhe të tretë dhe në bashkëpunim me njësinë që realizon programe studimore të njëjtës fushë apo të fushës së përafërt shkencore.

(3) Instituti shkencor në përbërje të universitetit mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë në cikël të tretë studimesh nëse i plotëson kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni dhe nëse është në përbërje të universitetit i cili radhitet në mesin e shtatë universiteteve të para të ranguara në Republikën e Maqedonisë.

(4) Instituti shkencor si institucion i pavarur mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë për studime të ciklit të tretë, nëse i plotëson kushtet nga paragrafit 1 të këtij neni vetëm në bashkëpunim me njësinë universitare i cili është i renditur në mesin e shtatë universiteteve të para të ranguara në Republikën e Maqedonisë.

## **Institucioni i arsimit të lartë i bashkësisë fetare**

### **Neni 24**

(1) Fakultetet ose akademitë e themeluara nga bashkësitë fetare mund t'i kenë të drejtat dhe detyrimet e institucionit të arsimit të lartë të përcaktuara me këtë ligj, nëse i plotësojnë kushtet e këtij ligji për themelimin e institucionit të arsimit të lartë dhe për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë (në tekstin e mëtejme:

institucioni i arsimit të lartë i bashkësisë fetare).

(2) Institucioni i arsimit të lartë i bashkësisë fetare mund të jetë në përbërje të universitetit si njësi të universitetit ose si anëtar shoqërues.

(3) Pozita e institucionit të arsimit të lartë të bashkësisë fetare si anëtar shoqërues në përbërjen e universitetit përcaktohet dhe rregullohet me marrëveshje të lidhur në formë me shkrim ndërmjet universitetit dhe themeluesit të institucionit të arsimit të lartë të bashkësisë fetare.

(4) Aderimi i institucionit të arsimit të lartë të bashkësisë fetare si njësi e universitetit kryhet sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj dhe statutin e universitetit.

(5) Kushtet për aderim të institucionit të arsimit të lartë të bashkësisë fetare në universitet, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre, rregullohen me statutin e universitetit.

## **Institucioni i huaj i arsimit të lartë**

### **Neni 25**

(1) Institucion i huaj i arsimit të lartë, të cilit i është njohur e drejta për të kryer veprimtari të arsimit të lartë, përkatësisht është i akredituar për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë në vendin në të cilin e ka selinë, në bazë të lejes nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me mendim paraprak nga Bordi për akreditim të arsimit të lartë, mund në një nga gjuhët botërore të kryejë veprimtari të arsimit të lartë në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Institucioni i huaj i arsimit të lartë mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe marrëveshje ndërshtetërore të lidhur midis Republikës së Maqedonisë dhe vendit në të cilin i njihet e drejta për të kryer veprimtari të arsimit të lartë.

Për kryerje të veprimtarisë së arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë nga institucioni i huaj i arsimit të lartë, themeluesi duhet të dorëzojë garanci bankare të parevokueshme në thirrje të parë në shumë prej 25% të taksës shkollore për numrin e studentëve për të cilët kërkohet leje pune (ose akreditim) me të cilën do të garantojë se do t'i kompensojë mjetet që studentët ia kanë paguar institucionit të arsimit të lartë që ka pushuar me punë dhe shpenzimet tjera që do t'i kenë studentët për transferimin e studimeve në institucion arsimor të lartë njëjtë ose të përafërt në vend.

(3) Institucioni i huaj i arsimit të lartë që ka marrë leje për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë në përputhje me paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni dhe akreditim për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë në vendin ku e ka selinë regjistrohet në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë si institucion dhe në Regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë në pajtim me nenin 71 të këtij ligji.

## Kapitulli i katërt

### STUDENTËT DHE ORGANIZATAT E STUDENTËVE

#### Seksioni 1

#### **Të drejtat dhe obligimet e studentëve**

##### **Statusi i studentëve**

###### Neni 26

(1) Statusi i studentit, dhe me këtë edhe i anëtarit të bashkësisë akademike fitohet me regjistrim në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve në universitet, ose në shkollën e lartë të pavarur profesionale.

(2) Statusi student dëshmohet me legjitimacionin e studentit ose me indeks.

#### **Të drejtat dhe obligimet e studentëve**

###### Neni 27

(1) Studenti ka të drejtë për:

1. studime kualitative dhe proces arsimor siç është paraparë me programet studimore,
2. shprehje të lirë të mendimit dhe qëndrimeve gjatë mësimit dhe aktiviteteve tjera të institucionit të arsimit të lartë,
3. të drejtën e sqarimit për kualitetin (vlerësimin) e mësimit dhe mësimdhënësve,
4. studim të rregullt dhe status të studentit të rregullt dhe të drejtë për studime me korrespondencë dhe status të studentit me korrespondencë,
5. të përparojë rregullisht, të arsimohet dhe t'i përfundojë studimet në kushte që kanë vlejtur gjatë regjistrimit,
6. regjistrimin dhe arsimin me kushte të barabarta të përcaktuara me ligj, statut dhe program studimor,
7. pjesëmarrje në menaxhimin e institucionit të arsimit të lartë në pajtim me këtë ligj dhe statutin e institucionit të arsimit të lartë,
8. mbrojtjen e të drejtave dhe detyrave të tyre para organeve të institucionit të arsimit të lartë dhe
9. mbrojtjen e personalitetit të studentit nga abuzimi dhe të dinjitetit të tij.

(2) Studenti ka të drejtë që:

1. të studiojë në të njëjtën kohë në më tepër programe studimore të specialiteteve të ndryshme dhe të mësojë kurse shtesë,

2. t'i vazhdojë studimet në institucion tjetër të arsimit të lartë nëse institucioni i arsimit të lartë në të cilin ai është i regjistruar e ndërpret punën,

3. t'i shfrytëzojë bibliotekën dhe bazat e të dhënave, hapësirën, pajisjen (veglat ndihmëse mësimore), softuerin dhe infrastrukturën tjetër shkencore dhe profesionale të universitetit dhe njësive të tij, përkatësisht institucionit të pavarur të arsimit të lartë,

4. të marrë pjesë në veprimtarinë hulumtuese-shkencore, artistike dhe profesionale ku i garantohen të drejtat e autorit, të zbulimeve dhe të drejtat e përafërta dhe çmimet,

5. të zgjedh dhe të zgjidhet si përfaqësues i studentëve në organet e institucioneve të arsimit të lartë,

6. t'i shfrytëzojë shërbimet e standardit të studentëve (akomodim, ushqim, mbrojtje shëndetësore etj.), transporti urban dhe ndërurban sipas kushteve të përcaktuara me ligj nga kryerësit e veprimtarive përkatëse,

7. t'i shfrytëzojë objektet universitare për veprimtari sportive dhe kulturore,

8. kalon nga një institucion në institucion tjetër të arsimit të lartë, respektivisht nga një palë studime në tjerat dhe me këtë rast t'i shfrytëzojë volitshmëritë e sistemit të kredive,

9. të marrë pjesë në punën e organizatave studentore,

10. të marrë pjesë në format e organizimit të organizatave studentore të përcaktuara me statutin e universitetit,

11. t'i vazhdojë studimet që i ka ndërprerë me kushte të përcaktuara me statut të institucionit të arsimit të lartë,

12. të shfrytëzojë pushim jo më pak se 60 ditë në suaza të një viti kalendarik,

13. të marrë bursa shtetërore ose bursa të tjera ose të shfrytëzojë kredi financiare për mbajtje gjatë shkollimit,

14. të realizojë bashkëpunim me studentët në vend dhe jashtë vendit dhe

15. të realizojë të drejta tjera në pajtim me ligjin dhe me statutin e institucionit të arsimit të lartë.

(3) Studenti e ka për obligim që:

1. t'i plotësojë detyrat e përcaktuara në programet studimore,

2. t'i respektojë dispozitat e këtij ligji, statutin e institucionit të arsimit lartë dhe aktet tjera juridike të rregullimit të brendshëm,

3. t'u përmbahet aktvendimeve dhe vendimeve të organeve të institucionit të pavarur të arsimit të lartë dhe njësisë së tij

4. t'i respektojë të drejtat e autorit dhe të autorëve të librave shkollorë, monografive dhe veglat ndihmëse mësimore dhe

5. të veprojnë në përputhje me kodeksin etik të studentit të cilin e përgatit dhe e miraton institucioni i arsimit të lartë në përputhje me prezantimin studentor.

(4) Studentët e të gjitha shkallëve të arsimit të lartë që janë pa prindër, të verbër, të shurdhër, invalidë grupit të parë dhe i dytë, nënat me fëmijë deri në moshën gjashtë vjeçe dhe të hospitalizuarit, kanë të drejtë për volitshmëri të veçanta të përcaktuara me statutin e institucionit të arsimit të lartë.

(5) Të drejtat e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni dhe obligimet nga paragrafi (3) të këtij neni, studenti i institucionit të arsimit të lartë i realizon në vëllim dhe sipas kushteve të përcaktuara me ligj dhe statutin e institucionit të arsimit të lartë.

(6) Qeveria e Republikës së Maqedonisë mund të marrë vendim për volitshmëri të posaçme për studentët, siç janë kartela studentore për lirime, transport urban falas dhe të tjera, me ç'rast mjetet sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

## **Rregullat e studimit**

### **Neni 28**

Me akt të përgjithshëm të universitetit ose të shkollës së lartë të pavarur profesionale, e më afërsisht me akt të përgjithshëm të njësisë universitare, rregullohen procedurat dhe rregullat për studim, e veçanërisht për:

1. kalendarin e studentëve,
2. procedurat e regjistrimit,
3. regjimin e provimeve,
4. avancimin, në mënyrë inkluzive me kushtet për avancim më të shpejtë,
5. përfundimin e arsimit,
6. kalimet ndërmjet programeve studimore,
7. përsëritjen e semestrit, riregjistrimin e lëndëve, respektivisht avancimin me kusht,
8. vazhdimin e studimeve pas ndërprerjes,
9. studim paralel, interdisiplinar dhe individual,
10. pranimin e provimeve dhe obligimeve tjera studimore të dhëna në institucione të ndryshme të arsimit të lartë,
11. llojin e dokumenteve të cilat i jepen studentit në bazë të evidencës së përcaktuar me këtë ligj,
12. procedurën për mbrojtjen e të drejtave të studentëve,
13. organet kompetente për mbajtjen e procedurave dhe vendimmarrjes,
14. përgjegjësia disiplinore dhe të drejtat dhe detyrimet e studentëve në procedurën disiplinore dhe
15. rregulla tjera lidhur me të drejtat dhe obligimet e studentëve.

## **Ndërprerja e statusit të studentit**

### **Neni 29**

(1) Studentit i pushon statusi i studentit në institucionin e arsimit të lartë sipas kushteve dhe procedurës së përcaktuar me statutin e institucionit të arsimit të lartë.

(2) Statusi nga paragrafi (1) i këtij neni pushon, nëse studenti:

- diplomon,
- nuk i përfundon studimet në afat të përcaktuar me ligj, statut apo rregullat për studim në institucion të arsimit të lartë,
- çregjistrohet,
- përjashtohet dhe
- në raste të tjera të përcaktuara me rregullat për studim në universitet dhe në njësi universitare, përkatësisht me statutin e shkollës së pavarur të lartë profesionale.

(2) Statusi nga paragrafi (1) i këtij neni mund të përtërihet sipas procedurës së përcaktuar me statutin e institucionit të arsimit të lartë, përveç nëse statusi nuk ka pushuar me përjashtim të përhershëm.

Shpenzimet për përtëritjen e statusit i bart studentit dhe të njëjtat përcaktohen me akt të përgjithshëm të universitetit, përkatësisht institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

## **Masat disiplinore**

### **Neni 30**

(1) Për shkeljen e detyrimeve dhe për mosplotësimin e obligimeve studentit mund t'i shqiptohet masë disiplinore vërejtje, vërejtje publike dhe përjashtim.



(2) Masa disiplinore përjashtim zbatohet për vitin shkollor në të cilin është shqiptuar.

(3) Masat disiplinore i shqipton komisioni për masa disiplinore të njësisë së universitetit, respektivisht të shkollës së pavarur profesionale.

(4) Në përbërjen e komisionit disiplinor një anëtar delegojnë studentët e institucionit të arsimit të lartë ku studenti është i regjistruar.

(5) Me statutin e universitetit respektivisht statutin e shkollës së lartë profesionale të pavarur përcaktohet përbërja e komisionit disiplinor, mënyra dhe procedura për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore, masat dhe kushtet në të cilat shqiptohet masa disiplinore dhe e drejta për mbrojtje të studentit.

(6) Procedura e përgjegjësisë disiplinore zbatohet mbi parimin e drejtësisë dhe dëgjimit nga ana e komisionit për masa disiplinore.

### **Avokati i studentëve**

#### **Neni 31**

(1) Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të studentëve në secilin universitet zgjidhet avokati i studentëve, nga radhët e studentëve të rregullt në universitet.

(2) Avokati i studentëve zgjidhet nga Senati i Universitetit me shumicë votash të anëtarëve të Senatit të Universitetit, me propozim të Kuvendit të Studentëve të Universitetit në konkurs të shpallur më parë.

(3) Në çdo njësi të Universitetit, zgjidhet zëvendësavokat i studentëve, të cilin e zgjedh Kuvendi i studentëve të fakultetit me konkurs të shpallur më parë nga radhët e studentëve të rregullt.

(4) Mandati i avokatit të studentëve dhe i zëvendësve të avokatit të studentëve është 2 vjet, pa mundësi për rizgjedhje.

(5) Procedurë për shkarkimin e avokatit të studentit mund të ngrejë Kuvendi i Studentëve të Universitetit, ndërsa vendim për shkarkim miraton Senati i Universitetit, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

(6) Procedurë për shkarkimin e zëvendësit të avokatit të studentëve mund të ngrejnë anëtarët e kuvendit të studentëve të fakultetit, avokati i studentëve ose 1/10 e numrit të përgjithshëm të studentëve të regjistruar në momentin në fakultetin në të cilin është zgjedhur zëvendësi i avokatit të studentëve.

Për shkarkimin e zëvendësit të avokatit të studentëve vendos Kuvendi i studentëve të fakultetit.

### **Kompetencat e avokatit të studentëve**

#### **Neni 32**

(1) Avokati i studentëve vepron për parashtrësë nga ana e studentit ose me vetëiniciativë nëse ka konstatuar se e drejta e studentit është cenuar nga organet e Universitetit ose nga anëtar tjetër i bashkësisë akademike të Universitetit.

Organet e institucionit të arsimit të lartë janë të detyruara të veprojnë sipas sugjerimeve të avokatit të studentëve.

(2) Zëvendësavokati i studentëve vepron për parashtrësë nga ana e studentit dhe me vetëiniciativë nëse konstaton se e drejta e studentit është cenuar nga ana e organeve të fakultetit ose nga anëtar tjetër i bashkësisë akademike të fakultetit. Organet e fakultetit janë të detyruar të veprojnë sipas sugjerimeve të zëvendësavokatit të studentëve.

(3) Për punën e tij, avokati i studentëve parashtron raport vjetor në Senatin e Universitetit.

(4) Për punën e tij zëvendësavokati i studentëve parashtron raport vjetor tek avokati i studentëve dhe në Këshillin Mësimor-Shkencor të njësisë.

(5) Kompetenca, kushtet për zgjedhjen, procedura për zgjedhje dhe shkarkim dhe puna e avokatit të studentëve dhe e zëvendësavokatit të studentëve përcaktohen me aktet e universitetit, njësisë të tij dhe kuvendit të studentëve.

## Seksioni 2

### ORGANIZIMI I STUDENTËVE DHE PJESËMARRJA E STUDENTËVE NË MENAXHIM

#### **Organizimi studentëve**

##### Neni 33

(1) Kuvendet e studentëve janë trupa të institucioneve të arsimit të lartë, në të cilat të anëtarësuar janë përfaqësues të studentëve.

(2) Institucionet e arsimit të lartë janë të detyruara që kuvendeve të studentëve, avokatit të studentëve dhe zëvendësavokatit të studentëve t'u sigurojnë hapësira për punë dhe t'u ofrojnë ndihmë teknike administrative.

(3) Institucionet e arsimit të lartë janë të obliguar, sipas mundësive të tyre, t'i mbështesin kuvendet e studentëve që janë të organizuar në suaza të tyre.

#### **Financimi i kuvendeve të studentëve**

##### Neni 34

(1) Puna e kuvendit të studentëve financohet nga mjetet e institucionit të arsimit të lartë, si dhe nga: legatet, dhuratat, testamentet, kontributet dhe burime tjera.

(2) Kuvendet e studentëve disponojnë me mjetet në mënyrën e përcaktuar me statutin e tyre.

(3) Institucionet e arsimit të lartë janë të obliguara t'u mundësojnë kuvendeve të studentëve disponim autonom me mjetet për punën e tyre në pajtim me këtë ligj dhe me aktet e përgjithshme të institucioneve të arsimit të lartë.

(4) Institucionet e arsimit të lartë kryejnë mbikëqyrje mbi shpenzimin me dedikim të mjeteve të cilat ua shpërndajnë kuvendeve të studentëve, në mënyrë të përcaktuar me statusin e tyre.

#### **Kuvendi universitar i studentëve**

##### Neni 35

(1) Kuvendi universitar i studentëve është trup i universitetit në të cilin të anëtarësuar janë përfaqësuesit e studentëve.

(2) Kuvendi studentor universitar i mbron interesat e studentëve, merr pjesë përmes pjesëtarëve të vet në vendimmarrje në organet dhe trupat e universitetit dhe i prezanton studentët në suaza të arsimit të lartë si anëtarë të bashkësisë akademike.

#### **Kompetenca e Kuvendit studentor universitar**

##### Neni 36

(1) Kuvendi studentor universitar ka kompetencë të:

- zgjedh përfaqësues studentor në Senatin dhe organet dhe trupat tjerë të universitetit,
- miraton plan dhe program për punën e vet,
- propozon avokat studentor,

- kujdeset për cilësinë e jetës së studentit dhe cilësinë e procesit të studimit, standardin studentor, realizimin e të drejtave dhe interesave studentore dhe për përsosje kulturore, sociale dhe intelektuale të studentëve,

- organeve drejtuese, u propozon plan për financim të aktiviteteve studentore,  
- stimulon aktivitete studentore jashtë procesit të mësimdhënies,  
- miraton akte të përgjithshme të kuvendit studentor në pajtim me ligjin dhe statutin e universitetit,

- kryen aktivitete tjera të interesit të studentëve.

(2) Kuvendi universitar studentor përbëhet prej përfaqësuesve të studentëve të emëruar nga radhët e përfaqësuesve të zgjedhur në kuvendin studentor të fakultetit.

(3) Kuvendet studentore të fakulteteve dhe kuvendet e studentëve në shkollat e larta profesionale emërojnë nga dy përfaqësues në kuvendin studentor universitar në universitetin në përbërje të të cilit janë.

(4) Kryetari i kuvendit universitar studentor zgjidhet nga radhët e përfaqësuesve të emëruar në kuvendin studentor universitar.

(5) Mandati i anëtarëve dhe kryetarit të kuvendit studentor universitar zgjat një vit, me të drejtë për rizgjedhje.

(6) Numri i anëtarëve të kuvendit studentor universitar, si dhe organet e kuvendit studentor universitar dhe mënyra e zgjedhjes së tyre rregullohen me statutin e universitetit.

(7) Kuvendi studentor universitar ka statut. Statuti i kuvendit studentor universitar miratohet me pëlqim paraprak të senatit të universitetit.

(8) Puna e kuvendit studentor universitar financohet me mjete të universitetit në suazat e të cilit vepron kuvendi studentor universitar.

### **Kuvendi studentor i fakultetit**

#### **Neni 37**

(1) Kuvendi studentor i fakultetit është trup i fakultetit ku bëjnë pjesë përfaqësues të studentëve.

(2) Përfaqësuesit në kuvendin studentor të fakultetit caktohen në zgjedhje të drejtpërdrejta, të drejta dhe demokratike me votim të fshehur.

(3) Të drejtë që të zgjedhin dhe të zgjidhen si anëtarë të kuvendit studentor të fakultetit kanë të gjithë studentët e fakultetit, të cilët janë të regjistruar në studime në vitin akademik në të cilin zgjedhet kuvendi studentor i fakultetit.

(4) Mandati i anëtarëve dhe kryetarit të kuvendit studentor universitar zgjat një vit, me të drejtën për rizgjedhje.

(5) Zgjedhja e anëtarëve dhe e kryetarit të kuvendit studentor të fakultetit mbahet çdo vit në termin të caktuar me statutin e kuvendit studentor universitar.

(6) Zgjedhjet për anëtarë të kuvendit studentor të fakultetit i shpall dekani në afat prej 30 ditëve para mbajtjes së tyre. Në vendimin për shpalljen e zgjedhjeve, Dekani emëron komision zgjedhor të formuar prej studentëve dhe mësimdhënësve, përkatësisht bashkëpunëtorëve, që i zbaton zgjedhjet për anëtarë të kuvendit studentor të fakultetit. Shumica e anëtarëve të komisionit zgjedhor përbëhet prej studentëve.

(7) Nëse dekani i fakultetit nuk i shpall zgjedhjet për kuvendin studentor të fakultetit në afatin e caktuar në paragrafin (6) të këtij neni, zgjedhjet i shpall rektori i universitetit në afat prej tre ditëve nga skadimi i afatit nga paragrafi (6) i këtij neni.

(8) Procedura për zgjedhje dhe numri i anëtarëve të kuvendit studentor të fakultetit, si dhe organet e kuvendit studentor të fakultetit dhe mënyra e zgjedhjes së tyre rregullohen me statutin e fakultetit në pajtim me statutin e universitetit.

(9) Kuvendi studentor i fakultetit ka statut, të cilin kuvendi studentor e miraton me pëlqim paraprak nga këshilli shkencor-mësimor të fakultetit.

(10) Për shkak të realizimit të të drejtave dhe mbrojtjen e interesave të studentëve, kuvendi studentor i fakultetit i zgjedh dhe shkarkon përfaqësuesit e studentëve në organet e fakultetit, në pajtim me ligj, me statutin e universitetit dhe statutin e fakultetit.

(11) Puna e kuvendit studentor të fakultetit financohet me mjete të fakultetit në suazat e të cilit vepron kuvendi studentor i fakultetit.

(12) Me kuvendin studentor të fakultetit kryeson kryetar i cili zgjedhet në zgjedhje të drejtpërdrejta dhe të fshehta. Kryetari i kuvendit studentor të fakultetit i zbaton vendimet e kuvendit studentor të fakultetit, i përfaqëson studentët dhe kuvendin studentor të fakultetit dhe është përgjegjës për punën e tij.

### **Kuvendi studentor i shkollës së lartë profesionale**

#### **Neni 38**

(1) Kuvendi studentor i shkollës së lartë profesionale është trup i shkollës së lartë profesionale në të cilën bëjnë pjesë përfaqësues të studentëve.

(2) Procedura për zgjedhje dhe numri i anëtarëve të kuvendit studentor të shkollës së lartë si dhe organet e kuvendit studentor të shkollës së lartë profesionale dhe mënyra e zgjedhjes së tyre rregullohen me statutin e shkollës së lartë profesionale, në pajtim me statutin e universitetit.

(3) Kuvendi studentor i shkollës së lartë ka statut, të cilin kuvendi studentor e miraton me pëlqim paraprak nga këshilli i mësimdhënësve të shkollës së lartë profesionale.

(4) Të drejtë për zgjedhje dhe të jenë të zgjedhur për anëtarë të kuvendit studentor të shkollës së lartë profesionale kanë të gjithë studentët, të cilët janë të regjistruar në studime në vitin shkollor në të cilin zgjedhet kuvendi studentor i shkollës së lartë profesionale.

(5) Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të kuvendit studentor të shkollës së lartë profesionale zgjat një vit, me të drejtë për rizgjedhje.

(6) Puna e kuvendit studentor të shkollës së lartë profesionale financohet me mjete të shkollës së arsimit të lartë në suazat e të cilës vepron kuvendi studentor.

(7) Zgjedhja e anëtarëve të kuvendit studentor të shkollës së lartë profesionale mbahet çdo vit në termin të caktuar me statutin e kuvendit studentor, me votim të fshehur dhe të drejtpërdrejtë.

(8) Zgjedhjet për anëtarët e kuvendit studentor të shkollës së lartë profesionale i shpall drejtori në afat prej 30 ditëve para mbajtjes së tyre. Në vendimin për shpalljen e zgjedhjeve, drejtori emëron komision zgjedhor të formuar prej studentëve dhe mësimdhënësve, përkatësisht bashkëpunëtorëve që i zbaton zgjedhjet për anëtarë të kuvendit studentor. Shumicën e anëtarëve të komisionit zgjedhor e përbëjnë studentët.

(9) Nëse drejtori i shkollës së lartë profesionale nuk i shpall zgjedhjet për kuvendin studentor në afatin e caktuar në paragrafin (8) të këtij neni, zgjedhjet i shpall rektori i universitetit në afat prej tri ditëve nga skadimi i afatit nga paragrafi (8) i këtij neni.

(10) Nëse drejtori i shkollës së pavarur të lartë profesionale nuk i shpall zgjedhjet për kuvendin studentor në afatin e caktuar në paragrafin (8) të këtij neni, zgjedhjet i shpall rektori i universitetit në afat prej 3 ditëve nga skadimi i afatit nga paragrafi (9) i këtij neni.

(11) Për shkak të realizimit të të drejtave dhe mbrojtjen e interesave të studentëve, kuvendi studentor i zgjedh dhe shkarkon përfaqësuesit e studentëve në organet e shkollës së lartë profesionale, në pajtim me ligj, me statutin e universitetit dhe statutin e shkollës së lartë profesionale.

## **Pjesëmarrje e studentëve në administrim**

### **Neni 39**

(1) Studentët marrin pjesë në administrimin me institucionet e arsimit të lartë nëpërmjet përfaqësuesve të cilët i zgjedhin në:

- kuvendin studentor universitar, kuvendin studentor të fakultetit dhe kuvendin studentor të shkollës së lartë profesionale.

- në organet e institucioneve të arsimit të lartë në pajtim me ligj,

- nëpërmjet formave të vetorganizimit ose

- në mënyrë tjetër sipas kushteve të caktuara me ligj dhe statutin e institucionit të arsimit të lartë.

(2) Kuvendi studentor i universitetit, kuvendi studentor i fakultetit dhe kuvendi studentor i shkollës së lartë profesionale u mundësojnë studentëve realizimin e interesave të përbashkëta si partnerë në procesin e arsimit të lartë.

(3) Pjesëmarrja e studentëve në organet e universitetit dhe të njësive të universitetit, përkatësisht në shkollën e pavarur të lartë profesionale, çështjet për të cilat vendosin në mënyrë të barabartë, numrin, mënyrën e zgjedhjes dhe çështjet tjera me rëndësi për realizimin e të drejtave të tyre më afërsisht rregullohen me statutin e universitetit dhe statutin e njësive të universitetit, përkatësisht me statutin e shkollës së pavarur të lartë profesionale, ndërkaq në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

## **Kapitulli i pestë**

### **SIGURIMI, VLERËSIMI, ZHVILLIMI DHE AVANCIMI I CILËSISË SË ARSIMIT TË LARTË**

#### **Seksioni 1**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Sistemi i sigurimit, vlerësimi, zhvillimi dhe avancimi i cilësisë së arsimit të lartë**

### **Neni 40**

(1) Sistemi i sigurimit, vlerësimit, zhvillimit dhe avancimit të cilësisë së arsimit të lartë përfshin:

miratim, vërtetim dhe njohje të institucionit të arsimit të lartë dhe programeve studimore, për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë në pajtim me këtë Ligj, që realizohet nëpërmjet sistemit të akreditimit (në tekstin e mëtejme: akreditim);- vlerësim i cilësisë së kryerjes së veprimtarisë të arsimit të lartë, të menaxhimit, financimit, aktiviteteve akademike dhe tjera dhe prioritetet e saj, që realizohet nëpërmjet sistemit të evaluimit (në tekstin e mëtejme: evaluim) dhe aktivitete dhe mekanizma tjerë nëpërmjet të cilëve zhvillohet dhe mirëmbahet cilësia e arsimit të lartë të caktuara me ligj dhe aktet e Këshillit nacional për arsim të lartë dhe veprimtari shkencor-hulumtuese.

(2) Sistemi i sigurimit, vlerësimit, zhvillimit dhe avancimit të arsimit të lartë realizohet nëpërmjet Këshillit nacional për arsim të lartë dhe veprimtarisë shkencor-hulumtuese dhe Agjencisë për cilësi në arsim të lartë.

(3) Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit nacional për arsim të lartë, Bordit për akreditim të arsimit të lartë dhe Bordit për evaluim të arsimit të lartë, aplikohet parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të qytetarëve të cilët u përkasin bashkësive me respektimin e kritereve të profesionalitetit dhe kompetencës në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

## Seksioni 2

### KËSHILLI NACIONAL PËR ARSIM TË LARTË DHE VEPRIMTARI SHKENCORE-HULUMTUESE

#### **Këshilli Nacional për arsim të lartë dhe veprimtari shkencoro-hulumtuese**

##### Neni 41

(1) Këshilli nacional për arsim të lartë dhe veprimtari shkencore-hulumtuese (në tekstin e mëtejme: Këshilli nacional) formohet për shkak të sigurimit, vlerësimit, zhvillimit dhe avancimit të cilësisë në arsimin e lartë dhe veprimtarinë shkencore-hulumtuese në Republikën e Maqedonisë.

(2) Këshilli nacional është organ i pavarur me zyrë në Shkup.

(3) Këshilli nacional ka:

-vulë me mbishkrimin: Republika e Maqedonisë – Këshilli Nacional për arsim të lartë dhe veprimtari shkencoro-hulumtuese – Shkup. Në qendrën e vulës gjendet stema e Republikës së Maqedonisë, - xhiro llogari e veçantë, ndërkaq mjetet për punë sigurohen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

#### **Përbërja e Këshillit nacional**

##### Neni 42

(1) Këshilli nacional përbëhet prej 15 anëtarëve të cilët i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë edhe atë:

- gjashtë anëtarë nga radhët e profesorëve në marrëdhënie pune në universitetet në Republikën e Maqedonisë, të cilët zgjedhen me propozim të Konferencës Interuniversitare me votim të fshehur, me ç'rast secili prej tyre është prej fushave të ndryshme shkencore-hulumtuese të nivelit të parë sipas Klasifikimit ndërkombëtar të Fraskatit (shkenca matematiko-natyrore; shkenca tekniko-teknologjike; shkenca mjekësore dhe shëndetësi; shkenca bujqësore dhe veterinare; shkenca shoqërore dhe shkenca humaniste),

- gjashtë anëtarë nga radhët e profesorëve në marrëdhënie pune në universitetet në Republikën e Maqedonisë, të cilët zgjedhen me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, me ç'rast secili prej tyre është prej fushave të ndryshme shkencore-hulumtuese të nivelit të parë sipas Klasifikimit ndërkombëtar të Fraskatit (shkenca matematiko-natyrore; shkenca tekniko-teknologjike; shkenca mjekësore dhe shëndetësi; shkenca bujqësore dhe veterinari; shkenca shoqërore dhe shkenca humaniste),

- një anëtar me propozim të Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve nga radhët e anëtarëve të Akademisë Maqedonase për shkencat dhe artet;

- një anëtar nga radhët e komunitetit afarist dhe

- një anëtar nga radhët e studentëve me propozim të Konferencës Interuniversitare.

(2) Për anëtarë të Këshillit nacional nuk mund të jenë persona të zgjedhur për rektor, prorektor ose kryetar të senatit të universitetit, dekan ose prodekan në fakultet, përkatësisht drejtor i shkollës së lartë profesionale, drejtor i institutit shkencor, përkatësisht drejtor i shkollës së lartë profesionale, drejtor i institutit shkencor që ushtron veprimtari të arsimit të lartë, anëtar i Bordit për akreditim ose anëtar i Bordit për evaluim.

(3) Mandati i anëtarëve të Këshillit nacional është 4 vite pa të drejtë për zgjedhje të sërishme.

4) Me përjashtim nga paragrafi (3) i këtij neni, anëtari i cili zgjedhet nga radhët e studentëve, zgjedhet periudhë prej dy viteve pa të drejtë të zgjedhjes së sërishme.

(5) Anëtarët e Këshillit nacional nga paragrafi (1) i këtij neni të cilët janë nga radhët e profesorëve, të propozuar nga Konferenca Interuniversitare dhe nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë duhet të kenë publikuar së paku dhjetë punime shkencore në publikim shkencor referues, përveç profesorëve për artet profesionale artistike.

(6) Mandati i anëtarit të Këshillit nacional ndërpritet me fuqi të ligjit në rastet vijuese:

- vdekje e anëtarit të Këshillit nacional ose paaftësi permanente për kryerjen e funksionit të tij;
- dorëheqje e anëtarit të Këshillit nacional;
- nëse anëtarit të Këshillit nacional i ndërpritet statusi profesor; përkatësisht anëtar i Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve, përkatësisht studentit;
- nëse anëtari i Këshillit nacional merr detyrë ose funksion që nuk përputhet me funksionin anëtar i Këshillit nacional, në pajtim me ligjin.

(7) Në rastet nga paragrafi (6) i këtij neni, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë e konstaton paraqitjen e ndërprerjes së funksionit të anëtarit të Këshillit nacional në seancën e parë të radhës.

(8) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e shkarkon anëtarin e Këshillit nacional, me Propozim të Këshillit nacional, nëse i njëjti më gjatë se gjashtë muaj nuk i kryen obligimet e caktuara me ligj dhe me dispozitat tjera.

### **Kompetenca e Këshillit nacional**

#### **Neni 43**

(1) Këshilli nacional është i pavarur në punën e vet dhe vendos në suaza të kompetencës që ka në bazë të parimit të profesionalitetit dhe kompetencës.

(2) Këshilli nacional:

1. përcjell zhvillimin e arsimit të lartë dhe harmonizimit me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për çka një herë në vit parashtron raport në Kuvendit dhe në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë me propozim masa, zgjidhje dhe rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së arsimit të lartë;

2. përpilon dhe me pëlqim të ministrit kompetent për punët në arsim të lartë propozon për miratim Programin nacional për arsim të lartë në Kuvendin e Republikën e Maqedonisë;

3. miraton Rregullore për normativat dhe standardet për themelim të institucioneve të arsimit të lartë dhe për kryerje të veprimtarisë së arsimit të lartë në pajtim me këtë ligj;

4. miraton Rregullore për përmbajtjen e programeve studentore në pajtim me këtë ligj;

5. propozon Urdhëresë për masa dhe kritere për stimulim të arsimit të lartë, të cilën e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë;

6. propozon Urdhëresë për masa dhe kritere për stimulim të studentëve të talentuar dhe për dhënie të bursave për studentët të cilët arrijnë rezultate mbi mesataret në studimet, të cilën e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë;

7. me propozim të Bordit për akreditim të institucioneve të arsimit të lartë, miraton Rregullore për metodologjinë, standardet dhe procedurën për akreditim të institucioneve të arsimit të lartë dhe për akreditim të programeve studentore;

8. me propozim të Bordit për evaluim të arsimit të lartë miraton Rregullore për standardet dhe procedurën për evaluim të jashtëm vetevaluim;

9. propozon komision amë për themelim të institucionit të pavarur për arsim të lartë;

10. propozon urdhëresë me të cilën rregullohet e drejta e personave me invaliditet dhe persona tjerë të jenë të liruar nga participimi për studim, të cilën e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë;

11. miraton Rregullore me të cilën përcaktohen titujt profesionalë dhe shkencorë, në pajtim me ligjin;

12. miraton Rregullore për përmbajtjen dhe formën e raportit për punën e rektorit;
13. miraton program katërvjeçar dhe program vjetor për punë;
14. miraton Rregullore për punë;
15. propozon në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë shkarkim të anëtarit të Këshillit nacional i cili më shumë se gjashtë muaj nuk i kryen kompetencat e tij të caktuara me ligj dhe me dispozitat tjera;
16. themelon baza elektronike të revistave, krahas bazave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1 pika 24 e këtij ligji dhe fushat në të cilat përkthimi i veprave kryesore do të konsiderohen si publikime shkencore referente në pajtim me nenin 2 paragrafi (1) pika 24 e këtij ligji;
17. përcakton listë të ngjarjeve relevante vendase dhe ndërkombëtare në të cilat performanset artistike merren parasysh gjatë akreditimit të mentorëve në pajtim me nenin 136 paragrafi 8 i këtij ligji;
18. propozon urdhëresë për përcaktim të sferave shkencoro-hulumtuese të nivelit të tretë (fusha), si plotësim të dy niveleve të Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, të cilën e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë;
19. e përcjell zhvillimin e veprimtarisë shkencoro-hulumtuese dhe harmonizimin e saj me tendencat evropiane dhe ndërkombëtare për çka një herë në vit parashtron raport në Kuvendin dhe Qeverinë e Republikës së Maqedonisë me propozim masa, zgjidhje dhe rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë shkencoro-hulumtuese;
20. e përpilon dhe me pajtim të ministrit kompetent për punët e arsimit të lartë e propozon për miratim Programin Nacional për veprimtari shkencoro-hulumtuese në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë;
21. në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë propozon fusha dhe programe prioritare për hulumtim shkencor dhe zhvillim teknologjik;
22. jep propozime dhe mendimet për iniciativa në lidhje me programet dhe projektet për bashkëpunim ndërkombëtar;
23. miraton Rregullore për normativat dhe standardet për themelim të instituteve shkencore dhe për kryerje të veprimtarisë shkencoro-hulumtuese;
24. propozon urdhëresë për masa dhe kritere për financim të veprimtarisë shkencoro-hulumtuese, të cilën e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë;
25. propozon së paku një bazë të punimeve në të cilën ministria kompetente për punë e arsimit të lartë siguron qasje për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e zgjedhur të universiteteve publike dhe
26. kryen punë tjera në pajtim me ligjin.

### **Organizimi dhe puna e Këshilli nacional**

#### **Neni 44**

- (1) Këshilli nacional punon dhe vendos në mbledhje.
- (2) Këshilli nacional mund të vendos nëse në mbledhjen të pranishëm janë më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve, ndërsa vendimet i miraton me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm.
- (3) Puna e Këshillit nacional është publike.
- (4) Mënyra e punës së Këshillit nacional më afërsisht rregullohet me Rregullore për punë.
- (5) Këshilli nacional zgjedh kryetar me votim të fshehur nga radhët e anëtarëve gjatë periudhës prej dy viteve, pa të drejtë për zgjedhje të sërishme.
- (6) Kryetari i Këshillit nacional e përfaqëson dhe paraqet Këshillin.
- (7) Këshilli nacional mund të formojë trupa punues/komisione profesionale për nevojat e punës së vet.



(8) Kompensimin për punë dhe për shpenzime të anëtarëve të Këshillit nacional dhe për trupat punues/komisionet, e cakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në bazë të prezencës në mbledhjet dhe/ose vëllimit dhe kompleksitetit të punëve të kryera.

(9) Këshilli nacional një herë në vit parashtron raport për punën e vet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

(10) Punët profesionale, administrative dhe ndihmëse-teknike për nevojat e Këshillit nacional i kryen Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

### Seksioni 3

## AGJENCI PËR CILËSI NË ARSIMIN E LARTË

### Agjencia për cilësi në arsimin e lartë

#### Neni 45

(1) Agjencia për cilësi në arsimin e lartë (në tekstin e mëtejme: Agjencia për cilësi) është organ i pavarur profesional me zyrë në Shkup.

(2) Agjencia për cilësi në arsimin e lartë ka vulë e cila përmban mbishkrimin: Republika e Maqedonisë – Agjencia për cilësi në arsimin e lartë. Në mes të vulës gjendet stema e Republikës së Maqedonisë.

(3) Agjencia për cilësi ka llogari të veçantë.

(4) Mjetet për punë të Agjencisë për cilësi sigurohen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë dhe prej burimeve vetanake.

### Organet e Agjencisë për cilësi

#### Neni 46

(1) Organe të Agjencisë për cilësi janë:

- Bordi për akreditim të arsimit të lartë,
- Bordi për evaluim të arsimit të lartë dhe
- Drejtori i Agjencisë për cilësi të arsimit të lartë.

(2) Agjencia për cilësi ka shërbim profesional që i kryen punët profesionale, administrative dhe ndihmëse-teknike. Përbërja, organizimi dhe mënyra e punës së shërbimit profesional të Agjencisë për akreditim rregullohet me Rregullore të cilën e miraton drejtori i Agjencisë për cilësi.

#### Pjesa 1

## BORDI PËR AKREDITIM TË ARSIMIT TË LARTË

### Organi për akreditim të arsimit të lartë

#### Neni 47

(1) Bordi për akreditim të arsimit të lartë (në tekstin e mëtejme: Bordi për akreditim) është trup kolektiv që bën akreditimin.

(2) Bordi për akreditim përbëhet prej pesëmbëdhjetë anëtarëve dhe atë:

- gjashtë anëtarë nga radhët e profesorëve në marrëdhënie të punës në universitetet në Republikën e Maqedonisë të zgjedhur me votim të fshehur nga Konferenca Interuniversitare,

- gjashtë anëtarë të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, nga radhët e profesorëve në marrëdhënie të punës në universitetet publike në Republikën e Maqedonisë,  
- një anëtar i emëruar nga organizata më reprezentative e punëdhënësve,  
- një anëtar i emëruar nga Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve,  
- një anëtar nga radhët e studentëve të zgjedhur me votim të fshehur nga Konferenca Interuniversitare.

(3) Në mesin e anëtarëve të Bordit për akreditim të zgjedhur nga Konferenca Interuniversitare medoemos duhet të ketë së paku nga një anëtar nga radhët e profesorëve nga secila prej gjashtë fushave shkencoro-hulumtuese të nivelit të parë sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit (shkencat matematiko-natyrore; shkencat tekniko-teknologjike; shkencat mjekësore dhe shëndetësi; shkencat bujqësore dhe veterinare; shkencat shoqërore dhe shkencat humaniste).

(4) Anëtarë të Bordit për akreditim nuk mund të jenë persona të zgjedhur për rektor ose prorektor të universitetit, dekan ose prodekan të fakultetit, përkatësisht drejtor i shkollës së lartë profesional, drejtor i institucionit shkencor që ushtron veprimtari të arsimit të lartë, anëtar i Këshillit nacional ose anëtar i Bordit për evaluim.

(5) Anëtarët e Bordit për akreditim zgjedhen, përkatësisht emërohen për periudhë prej katër viteve, pa të drejtën për zgjedhje të sërishme.

(6) Me përjashtim të paragrafit (5) të këtij neni, anëtari i Bordit për akreditim nga radhët e studentëve zgjedhet për periudhë prej dy viteve, pa të drejtë për zgjedhje të sërishme.

(7) Anëtarët e Bordit nga paragrafi (2) i këtij neni të cilët janë nga radhët e profesorëve, të zgjedhur nga Konferenca Interuniversitare dhe të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë duhet të kenë publikuar së paku dhjetë punime shkencore në publikim shkencor referues, përveç profesorëve për lëndët artistike profesionale.

(8) Anëtarët e Bordit për akreditim janë të pavarur dhe autonom në punën e vet.

(9) Mandati i anëtarit të Bordit për akreditim ndërpritet në këto raste:

- vdekje e anëtarit të Bordit për akreditim ose paaftësi permanente për kryerjen e funksionit të tij;

- dorëheqje e anëtarit të Bordit për akreditim,

- nëse anëtarit të Bordit për akreditim i ndërpritet statusi profesor, përkatësisht anëtar i Akademisë Maqedonisë për shkencë dhe arte, përkatësisht student;

- nëse anëtari i Bordit për akreditim merr detyrën ose funksion që nuk ndërlidhet me funksionin anëtar i Bordit për akreditim, në pajtim me ligj dhe

– kur Bordi për akreditim konstaton se anëtari më shumë se gjashtë muaj nuk i kryen obligimet.

(10) Në rastet e paragrafit (9) të këtij neni, Drejtori i Agjencisë për cilësi e njofton institucionin që ka zgjedhur përkatësisht, emëruar anëtarin të zgjedh, përkatësisht të emërojë anëtar të ri.

### **Kompetencë e Bordit për akreditim**

#### **Neni 48**

(1) Bordi për akreditim është i pavarur në punën e vet dhe vendos në suaza të kompetencës së tij në bazë të parimeve të profesionalizmit dhe paanshmërisë.

(2) Bordit për akreditim në suazat e të drejtave dhe obligimeve që ka:

1. konstaton nëse me projektin për themelim të institucionit për arsim të lartë dhe dokumentacionin e parashtruar janë plotësuar kushtet për kryerje të veprimtarisë për arsim të lartë dhe përcakton kapacitetin e institucionit për arsim të lartë për studim,

2. miraton aktvendim për akreditim të projektit për themelim të institucionit të pavarur privat ose publiko-privat,

3. miraton aktvendim për akreditim të projektit për themelim të njësisë së institucionit të pavarur privat ose publiko-privat,

4. vendos për akreditim të institucionit shkencor për kryerje të veprimtarisë për arsim të lartë, në studime të ciklit të dytë dhe ciklit të tretë të studimeve,

5. verifikon plotësim të kushteve për organizim të studimeve për programe të reja studimore të institucionit të arsimit për arsim të lartë dhe e përcakton kapacitetin për studim të institucionit për arsim të lartë,

6. vendos për akreditim të programeve studimore për periudhë prej pesë viteve studimore,

7. vendos për akreditim të mentorëve në studime të doktoraturës,

8. në bazë të raporteve të evaluimit të jashtëm të institucioneve për arsim të lartë, e përcjell plotësimin e kushteve të institucioneve për arsim të lartë, të cilat janë akredituar dhe aprovuar për fillim me punë dhe në bazë të kësaj mund t'ua merr akreditimin,

9. miraton aktvendim për marrje të akreditimit të dhënë pas procedurës së zbatuar për marrjen e të drejtës për kryerje të veprimtarisë për arsim të lartë në pajtim me këtë ligj,

10. mban evidencë për institucionet e akredituara për arsim të lartë dhe për akreditime tjera të cilën detyrimisht e publikon në ueb faqen e Agjencisë për cilësi,

11. jep rekomandimet për përmirësimin e normativave dhe standardeve për kryerje të veprimtarisë për arsim të lartë,

12. në Këshillin nacional propozon Rregullore për metodologjinë, standardet dhe procedurën për akreditimin e institucioneve për arsim të lartë dhe për akreditimin e programeve studimore,

13. realizon bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e vet,

14. përpilon formular për parashtrimin e projektit për themelim të institucionit të pavarur autonom, publiko-privat ose privat për arsim të lartë,

15. përpilon formular të elaboratit për akreditim të programeve studimore,

16. kryen punë tjera të caktuara me ligje ose rregullë tjetër. (3)

(3) Bordi për akreditim mund të heq akreditim të programit studimor edhe para skadimit të periudhës për të cilën është dhënë akreditimi, në bazë të Propozimit të Bordit për evaluim.

(4) Bordi për akreditim e informon ministrin kompetent për punët e arsimit të lartë për akreditimet e miratuara dhe për çështje tjera dhe në çdo gjashtë muaj parashtron raport për punën e vet në ministrinë kompetente për punët nga arsimi i lartë dhe në Këshillin nacional. Formularin e raportit e përcakton ministri kompetent për punët në arsim të lartë.

(5) Raporti nga paragrafi (4) i këtij neni detyrimisht publikohet në ueb faqen e Agjencisë për cilësi dhe në ueb faqen e ministrisë kompetente për punët e arsimit të lartë.

### **Organizimi i punës së Bordit për akreditim**

#### **Neni 49**

(1) Puna e Bordit për akreditim, më afërsisht përkufizohet me rregullore për punë të cilën e miraton Bordi për akreditim.

(2) Bordi për akreditim e kryen akreditimin në pajtim me Rregulloren për standardet dhe procedurën për akreditim të institucioneve të arsimit të lartë dhe për akreditimin e programeve studimore të cilën e miraton Këshilli nacional për arsim të lartë.

(3) Bordi për akreditim punon dhe vendos në mbledhje.

(4) Bordi mund të vendos nëse në mbledhjen të pranishëm janë më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve, ndërsa vendimet i miraton me shumicë të votave të anëtarëve prezent.

(5) Mbledhjen konstituive e Bordit për akreditim e konvokon ministri kompetent për punët në arsim të lartë.

(6) Bordi për akreditim ka kryetar, i cili zgjedhet nga anëtarët e bordit me votim të fshehur, për periudhë prej dy viteve pa të drejtën për zgjedhje të sërishme.

(7) Bordi për akreditim nga radhët e anëtarëve formon komisione profesionale për nevojat e kryerjes së akreditimit. Nëse në Bordin nuk ka anëtar i cili është i kualifikuar për fushën, sferën ose materien e caktuar shkencore, Bordi në komisionet mund të angazhojë edhe persona të jashtëm profesional.

(8) Qeveria e Republikës së Maqedonisë i cakton llojin dhe lartësinë e kompensimeve për shpenzimet në procedurën e akreditimit në bazë të shpenzimeve reale, si dhe kompensimet e anëtarëve të Bordit për akreditim në bazë të prezencës në mbledhje dhe vëllimit të punës së kryer.

(9) Aktvendimet për akreditim të institucioneve të arsimit të lartë, aktvendimet për akreditim të programeve studimore dhe vendimet tjera të Bordit për akreditim publikohen në ueb faqen e Agjencisë për cilësi, më së voni në afat prej 15 ditëve nga dita e miratimit.

## Pjesa 2

### EVALUIMI I ARSIMIT TË LARTË

#### **Evaluimi i institucioneve të arsimit të lartë**

##### Neni 50

Evaluimi i institucioneve për arsim të lartë bëhet nëpërmjet:

1. evaluimit të jashtëm dhe
2. vetevaluimit.

#### **Evaluimi i jashtëm**

##### Neni 51

(1) Evaluimin e jashtëm e bëjnë komisione profesionale të zgjedhura nga ana e Bordit për evaluim të arsimit të lartë (në tekstin e mëtejme: Bordi për evaluim).

(2) Së paku dy e treta e komisionit profesional nga paragrafi (1) i këtij neni përbëhet prej profesorëve të universiteteve të vendeve anëtare të Shoqatës Evropiane për sigurim të cilësisë në arsim të lartë (European Association for Quality Assurance in Higher Education - ENQA).

(3) Standardet dhe procedura sipas të cilave bëhet evaluimi i jashtëm përkufizohen me Rregullore për standarde dhe procedurën për evaluim të jashtëm dhe vetevaluim, ndërkaq e cila duhet të jetë e harmonizuar me standardet dhe procedurat e pranuar në udhëzuesin (udhëzimet) të cilat aplikohen nga Shoqata Evropiane për sigurim të cilësisë në arsim të lartë (ENQA).

(4) Rregulloren nga paragrafi (3) të këtij neni e miraton Këshilli nacional për arsim të lartë, me propozim të Bordit për evaluim, ndërkaq në pajtim me Ministrin kompetent për arsim të lartë.

(5) Evaluim i jashtëm i institucionit për arsim të lartë bëhet:

1. sipas planit vjetor për punë të Bordit për evaluim ose
2. me kërkesë të parashtruar nga:
  - Këshilli nacional për arsim të lartë,
  - institucioni për arsim të lartë ose
  - ministri kompetent për arsim të lartë.

(6) Parashtruesit e kërkesës për evaluim të jashtëm nga paragrafi (5) pika 2 e këtij neni nuk mund sërish të parashtrojnë kërkesë për evaluim të jashtëm në të njëjtin institucion për arsim të lartë me kërkesë të tyre.

(7) Raportet nga evaluimi i jashtëm janë publike dhe publikohen në ueb faqen e Agjencisë për cilësi.

## **Bordi për evaluim të arsimit të lartë**

### Neni 52

(1) Bordi për evaluim të arsimit të lartë (në tekstin e mëtejme: Bordi për evaluim) është trup kolektiv profesional.

(2) Bordi për evaluim përbëhet prej pesëmbëdhjetë anëtarëve dhe atë:

- gjashtë anëtarë nga radhët e profesorëve në marrëdhënie të punës në universitetet në Republikën e Maqedonisë të zgjedhur nga Konferenca Interuniversitare me votim të fshehur,
- gjashtë anëtarë të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, nga radhët e profesorëve në marrëdhënie të punës në universitetet publike në Republikën e Maqedonisë,
- një anëtar i emëruar nga organizata me reprezentative e punëdhënësve,
- një anëtar i emëruar nga Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve,
- një anëtar nga radhët e studentëve të zgjedhur me votim të fshehur nga Konferenca Interuniversitare.

(3) Ndër anëtarët e Bordit për evaluim të zgjedhur nga Konferenca Interuniversitare medoemos duhet të ketë së paku nga një anëtar nga radhët e profesorëve nga secila prej gjashtë fushave shkencoro-hulumtuese të nivelit të parë sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit (shkencat matematiko-natyrore; shkencat tekniko-teknologjike; shkencat mjekësore dhe shëndetësi; shkencat bujqësore dhe veterinare; shkencat shoqërore dhe shkencat humaniste).

(4) Anëtarë të Bordit për evaluim nuk mund të jenë persona të zgjedhur për rektor ose prorektor të universitetit, dekan ose prodekan të fakultetit, përkatësisht drejtor i shkollës së lartë profesionale, drejtor i institucionit shkencor që ushtron veprimtari të arsimit të lartë, anëtar i Këshillit nacional ose anëtar i Bordit për akreditim.

(5) Anëtarët e Bordit për akreditim zgjedhen, përkatësisht emërohen për periudhë prej katër viteve, pa të drejtën për zgjedhje të serishme.

(6) Me përjashtim të paragrafit (5) të këtij neni, anëtari i Këshillit për evaluim nga radhët e studentëve zgjedhet për periudhë prej dy viteve, pa të drejtë për zgjedhje të serishme.

(7) Anëtarët e Bordit nga paragrafi (2) i këtij neni të cilët janë nga radhët e profesorëve, të zgjedhur nga Konferenca Interuniversitare dhe të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë duhet të kenë publikuar së paku dhjetë punime shkencore në publikimin shkencor referues, përveç profesorëve për lëndët artistike profesionale.

(8) Anëtarët e Bordit për akreditim janë të pavarur dhe autonom në punën e vet.

(9) Mandati i anëtarit të Bordit për akreditim ndërpritet në këto raste:

- vdekje e anëtarit të Bordit për akreditim ose paaftësi permanente për kryerjen e funksionit të tij;
- dorëheqje e anëtarit të Bordit për akreditim,
- nëse anëtarit të Bordit për akreditim i ndërpritet statusi profesor, përkatësisht anëtar i Akademisë Maqedonisë të Shkencave dhe Arteve, përkatësisht student;
- nëse anëtari i Bordit për akreditim merr detyrën ose funksion që nuk ndërlidhet me funksionin anëtar i Bordit për akreditim, në pajtim me ligj dhe
- kur Bordi për akreditim konstaton se anëtari më shumë se gjashtë muaj nuk i kryen obligimet.

(10) Në rastet e paragrafit (9) të këtij neni, Drejtori i Agjencisë për cilësi e njofton institucionin që ka zgjedhur përkatësisht, emëruar anëtarin të zgjedh, përkatësisht të emërojë anëtar të ri.

## **Kompetenca e Bordit për evaluim**

### Neni 53

(1) Bordi për evaluim:

1. në bazë të raportit të komisioneve për evaluim të institucioneve për arsim të lartë e përcjell veprimtarinë e institucioneve për arsim të lartë të cilëve u është dhënë akreditim dhe aktvendim për fillim me punë;

2. përcjell dhe vlerëson cilësinë e kryerjes së veprimtarisë për arsim të lartë, punën shkencorohulumtuuese, artistike dhe profesionale të kuadrit akademik të institucioneve për arsim të lartë, ndërkaq në veçanti të programeve të tyre studimore së paku në çdo pesë vite dhe në bazë të asaj i propozon Bordit për akreditim ta vazhdojë ose të merr akreditimin;

3. propozon Rregullore për standardet dhe procedurën për evaluim të jashtëm dhe vetevaluim nga Këshilli nacional për arsim të lartë;

4. jep rekomandime të nevojshme për përmirësimin e normativave dhe standardeve për kryerjen e veprimtarisë për arsim të lartë;

5. kryen edhe punë tjera në pajtim me Rregulloren për standardet dhe procedurën për evaluim të jashtëm dhe për vetevaluim;

6. kryen edhe punë tjera të caktuara me ligj.

(2) Bordi për evaluim në çdo gjashtë muaj parashtron raport për punën e vet në ministrinë kompetente për punët në arsim të lartë dhe në Këshillin nacional. Formularin e raportit e përcakton ministri kompetent për punët në arsim të lartë.

(3) Raporti nga paragrafi (2) i këtij neni detyrimisht publikohet në ueb faqen e Agjencisë për cilësi dhe në ueb faqen e ministrisë kompetente për punët e arsimit të lartë.

### **Organizimi dhe puna e Bordit për evaluim**

#### **Neni 54**

(1) Organizimi dhe puna e Bordit për evaluim, më afërsisht përkufizohen me rregullore të cilën e miraton Bordi për evaluim.

(2) Bordi për evaluim punon dhe vendos në mbledhje.

(3) Bordi mund të vendos nëse në mbledhje të pranishëm janë më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve, ndërkaq vendimet i merr shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm.

(4) Mbledhjen konstituive të Bordit për evaluim e konvokon ministri kompetent për punët në arsimin e lartë.

(5) Bordi për evaluim ka kryetar, të cilin e zgjedhin anëtarët me votim të fshehur për periudhë prej dy viteve, pa të drejtën për zgjedhje të sërishme.

(6) Qeveria e Republikës së Maqedonisë i përcakton llojin dhe lartësinë e kompensimeve për shpenzimet në procedurën e evaluimit në bazë të shpenzimeve reale, si dhe kompensimet e anëtarëve të Bordit për evaluim në bazë të prezencës në mbledhje dhe vëllimit të punës së kryer.

(7) Bordi për evaluim mund të formojë komisione, grupe të punës dhe trupa punues të tjerë për zbatimin e aktiviteteve të caktuara në kompetencë të vet.

### **Vetevaluimi**

#### **Neni 55**

(1) Vetevaluim i universitetit, njësisive të universitetit, përkatësisht të shkollës së lartë të pavarur profesionale, bën komisioni për vetevaluim të universitetit, përkatësisht të shkollës së lartë profesionale, në mënyrë dhe sipas kushteve të caktuara me statut të universitetit ose statutin e shkollës së lartë të pavarur profesionale.

(2) Anëtarët e komisioneve nga paragrafi (1) i këtij neni zgjedhen me votim të fshehur nga senati i universitetit, përkatësisht nga këshilli shkencor-mësimor, këshilli mësimor ose këshilli shkencor i njësisë së universitetit ose nga këshilli i mësimdhënësve i shkollës së lartë profesionale të pavarur, nga radhët e mësimdhënësve me mandat prej katër viteve dhe nga përfaqësuesit e studentëve gjatë periudhës prej një viti.

(3) Komisionet nga paragrafi (1) i këtij neni vetevaluimin e bëjnë sipas Rregullores për standardet për procedurën për evaluim të jashtëm dhe vetevaluim të cilën e miraton Këshilli nacional.

(4) Vetevaluimi zbatohet në intervale prej më së shumti tre viteve.

(5) Pjesë përbërëse e vetevaluimit është sondazh i studentëve për cilësinë e kuadrit të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve, që zbatohet në gjysmën e dytë të semestrit, përkatësisht vitit shkollor, për çdo lëndë veçmas, varësisht nëse bëhet fjalë për lëndë në një semestër apo dy semestra.

(6) Rezultatet nga vetevaluimi publikohen në ueb faqen e çdo njësie të universitetit veçmas (fakultet, shkollë e lartë profesionale ose institut shkencor), përkatësisht në ueb faqen e shkollës së lartë të pavarur profesionale.

### Pjesa 3

## DREJTORI I AGJENCISË PËR CILËSI

### **Kushte për emërim të drejtorit të Agjencisë për cilësi**

#### Neni 56

(1) Drejtorin e Agjencisë për cilësi e emëron dhe shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në bazë të konkursit publik të cilin e shpall Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

(2) Drejtori i Agjencisë për cilësi ka mandat prej katër viteve, me të drejtën për zgjedhje të sërishme.

(3) Për Drejtor të Agjencisë për cilësi mund të emërohet person i cili:

1. ka mbaruar së paku ciklin e parë dhe të dytë të studimeve akademike me së paku 300 kredi me shkallën VII A arsimore të Kornizës Nacionale për kualifikime,

2. ka së paku dhjetë vite përvojë pune në fushën e arsimit të lartë.

(4) Neto paga e drejtorit të Agjencisë për cilësi është në lartësi prej tre neto pagave mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë gjatë vitit të kaluar.

(5) Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë konstaton se mandati i Drejtorit të Agjencisë për cilësi është ndërprerë kur:

1. ka dhënë dorëheqje,

2. është emëruar ose shkarkuar në funksion ose detyrë që nuk përputhet me funksionin drejtor i Agjencisë, ose

3. me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor i është shqiptuar masa ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

(6) Drejtori i Agjencisë për cilësi mund të shkarkohet nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë para skadimit të mandatit në këto raste:

1. kur më tepër se gjashtë muaj nuk është në gjendje t'i kryejë obligimet, ose

2. për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit.

### **Kompetencat e drejtorit të Agjencisë për cilësi**

#### Neni 57

(1) Drejtori i Agjencisë për cilësi:

1. e përfaqëson dhe prezanton Agjencinë për cilësi,

2. kujdeset për zbatimin e vendimeve dhe aktvendimeve të Bordit për akreditim dhe Bordit për evaluim,

3. organizon dhe udhëheq shërbimin profesional të Agjencisë për cilësi,

4. kujdeset për punën materialo-financiare të Agjencisë,

5. vendos për të drejtat nga marrëdhëniet e punës për të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë për cilësi,

6. organizon dhe menaxhon ueb faqen e Agjencisë për cilësi
7. kujdeset për ligjshmërinë në punën e Agjencisë për cilësi dhe
8. kryen punë tjera të caktuara me ligj ose akt të përgjithshëm. Seksioni 4

#### Seksioni 4

### RANGIMI I UNIVERSITETEVE

#### **Rangimi i universiteteve**

##### Neni 58

(1) Për zhvillim dhe mirëmbajtje të cilësisë së arsimit të lartë në çdo tre vite detyrimisht bëhet rangim i të gjithë universiteteve, të regjistruara në regjistrin e institucioneve për arsim të lartë.

(2) Për zhvillim dhe mirëmbajtje të cilësisë në arsim të lartë, krahas rangimit nga paragrafi (1) i këtij neni, në çdo tre vite detyrimisht bëhet edhe rangim i veçantë i të gjitha institucioneve të pavarura shkencore të cilat kryejnë veprimtari të arsimit të lartë në pajtim me këtë ligj.

(3) Rangimet nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni i bën person juridik të cilin e zgjedh ministri kompetent për punët në arsim të lartë në procedurë për ndarje të marrëveshjes për furnizim publik në pajtim me Ligjin për furnizime publike.

(4) Personi juridik që do t'i zbatojë rangimet duhet t'i plotësojë këto kritere:

- të ketë vendosur sistem relevant për menaxhim me cilësi,
- të ketë së paku 15 persona të punësuar vazhdimisht në tituj shkencorë-mësimorë të cilët i mbulojnë të gjitha fushat shkencore, me përvojë minimum pesëvjeçare në proces të sigurimit të shërbimeve për konsultim në institucionet e arsimit të lartë ose institucione shtetërore dhe të kenë menaxhuar projekte shkencoro-hulumtuese në lidhje me aspekte të ndryshme të arsimit të lartë,
- të ketë në dispozicion së paku pesë bashkëpunëtorë të jashtëm me tituj shkencorë-mësimorë,
- të ketë bërë rangime të universiteteve dhe/ose institucioneve të arsimit të lartë në përbërje të universiteteve në së paku tre vende të Bashkimit Evropian,
- të ketë zhvilluar metodologji fleksibile në procesin e rangimit dhe
- rezultatet nga puna e vet t'i kenë shpallur publikisht.

(5) Universitetet dhe njësitë e universiteteve, si dhe institucionet e pavarura shkencore kanë për obligim personit juridik që i zbaton rangimet t'i japin të gjitha të dhënat e nevojshme për rangimet.

(6) Mjetet e nevojshme për rangimin e universiteteve dhe rangimin e institucioneve të pavarura shkencore sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(7) Rezultatet nga rangimet, nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni dhe kriteret në bazë të të cilave janë bërë rangimet janë në dispozicion për opinionin në afat prej tetë ditëve pas përpilimit të raportit për rezultatet nga rangimet me rang-listat, nëpërmjet publikimit në ueb faqen e ministrisë kompetente për punët në arsim të lartë.

(8) Ministria kompetente për punët në arsim të lartë është e obliguar në afat prej tetë ditëve pas pranimit ta parashtrijë raportin për rezultatet nga rangimet me rang-listat në të gjitha universitetet dhe institucionet e pavarura shkencore.

(9) Kriteret dhe mënyra e rangimit të universiteteve do të rregullohet me akt të veçantë të cilin e përcakton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.



## Kapitulli i gjashtë

### THEMELIMI DHE SHUARJA E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

#### Seksioni 1

#### SUBJEKTE TË CILAT MUND TË THEMELOJNË INSTITUCION PËR ARSIM TË LARTË

##### **Subjekte të cilat mund të themelojnë institucione për arsim të lartë**

###### Neni 59

(1) Institucion të pavarur publik për arsim të lartë themelon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me ligj.

(2) Njësi të universitetit publik themelon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me ligj.

##### **Subjekte që mund të themelojnë institucion publiko-privat joprofitabil dhe privat joprofitabil për arsim të lartë**

###### Neni 60

(1) Institucion privato-publik joprofitabil për arsim të lartë mund të themelojë fondacion joprofitabil i themeluar prej personit të huaj juridik ose fizik me mjete publike të siguruar prej burimeve të huaja dhe vendase sipas kushteve të caktuara me këtë ligj, në bazë të lejes nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(2) Institucion privat joprofitabil për arsim të lartë mund të themelojë person juridik ose fizik i huaj ose vendas, sipas kushteve të caktuara me këtë ligj, në bazë të lejes nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

#### Seksioni 2

#### KUSHTET PËR THEMELIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

##### **Kushtet për themelimin e institucionit të arsimit të lartë të pavarur**

###### Neni 61

(1) Institucioni i pavarur i arsimit të lartë mund të themelohet nëse:

1. është përcaktuar se sfera studimore dhe hulumtuese-shkencore, përkatësisht disiplina e artit për të cilat themelohet institucioni i arsimit të lartë, me ç'rast për përcaktimin e sferës studimore, përkatësisht disiplinës artistike shfrytëzohet Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit të UNESCO (MSKOB, ISCED) dhe Korniza nacionale e kualifikimeve, ndërsa gjatë përcaktimit të sferës shkencore hulumtuese shfrytëzohet Klasifikimi Ndërkombëtar i Fraskatit.

2. janë siguruar hapësira përkatëse dhe pajisje për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë, shkencore-hulumtuese dhe artistike, përkatësisht veprimtarisë profesionale,

3. me plan financiar është siguruar nivel i qëndrueshëm i financimit më së paku për një cikël të studimeve,

4. është siguruar numri i nevojshëm i personave të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara për zgjedhje të tituj mësimesorë-shkencorë, tituj shkencorë dhe mësimesorë të cilët kanë dhënë deklaratë të verifikuar në noter se do të paraqiten në konkurs dhe se do të themelojnë marrëdhënie pune, nëse në konkurs zgjidhen dhe

5. janë plotësuar edhe kushte të tjera të cilat janë të përcaktuara me normativat dhe standardet për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë.

(2) Kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni si normativa dhe standarde për themelimin e institucionit të pavarur të arsimit lartë dhe kryerjen e veprimtarisë së arsit të lartë përcaktohen me Rregullore për normativat dhe standardet për themelimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë (në tekstin e mëtejme: Rregullore për normativa dhe standarde), të cilën e miraton Këshilli Nacional për Arsim të Lartë.

(3) Kushti nga paragrafi (1), alineja 4 të këtij neni llogaritet si i plotësuar lidhur me universitetin, nëse në universitet janë punësuar persona të zgjedhur në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë në marrëdhënie pune me kohë të plotë të punës për realizimin e së paku 50% të orëve të mësimit në programe studimore për të cilat kërkohet akreditim (leje për punë), ndërsa së paku 10 persona me tituj shkencorë-mësimorë në marrëdhënie pune me kohë të plotë të punës për secilin nga fakultetet në përbërje të universitetit.

(4) Kushti nga paragrafi (1) alineja 4 të këtij neni llogaritet si i plotësuar lidhur me shkollën e lartë të pavarur profesionale nëse në shkollën e lartë profesionale të pavarur janë punësuar në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë në marrëdhënie pune me kohë të plotë të punës për realizimin e së paku 50% të orëve të mësimit të studimeve programorë për të cilat kërkohet akreditim (leje për punë), ndërsa së paku 10 mësimdhënës në marrëdhënie pune me kohë të plotë të punës.

### **Kushte për themelimin e universitetit**

#### **Neni 62**

(1) Universiteti mund të themelohet nëse në pajtim me kushtet e përcaktuara në nenin 61 të këtij ligji në përbërjen e vet ka së paku pesë njësi të akredituara prej të cilëve së paku tre janë fakultete.

(2) Gjatë themelimit të universitetit duhet të plotësohen kushtet për realizimin e programeve studimore së paku në ciklin e parë të arsimit të lartë.

(3) Për plotësimin e kushteve për realizimin e programeve studimore nga cikli i tretë vendoset pas marrjes së aktvendimit për akreditim të universitetit, aktvendimit për fillim me punë dhe përfundimit të së paku një gjenerate të studentëve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve.

(4) Programe studimore nga cikli i tretë i studimeve mund të organizojnë vetëm universitetet të cilat janë në mesin e shtatë universiteteve të para të ranguara, të regjistruar në regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë në shtet, të përcaktuar në rangimin e fundit në pajtim me nenin 58 të këtij ligji.

(5) Nëse universiteti e humb statusin e njërit prej shtatë institucioneve të para të ranguara në shtet në rangimin e ardhshëm, në këtë rast universiteti, përkatësisht njësitë e tij dhe anëtarët shoqërues nuk mund të regjistrojnë kandidatë të rinj në ciklin e tretë të studimeve të doktoraturës. Nëse universiteti, përkatësisht njësitë në përbërje të tij dhe anëtarët shoqërues regjistrojnë kandidatë të rinj, Bordi për akreditim detyrimisht miraton aktvendim për ndërprerjen e aktvendimit për akreditim për të gjitha ciklet për të cilat është i akredituar universiteti.

### **Kushtet për themelimin e shkollës së lartë të pavarur profesionale**

#### **Neni 63**

(1) Për themelim të shkollës së lartë të pavarur profesionale duhet të plotësohen kushtet për realizimin e programeve studimore së paku të ciklit të parë të arsimit të lartë me kohëzgjatja prej tre vitesh.

(2) Krahas kushtit të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, për themelimin e institucionit privat të pavarur të arsimit të lartë, nevojitet që themeluesi të paraqesë garanci të përvokueshme në thirrjen e parë me shumë prej 25% nga taksa shkollore për numrin e studentëve për të cilët

kërkohej leje për punë (ose akreditim) me të cilën do të garantojë se do t'i kompensojë mjetet të cilat studentët i kanë paguar në institucionin e arsimit të lartë që e ka ndërprerë punën dhe harxhimet tjera të cilat do t'i kenë studentët për shkak të transferimit të studimeve në institucionin e njëjtë ose të ngjashëm të arsimit të lartë në vend.

### Seksioni 3

## PROCEDURA PËR THEMELIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

### **Fillimi i procedurës për themelimin e institucionit të arsimit të lartë**

#### Neni 64

(1) Procedura për themelimin e institucionit të arsimit të lartë fillon me përpunimin e projektit për themelimin e institucionit të arsimit të lartë.

(2) Projektin për themelimin e institucionit të arsimit të lartë e përgatit Qeveria e Republikës së Maqedonisë, përkatësisht organi të cilin do ta autorizojë ajo.

(3) Projektin për themelimin e institucionit të arsimit të lartë privat ose privat-publik e përgatit themeluesi.

### **Projekti për themelimin e institucionit të arsimit të lartë**

#### Neni 65

(1) Projekti për themelimin e institucionit të arsimit të lartë në veçanti përmban:

- 1 arsyetim të shkaqeve dhe arsyzhmërinë për themelimin;
2. sferat studimore me përshkrimin e tyre si tërësi dhe grupe studimore, seksione dhe drejtime,
3. kushtet hapësinore dhe pajisje për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë, shkencore përkatësisht artistike dhe profesionale në sferë përkatëse,
4. burimin e mjeteve financiare për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë,
5. mundësinë për sigurimin e numrit të nevojshëm të personave të cilët mund të zgjidhen në tituj shkencorë-mësimorë, shkencorë dhe mësimorë dhe
6. planin për mënyrën në të cilën do të plotësohen kushtet tjera të cilat janë përcaktuar me Rregulloren për standardet për themelimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe për kryerjen e veprimtarisë së lartë arsimore të cilin e miraton Këshilli Nacional.

(2) Projekti për themelimin e universitetit i përmban të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni për të gjitha njësitë e universitetit.

(3) Me projektin për themelimin e institucionit të lartë të arsimit dorëzohen shtojca të përcaktuara me Rregulloren për normativa dhe standarde për themelimin e institucionit të arsimit të lartë dhe për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë të cilin e miraton Këshilli nacional për arsim të lartë.

(4) Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me akreditimin e projektit për themelimin e institucionit të arsimit të lartë zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në akreditimin për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë nga ana e institucionit shkencor.

(5) Projekti për themelimin e institucionit të arsimit të lartë dorëzohet në Bordin për akreditim të formularit përmbajtjen e të cilit e përcakton Bordi për akreditim.

(6) Projektin për themelimin e institucionit të arsimit të lartë me shtojcat, themeluesi i institucionit të arsimit të lartë privat përmes ministrisë kompetente për punët e arsimit të lartë e dorëzon në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për miratim.

(7) Pasi do ta marrë lejen nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë nga paragrafi (6) i këtij neni, themeluesi i institucionit të arsimit të lartë privat e dorëzon në Bordin për akreditim projektin për themelimin e institucionit të arsimit të lartë me shtojcat, duke përfshirë edhe lejen për themelim nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në formular përmbajtjen e të cilit e përcakton Bordi për akreditim.

(8) Për projektin për themelimin e institucionit të arsimit të lartë publik, Bordi për akreditim jep mendim.

(9) Për projektin për themelimin e institucionit të arsimit të lartë privat ose privat-publik, Bordi për akreditim miraton aktvendim për akreditim.

### **Aktvendimi për akreditimin e institucionit të arsimit të lartë privat ose privat-publik**

#### **Neni 66**

(1) Aktvendimin për akreditimin e projektit për themelimin e institucionit të arsimit të lartë privat ose privat-publik Bordi për akreditim e miraton për universitetin si tërësi dhe për çdo njësi të universitetit veçmas, përkatësisht për shkollën e lartë të pavarur private profesionale, më së voni në afat prej 90 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës për akreditim të projektit. Nëse këtë e kërkojnë rrethanat, Bordi për akreditim mund ta vazhdojë afatin më së shumti për 30 ditë, për çka e informon parashtruesin e projektit.

(2) Aktvendimi i Bordit për akreditim nga paragrafi (1) të këtij neni është përfundimtar.

(3) Kundër aktvendimit përfundimtar për kërkesën për akreditim të projektit për themelimin e institucionit të arsimit të lartë privat ose privat-publik nga paragrafi (1) i këtij neni mund të paraqitet padi në Gjykatën Administrative.

### **Akti për themelimin e institucionit të arsimit të lartë të pavarur**

#### **Neni 67**

(1) Pas marrjes së mendimit nga Bordi për akreditim të arsimit të lartë, propozimi për miratimin e ligjit për themelimin e institucionit të arsimit të lartë publik dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Pas miratimit të aktvendimit për akreditimin e projektit për themelimin e institucionit të arsimit të lartë privat, themeluesi miraton akt themelues, sipas tekstit i cili ka qenë i dorëzuar me projektin për themelimin e institucionit të arsimit të lartë.

### **Komisioni amë për themelimin e institucionit të arsimit të lartë të pavarur**

#### **Neni 68**

(1) Pas miratimit të ligjit për themelimin e institucionit të arsimit të lartë publik ose aktit për themelimin e institucionit të arsimit të lartë privat, ministri kompetent për punët e arsimit të lartë me propozim të Këshillit nacional emëron komision amë.

(2) Komisioni amë për themelimin e universitetit përbëhet nga pesë anëtarë për çdo njësi të universitetit. Anëtarët e komisionit amë emërohen nga radhët e profesorëve të rregullt të zgjedhur në sferën përkatëse shkencore, përkatësisht artistike, të cilët janë të punësuar në institucionet ekzistuese të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë. Nëse në Republikën e Maqedonisë nuk është zgjedhur profesor i rregullt në sferë të caktuar për të cilën formohet komisioni amë, anëtarët e komisionit amë mund të jenë profesorë të zgjedhur në sferë të ngjashme shkencore përkatësisht artistike në Republikën e Maqedonisë ose profesorë të zgjedhur në sferën e njëjtë ose të ngjashme shkencore në vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

(3) Komisioni amë për themelimin e shkollës së lartë të pavarur profesionale përbëhet prej pesë anëtarëve me titull shkencorë-mësimorë dhe/ose shkencorë në sferën shkencore, përkatësisht sferën artistike ose profesionin për të cilin themelohet, të cilët janë të punësuar në institucionet ekzistuese të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë.

(4) Komisioni amë i kryen punët përgatitore me të cilat krijohen kushte për fillimin e punës së institucionit të arsimit të lartë të akredituar dhe në ato suaza kryen:

- zgjedhje të mësimdhënësve
- lidh marrëveshje për punësimin e personave në shërbimin profesional dhe administrativ, dhe persona ndihmës teknik dhe
- punë të tjera që ia ka besuar themeluesi, që janë me rëndësi për fillimin e punës së institucionit të arsimit të lartë.

(5) Komisioni amë gjatë zgjedhjes së mësimdhënësve nuk mund të kryejë zgjidhje në tituj më të lartë shkencorë-mësimorë të kandidatëve.

### **Aktvendim për fillimin e punës së institucionit të arsimit të lartë**

#### **Neni 69**

(1) Pas përfundimit të përgatitjeve për fillimin e punës të institucionit të arsimit të lartë, themeluesi, përkatësisht organi i autorizuar prej tij, dorëzon kërkesë në ministrinë kompetente për punët e arsimit të lartë, për realizimin e këqyrjes për plotësimin e kushteve për fillimin e punës në institucionin e arsimit të lartë.

(2) Nëse konstatohet se numri i nevojshëm i personave janë zgjedhur në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë në pajtim me nenin 61, paragrafi (1), alineja 4 dhe paragrafët (3) dhe (4) të nenit të njëjtë edhe pse janë plotësuar edhe kushtet tjera të përcaktuar me këtë ligj dhe me aktvendim për akreditim, ministria kompetente për punët e arsimit të lartë në afat prej 60 ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton aktvendim për fillimin e punës së institucionit të arsimit të lartë (në tekstin e mëtejme: aktvendim për fillimin e punës), që është përfundimtar.

(3) Në aktvendimin për fillimin e punës përmenden:

- programe studimore
- numri i studentëve
- numri i mësimdhënësve të punësuar me kohë të plotë të punës dhe
- objektet në të cilat do të kryhet veprimtaria e arsimit të lartë.

(4) Nëse konstatohet se nuk janë plotësuar kushtet nga paragrafi (2) i këtij neni, ministria kompetente për punët e arsimit të lartë miraton aktvendim për refuzimin e fillimit të punës së institucionit të arsimit të lartë.

(5) Aktvendimi i paragrafit (4) të këtij neni është përfundimtar dhe kundër tij mund të paraqitet padi në Gjykatën Administrative.

(6) Në marrëveshjen për punësim të lidhur ndërmjet institucionit të arsimit të lartë dhe personave nga paragrafi (2) i këtij neni përcaktohet se ata do të fillojnë me punë më së voni një muaj nga dita kur institucioni i arsimit të lartë e ka pranuar aktvendimin për fillimin e punës. Nëse të gjithë këto persona nuk fillojnë me punë më së voni 30 ditë nga dita kur institucioni i arsimit të lartë e ka pranuar aktvendimin për fillim të punës, atëherë ministri kompetent për punët e arsimit të lartë e anulon aktvendimin për fillimin e punës.

(7) Institucioni i arsimit të lartë është i obliguar në afat prej 45 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit për fillimin e punës të dorëzojë dëshmi në ministrinë kompetente për arsimin e lartë se personat nga paragrafi (2) i këtij neni kanë themeluar marrëdhënie pune me institucionin e arsimit të lartë dhe kanë filluar punën në afatin e paraparë në paragrafin (6) të këtij neni. Nëse institucioni i arsimit të lartë nuk dorëzon dëshmi të tillë, atëherë aktvendimi për fillimin e punës anulohet.

(8) Akti për anulimin e aktvendimit për fillimin e punës i miratuar në bazë të paragrafëve (6) dhe (7) të këtij neni është përfundimtar dhe kundër tij mund të ngritet padi në Gjykatën Administrative.

(9) Dispozitat e këtij neni në mënyrë përkatëse zbatohen edhe për realizimin e programeve studimore jashtë selisë së institucionit të arsimit të lartë.

### **Regjistrimi në regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë**

#### **Neni 70**

Pas plotfuqishmërisë së aktvendimit për fillimin e punës së institucionit të arsimit të lartë, themeluesi paraqet kërkesë për regjistrim në institucionin e arsimit të lartë në regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë që e mban ministria kompetente për punët e arsimit të lartë.

### **Regjistri i institucioneve të arsimit të lartë**

#### **Neni 71**

(1) Ministria kompetente për punën e arsimit të lartë mban regjistër të institucioneve të arsimit të lartë.

(2) Në regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë nga paragrafi (1) i këtij neni mbahet evidencë e:

1. institucioneve të pavarura të arsimit të lartë,
2. njësitë e universiteteve,
3. institucionet shkencore të cilat janë të akredituara për kryerje të arsimit të lartë,
4. programet studimore
5. personat e zgjedhur në tituj shkencorë-mësimorë, shkencorë dhe mësimorë dhe tituj bashkëpunorësh,
6. të dhëna tjera të parapara me rregulloren për regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë.

(3) Regjistri i paragrafit (1) të këtij neni mbahet në kushte të përcaktuara me këtë ligj dhe rregulloren për regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë, që e miraton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

(4) Me rregulloren nga paragrafi (3) të këtij neni rregullohet mënyra e regjistrimit, përmbajtja, forma e përmbledhjes së formularëve për regjistrim, mënyra e shpalljeve të regjistrimeve, dokumentet dhe provat që dorëzohen me kërkesën, udhëheqja informatike e regjistrit, lidhshmëria me Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Regjistri Qendror) dhe çështje tjera me rëndësi për udhëheqje të rregullt të regjistrit.

### **Konstituimi i organeve të institucioneve të pavarura të arsimit të lartë**

#### **Neni 72**

Pas regjistrimit të kryer të institucionit të pavarur të arsimit të lartë në regjistrimin e institucioneve të arsimit të lartë konstituohet senati dhe zgjidhet rektori i universitetit, përkatësisht konstituohet këshilli i mësimdhënësve dhe zgjidhet drejtori i shkollës së lartë të pavarur profesionale.

### **Konstituimi i organeve të njësisë së universitetit**

#### **Neni 73**

(1) Pas regjistrimit të kryer të njësisë së universitetit në regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë konstituohet këshilli mësimor-shkencor dhe zgjidhet dekani i fakultetit, përkatësisht konstituohet këshilli i mësimdhënësve dhe zgjidhet drejtori i shkollës së lartë profesionale.

(2) Në rast kur me ligj themelohet njësi e universitetit deri në zgjedhjen e dekanit, përkatësisht drejtorit në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, menjëherë pas hyrjes në fuqi të ligjit me të cilin themelohet njësia e universitetit, rektori emëron ushtrues të detyrës dekan, përkatësisht ushtrues të detyrës drejtor i cili e kryen detyrën më së shumti gjashtë muaj nga dita e emërimit të tij.

### **Regjistrimi në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë**

#### **Neni 74**

(1) Pas konstituimit dhe zgjedhjes së organeve të universitetit dhe të njësive të tij, përkatësisht të shkollës së lartë profesionale të pavarur, bëhet regjistrimi i universitetit, njësive të universitetit dhe shkollës së lartë profesionale të pavarur në Regjistrin qendror.

(2) Pas regjistrimit të institucionit të arsimit të lartë në Regjistrin Qendror, institucioni i arsimit të lartë mund të kryejë regjistrim të studentëve në vitin e parë të studimeve.

### **Llojet e ndryshimeve të statusit të universiteteve**

#### **Neni 75**

(1) Universitetet mund të bashkohen, ndahen ose të bashkëngjiten, nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj, Ligjin për institucionet dhe statutin e universitetit.

(2) Bashkimi ose bashkëngjitja bëhet me marrëveshje për bashkim ose bashkëngjitje, ndërsa ndarja me vendim për ndarje.

(3) Universitetet të cilat bashkohen e ndërpresin punën, ndërsa njësitë e universiteteve që bashkohen vazhdojnë me punë si njësi të universitetit i cili krijohet me bashkim, përveç nëse me marrëveshjen për bashkim nuk është përcaktuar se ndonjëra, përkatësisht të gjitha njësitë e universiteteve që bashkohen hyjnë në përbërje të ndonjëres prej njësive të universiteteve që bashkohen. Vendime për miratimin e marrëveshjes për bashkim miratojnë me votim sekret dhe me 2/3 të shumicës nga numri i plotë i anëtarëve, senatet e universitetit të cilat bashkohen me pëlqim paraprak prej 2/3 të njësive të universitetit të cilat bashkohen. Pëlqim për marrëveshje japin themeluesit e universiteteve. Ndryshimi statusor hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ndryshimeve për ndryshimin e aktit, përkatësisht akteve për themelimin e universitetit, përkatësisht universiteteve me të cilat ka të bëjë ndryshimi i statusit.

(4) Universiteti i cili i bashkëngjitet universitetit tjetër e ndërpret punën dhe njësitë e universitetit që i bashkëngjitet vazhdojnë me punë si njësi e universitetit të cilit universiteti i bashkëngjitet, përveç nëse me marrëveshjen për bashkëngjitje nuk është përcaktuar se ndonjëra përkatësisht të gjitha njësitë e universitetit që bashkëngjitet hyn, përkatësisht hyjnë në përbërje të njësisë ekzistuese të universitetit të cilit universiteti i bashkëngjitet. Vendime për miratimin e marrëveshjes për bashkëngjitje të njërit universitet ndaj tjetrit miratohen me votim sekret dhe me 2/3 e shumicës nga numri i plotë i anëtarëve, senatit të universitetit i cili bashkëngjitet dhe senatit të universitetit të cilit i bashkëngjitet me pëlqim paraprak prej 2/3 të njësive të universitetit. Pëlqim për marrëveshje japin themeluesit e universiteteve. Ndryshimi statusor hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të ndryshimit të aktit, përkatësisht akteve për themelimin e universitetit, përkatësisht universiteteve me të cilat ka të bëjë ndryshimi i statusit.

(5) Universiteti mund të ndahet në dy ose më shumë universitete nëse pas ndarjes universitetet që krijohen me ndarje i plotësojnë kushtet për themelimin e universitetit të përcaktuar me këtë Ligj. Njësitë e universitetit i cili ndahet vazhdojnë me punë si njësi të universiteteve të cilat krijohen me ndarjen. Vendimin për ndarje e miraton senati i universitetit me votim sekret dhe me 2/3 e shumicës nga numri i plotë i anëtarëve të senatit, me pëlqim paraprak të 2/3 të njësive të

universitetit. Pëlqim të vendimit jep themeluesi i universitetit. Ndryshimi statusor hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të ndryshimit të aktit, përkatësisht akteve për themelimin e universitetit, përkatësisht universiteteve me të cilat ka të bëjë ndryshimi i statusit.

### **Ndryshime statusore të njësive të universitetit**

#### **Neni 76**

(1) Njësia e universitetit mund të bashkëngjitet nga një në universitetin tjetër. Vendimi për miratimin e marrëveshjes për bashkëngjitje miratohet me votim sekret dhe me 2/3 të shumicës nga numri i plotë i anëtarëve, senatit të universitetit të njësisë së universitetit që bashkëngjitet dhe senati i universitetit të cilit i bashkëngjitet njësia, me pëlqim paraprak prej 2/3 të njësive të universitetit. Pëlqim për marrëveshjen japin themeluesit e universiteteve. Ndryshimi statusor hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ndryshimeve për ndryshimin e aktit, përkatësisht akteve për themelimin e universitetit, përkatësisht universiteteve me të cilat ka të bëjë ndryshimi i statusit.

(2) Njësia e cila i bashkëngjitet vazhdon me punë si njësi e universitetit të cilit i bashkëngjitet, përveç nëse me marrëveshje për bashkëngjitje nuk është përcaktuar se hynë në përbërje të njësisë ekzistuese të universitetit të cili bashkëngjitet.

(3) Ndryshime statusore mund të kryejnë edhe njësitë në përbërje të universitetit të njëjtë, përkatësisht të bashkohen ndahen dhe bashkëngjiten.

(4) Vendim për miratimin e marrëveshjes për bashkim ose bashkëngjitje miraton senati i universitetit me votim sekret dhe me 2/3 të shumicës nga numri i plotë i anëtarëve, me pëlqim paraprak të këshillit mësimor-shkencor të njësive që e kanë lidhur marrëveshjen. Për dhënien e pëlqimit për ndryshimet statusore, këshilli mësimor-shkencor vendos me votim të fshehtë edhe me 2/3 e shumicës nga numri i plotë i anëtarëve. Pëlqim për marrëveshje jep themeluesi i universitetit. Ndryshimi stasor hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ndryshimeve për ndryshimin e aktit të universitetit, më të cilin ka të bëjë ndryshimi i statusit.

(5) Vendimi për ndarjen e njësisë së universitetit miratohet me votim sekret dhe me 2/3 të shumicës nga numri i plotë i anëtarëve të senatit, me pëlqim paraprak të këshillit mësimor-shkencor të njësisë e cila ndahet. Për dhënien e pëlqimit për ndryshimet statusore, këshilli mësimor-shkencor vendos me votim të fshehtë edhe me 2/3 e shumicës nga numri i plotë i anëtarëve. Pëlqimin e marrëveshjes e jep themeluesi i universitetit. Ndryshimi statusor hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ndryshimeve për ndryshimin e aktit për themelimin të universitetit, me të cilin ka të bëjë ndryshimi i statusit.

### **Llojet e ndryshimeve statusore të shkollës së lartë të pavarur profesionale**

#### **Neni 77**

(1) Shkolla e lartë e pavarur profesionale mund t'i bashkëngjitet universitetit.

(2) Bashkëngjitja bëhet me marrëveshje për bashkëngjitje. Vendimin për miratimin e marrëveshjes për bashkëngjitje e sjellin me votim sekret dhe 2/3 e shumicës nga numri i plotë i anëtarëve, senatit të universitetit dhe organit drejtues të shkollës së lartë të pavarur profesionale e cila bashkëngjitet, me pëlqim paraprak prej 2/3 të njësive të universitetit. Pëlqim për marrëveshjen japin themeluesi i universitetit dhe themeluesi i shkollës së lartë të pavarur profesionale. Ndryshimi statusor hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ndryshimeve për ndryshimin e aktit për themelimin e universitetit dhe aktit për themelimin e shkollës së lartë profesionale, me të cilat ka të bëjë ndryshimi i statusit.



(3) Shkolla e lartë profesionale e cila bashkëngjitet vazhdon të punojë si njësi e universitetit ndaj të cilit bashkëngjitet, përveç nëse me vendim të bashkëngjitetes nuk është e përcaktuar se hyn në përbërje të njësisë ekzistuese të universitetit të cilit i bashkëngjitet.

(4) Paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni në mënyrë përkatëse zbatohen dhe për bashkëngjitje nga njëra në shkollën tjetër të lartë profesionale të pavarur.

### **Regjistrimi i ndryshimeve statusore në Regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë në Regjistrin Qendror**

#### **Neni 78**

Ndryshimet statusore regjistrohen në Regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë dhe në Regjistrin Qendror

### **Procedura dhe pasoja juridike nga ndryshimet statusore**

#### **Neni 79**

(1) Bordi për akreditim jep mendim paraprak të marrëveshjes, përkatësisht vendimit për ndryshimet statusore të neneve 75,76 dhe 77 të këtij Ligji.

(2) Në rast të cilitdo ndryshimi statusor, të përcaktuar me këtë ligj, studenti ka të drejtë t'i përfundojë studimet sipas kushteve në institucionet e arsimit të lartë në të cilin ka qenë i regjistruar para zbatimit të ndryshimit statusor.

(3) Në rast të bashkimit, përkatësisht ndarjes së universiteteve, përkatësisht shkollave të larta profesionale të pavarura zbatohet procedura për lëshimin e aktvendimit për fillimin me punë në mënyrën dhe sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj për themelimin e institucionit të arsimit të lartë.

(4) Në rast të bashkëngjitetes bëhet plotësimi i aktvendimit të lëshuar për akreditim dhe i aktvendimit për fillimin me punë, sipas kushteve dhe procedurës të përcaktuar me këtë ligj.

(5) Universiteti, përkatësisht shkolla e lartë profesionale e pavarur të cilit/cilës i bashkëngjitet dhe i merr të drejtat dhe obligimet e institucionit të arsimit të lartë i cili bashkëngjitet.

(6) Me bashkëngjitje dhe me bashkim të universitetit, përkatësisht shkollë të lartë profesionale, shuhet pa likuidim universiteti, përkatësisht shkolla e lartë profesionale e pavarur e cila bashkëngjitet, përkatësisht bashkohet dhe bëhet bartje e pronës së plotë të tyre dhe të obligimeve mbi universitetin, përkatësisht shkollën e lartë profesionale të pavarur e cila bashkohet, përkatësisht e cila krijohet me bashkimin, me gjendjen në ditën e përcaktuar me marrëveshje për bashkëngjitje, përkatësisht bashkim.

(7) Me ndarjen e universitetit që ndahet shuhet pa likuidim dhe bëhet bartja e pronës së tij të plotë dhe e obligimeve mbi universitetet që krijohen me ndarje, me gjendjen në ditën e përcaktuar me vendimin për ndarje.

(8) Me obligime nga paragrafët (5), (6) dhe (7) të këtij neni, nënkuptohen edhe obligimet ndaj studentëve për vazhdimin e studimeve sipas kushteve në të cilat i kanë filluar para ndryshimit statusor.

(9) Universiteti i cili është krijuar me bashkimin ose me ndarje, përkatësisht universiteti të cilit i është bashkëngjitur ose shkolla e lartë profesionale e pavarur, janë debitorë solidarë të kreditorëve të universiteteve dhe njësisive të tyre, përkatësisht të shkollës së lartë profesionale të pavarur të cilat janë bashkuar, bashkëngjitur ose janë ndarë.

#### Seksioni 4

### SHUARJA E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

#### **Shuarja e institucionit të arsimit të lartë publik për shkak të ndërprerjes së nevojës së ekzistimit**

##### Neni 80

(1) Propozim për shuarje të institucionit të arsimit të lartë publik ose njësia në përbërje të tij mund të japë parashtruesi i autorizuar i propozimit për themelim me arsytimin e shkaqeve të cilat kanë sjellë deri në ndërprerjen e nevojës për ekzistimin e institucionit të arsimit të lartë publik, përkatësisht njësisë së tij.

(2) Parashtruesi i autorizuar për ndërprerjen e institucionit të lartë të pavarur publik ose njësia e tij i dorëzojnë në senatin e universitetit dhe në këshillin mësimor - shkencor të fakultetit ose të këshillit i mësimdhënësve në shkollën e lartë profesionale, dhe u jep afat prej së paku 90 ditësh që të prononcohen për propozimin.

(3) Kur propozimi është për shuarjen e njësisë së institucionit të arsimit të lartë, senati mund të sjellë vendim për mbajtjen e njësisë ashtu që të sigurojë mjete për vazhdimin e punës me burime personale të financimit.

(4) Kur propozimi është për shuarjen e institucionit të arsimit të lartë të pavarur, senati i universitetit përkatësisht këshilli i mësimdhënësve i shkollës së lartë profesionale të pavarur mund të sjellë vendim për vazhdimin e punës nga burimet personale të financimit.

(5) Nëse senati i universitetit, përkatësisht këshilli i mësimdhënësve i shkollës së lartë profesionale të pavarur, e informon themeluesin se nuk ekzistojnë kushte për kryerjen e mëtejme të veprimtarisë së arsimit të lartë nga ana e njësisë, përkatësisht institucionit të arsimit të lartë të pavarur, Qeveria i dorëzon Kuvendit propozim për miratim të ligjit për shuarje të universitetit, shkollës së lartë profesionale të pavarur, fakultetit, shkollës së lartë profesionale, përkatësisht institutit shkencor.

(6) Në propozimin për miratimin e ligjit të paragrafit (5) të këtij neni rregullohet mënyra me të cilën studentët mund ta vazhdojnë studimin.

(7) Pas miratimit të ligjit nga paragrafi (5) i këtij neni, ministri kompetent për punët e arsimit të lartë miraton aktvendim për shlyerjen e institucionit nga regjistri i institucioneve të arsimit të lartë edhe për këtë e informon Regjistrin Qendror.

#### **Shuarja e institucionit të arsimit të lartë publik ose privat për shkak të ndërprerjes së nevojës së ekzistimit**

##### Neni 81

(1) Kur organi i themeluesit do të përcaktojë se është ndërprerë nevoja për kryerjen e veprimtarisë së lartë arsimor për institucion të arsimit të lartë të caktuar të pavarur privat, ose njësi të universitetit privat, ose nuk është në gjendje ta financojë veprimtarinë e vet, e informon për shkaqet organin drejtues të institucionit të arsimit të lartë dhe bashkëthemeluesit tjerë ose bashkëpronarët ose aksionarët kur themelues është personi juridik dhe u jep afat prej më së paku 30 ditë që të vendosin nëse institucioni i arsimit të lartë do të vazhdojë me punë me sigurimin e burimeve të veta të mjeteve financiare, përkatësisht nëse financimin e institucionit të arsimit të lartë do ta merr njërin nga bashkëthemeluesit, nëse institucionin e arsimit të lartë e kanë themeluar dy ose më shumë themelues, ose njëri nga bashkëpronarët ose aksionarët, nëse themelues i institucionit të arsimit të lartë është një person juridik.

(2) Nëse organidrejtues, përkatësisht bashkëthemeluesi, bashkëpronari ose aksionari nga paragrafi (1) e informon themeluesin se nuk ekzistojnë kushte për kryerje të mëtejme të veprimtarisë së lartë arsimore me burime personale të financimit ose me mjete të njërit nga themeluesit, përkatësisht bashkëpronarit ose aksionarit, themeluesi miraton vendim për shuarje të institucionit të arsimit të lartë.

(3) Nëse mjetet që themeluesi i ka siguruar për kryerjen e garancive të dhëna nuk janë të mjaftueshme për realizimin e të drejtës së studentëve që ta vazhdojnë shkollimin, themeluesi për plotësimin e garancive të dhëna përgjigjet pa kufizime me pronën e tij të plotë.

(4) Pas miratimit të vendimit për ndërprerjen e punës së institucionit të arsimit të lartë, ministria kompetente për punët e arsimit të lartë sjell vendim për shlyerjen e institucionit nga regjistri i institucioneve të arsimit të lartë dhe paraqet kërkesë për shlyerjen e institucionit të arsimit të lartë nga Regjistri Qendror.

(5) Në rast të ndërprerjes së punës të institucionit të arsimit të lartë privat kur është i plotësuar kushti nga paragrafi (2) i këtij neni, ose kur i është hequr akreditimi dhe kur është miratuar aktvendimi për heqjen e të drejtës së kryerjes së veprimtarisë së lartë arsimore në pajtim me nenin 84 paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji, ministria kompetente për punët e arsimit të lartë, me propozim të Bordit për akreditim, do të sjellë vendim me të cilin do të sigurohet përfundimi i studimeve në institucionin e arsimit të lartë i cili është në likuidim ose transferimi i studentëve në institucion tjetër të arsimit të lartë në vendin i cili ka programe studimore të njëjta ose të ngjashme. Me vendimin do të aktivizohet edhe garancia financiare të cilën e ka dhënë themeluesi që të mundet të kompensohen mjetet të cilat studentët ia kanë paguar institucionit të arsimit të lartë i cili e ka ndërprerë punën dhe harxhimet tjera të cilat i kanë studentët për shkak të përfundimit të studimeve.

(6) Dispozitat e paragrafëve prej (1) deri (5) të këtij neni në mënyrë përkatëse zbatohen edhe për shuarje të institucionit të arsimit të lartë privat-publik.

### **Falimentimi i institucionit të arsimit të lartë**

#### **Neni 82**

(1) Mbi institucionin e arsimit të lartë publik të pavarur nuk zbatohet falimentim.

(2) Institucioni i arsimit të lartë të pavarur privat mund të shuhet me falimentimin në pajtim me Ligjin për institucione dhe Ligjin për falimentim.

(3) Garancia bankare që në pajtim me këtë ligj e jep themeluesi i institucionit të arsimit të lartë privat nuk hyn në masën e falimentimit dhe shfrytëzohet ekskluzivisht për dedikimin për të cilin është dhënë në pajtim me këtë ligj.

(4) Nëse mjetet nga garancia bankare që në pajtim me këtë ligj e ka dhënë themeluesi i institucionit privat të arsimit të lartë të pavarur dhe mjetet nga masa e falimentimit nuk janë të mjaftueshme për kompensim të mjeteve që studentët i kanë paguar në institucionin e arsimit të lartë i cili ka ndërprerë punën dhe për harxhime të tjera që i kanë studentët për shkak të transferimit të studimeve në institucion të arsimit të lartë të njëjtë ose të ngjashëm në vend, themeluesi përgjigjet pa kufizime me pronën e plotë të tij në pajtim me Ligjin për falimentim dhe Ligjin për institucione.

### **Baza të tjera për shuarjen e institucionit të arsimit të lartë**

#### **Neni 83**

(1) Institucioni i arsimit të lartë shuhet, nëse:

- e ndërpret plotësimin e kushteve për themelimin e institucionit të arsimit të lartë të për caktuara në nenin 61 paragrafi (1) dhe nenin 62 paragrafi (1) të këtij ligji,

-ministri kompetent për punët e arsimit të lartë ka sjellë vendim për heqjen e të drejtës për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë, në bazë të vendimit të Bordit për akreditim për heqjen e akreditimit nga neni 84 paragrafi (4) i këtij ligji,

- me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor përcaktohet pavlefshmëria e regjistrimit në regjistër,
- kryen ndryshime statusore pasoja e të cilave është shuarja e institucionit të arsimit të lartë.

(2) Institucioni i arsimit të lartë publik shfuqizohet me ligj, kurse institucioni i arsimit të lartë privat ose privat-publik shfuqizohet me vendim të themeluesit.

(3) Me aktin për shuarje të universitetit përcaktohet nëse disa njësi të universitetit do të vazhdojnë me punë dhe do t'i bashkëngjiten ndonjë universiteti tjetër ose do të vazhdojnë të punojnë si institucione të arsimit të lartë të pavarura.

### **Heqja e të drejtës për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë**

#### **Neni 84**

(1) Ministria kompetente për punët e arsimit të lartë, themeluesi dhe Bordi për akreditim mund të ngrejnjë procedurë për heqjen e të drejtës për kryerjen e veprimtarisë së lartë arsimore në institucion të arsimit të lartë, ndërsa për heqjen e të drejtës për kryerjen e veprimtarisë së lartë arsimore të njësisë në përbërje të vet, procedurë mund të ngrejnjë edhe vetë universiteti.

(2) Procedura nga paragrafi (1) i këtij neni mbahet para Bordit për akreditim.

(3) Nëse Bordi për akreditim, në bazë të raportit të Bordit për evaluim, përcakton se institucioni i arsimit të lartë ka ndërprerë plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 61 paragrafi (1) alineja 4 neni 62 paragrafi (1) të këtij ligji për kryerjen e veprimtarisë së lartë arsimore, me sugjerim me shkrim do ta obligojë institucionin e arsimit të lartë që t'i mënjanojë mangësitë, dhe Bordi për akreditim e informon edhe universitetin nëse institucioni i arsimit të lartë është njësi e tij.

(4) Nëse në afat të përcaktuar nga Bordi për akreditim, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 60 ditë dhe më i gjatë se 120 ditë nga dita e marrjes së sugjerimit me shkrim nga paragrafi (3) i këtij neni, institucioni i arsimit të lartë nuk i mënjanon mangësitë për të cilat i është sugjeruar, Bordi për akreditim në afat prej 15 ditësh miraton vendim për heqjen e akreditimit të dhënë dhe menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej tri ditëve nga miratimi i vendimit për heqjen e akreditimit e informon ministrinë kompetent për punët në arsimin e lartë.

(5) Në bazë të vendimit për heqjen e akreditimit, ministria kompetente për punët e arsimit të lartë në afat prej 10 ditësh nga marrja e të njëjtës, miraton vendim për heqjen e të drejtës për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë, i cili është përfundimtar. Pas miratimit të vendimit ministria kompetente për punën e arsimit të lartë e shlyen institucionin e arsimit të lartë nga regjistri i institucionit të arsimit të lartë dhe parashtron kërkesë për shlyerjen e tij në Regjistrin Qendror.

(6) Kundër vendimit përfundimtar të ministrisë kompetente për punët e arsimit të lartë nga paragrafi (5) i këtij neni, mund të parashtrohet padi në Gjykatën Administrative.

#### **Kapitulli i shtatë**

### **ORGANIZIMI I BRENDSHËM I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË DHE FORMAT E BASHKËPUNIMIT**

#### **Seksioni 1**

### **ORGANIZIMI I BRENDSHËM I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË**

#### **Organizimi i brendshëm i institucioneve të arsimit të lartë**

#### **Neni 85**

(1) Organizimi i brendshëm i institucioneve të arsimit të lartë rregullohet me këtë ligj dhe me statutin e institucionit të arsimit të lartë.

(2) Universiteti i cili në përbërjen e vet ka njësi të sferave të ndryshme studimore mund t'i organizojë njësitë e universitetit në sfera universitare, seksionet ose format tjera.

(3) Njësia e universitetit për kryerjen e veprimtarisë së vet mund të organizojë institut, qendër, ent, katedër, seksion dhe njësi të tjera të brendshme organizative, me kushte të përcaktuara me statutin e universitetit.

(4) Universiteti, në kushtet e përcaktuara me ligj dhe me statut, krahas njërive në përbërje të vet mund të ketë edhe njësi të tjera të brendshme organizative me të cilat ndërlidhet praktika, njohuria, arti dhe arsimit i lartë dhe në emër të të cilit mund të marrin pjesë studentët (qendrat kulturore studentore, byrotë inxhinierike, punëtoritë, qendrat për këshilla juridike dhe të biznesit, qendra për punë sociale dhe ndihmë tjetër sociale të qytetarëve, qendra prodhuese provuese, galeri, radio dhe TV stacione etj.) dhe parqe teknologjike.

(5) Universiteti mundet në kushtet e përcaktuara me ligj dhe me statutin e universitetit për kryerjen e veprimtarisë së vet të organizojnë qendra klinike studentore, poliklinikë studentore, qendër sportive studentore, qendër klinike universitare të veterinarisë, institucione agrare universitare, qendra për hulumtim dhe arsim të vazhdueshëm si mësim të përjetshëm dhe forma të tjera të veprimtarisë së njësive.

(6) Për shkak të kryerjes së veprimtarisë së vet universiteti mund të lidh marrëveshje me klinikat universitare dhe institucionet tjera kur është ajo e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së lartë arsimore ose me institucione të tjera dhe shoqëri tregtare veprimtaria e të cilave është me rëndësi për kryerjen e veprimtarisë së universitetit dhe për kryerjen e veprimtarisë aplikative të nivelit të lartë.

### **Qendra për karrierë**

#### **Neni 86**

(1) Universiteti themelon më së paku një qendër për karrierë. Qendra për karrierë mban evidencë të veçantë për studentët e mëparshëm (alumnë), organizon panairë për karrierë në çdo fakultet/universitet ku ka qendër për karrierë dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me statutin e universitetit.

(2) Puna në qendrën për karrierë rregullohet me akt të përgjithshëm që e miraton senati i universitetit, në pajtim me statutin e universitetit.

### **Themelimi i organizatave tjera**

#### **Neni 87**

(1) Universiteti, njësia e universitetit përkatësisht shkolla e lartë profesionale e pavarur, mundet në kushte të përcaktuara me ligj dhe me statut për shkak të bartjes së të drejtave të pronësisë intelektuale që dalin nga veprimtaria e tyre, në veçanti nga puna shkencore-hulumtuese dhe krijimi i veprave autoriale, për shkak të kryerjes së shërbimeve të tjera të autorizimeve publike, bartje të njohurive shkencore dhe profesionale dhe realizime të tjera në kryerjen e punëve aplikative, për kryerjen e veprimtarisë botuese, për mbrojtjen shëndetësore të studentëve, për vendosje dhe ushqim, për nevoja kulturore, sport dhe rekreacion të studentëve dhe të punësuarve në institucionin e arsimit të lartë dhe për nevoja të tjera, në mënyrë të pavarur ose me bashkëthemelues të themelojë shoqëri tregtare ose institucion në kushte të përcaktuara me ligj dhe statut.

(2) Këto nevoja universiteti, njësia e universitetit përkatësisht shkolla e lartë profesionale e pavarur mund në bazë më të gjatë t'i realizojnë me marrëveshje me persona juridikë dhe fizikë.

(3) Fitimi i shoqërisë tregtare që i takon institucionit të arsimit të lartë në bazë të investimit, përkatësisht të hyrave të institucionit nga paragrafi (1) i këtij neni mund të shfrytëzohen ekskluzivisht për përparimin e veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë i cili ka marrë pjesë në krijimin e tij.

## **Shërbimi profesional dhe administrativ**

### **Neni 88**

(1) Për kryerjen e punëve profesionale dhe administrative të institucionit të arsimit të lartë formohet shërbim profesional dhe administrativ.

(2) Organizimi i brendshëm i shërbimit profesional dhe administrativ rregullohet me statutin e institucionit të arsimit të lartë.

### **Seksioni 2**

## **FORMAT E BASHKËPUNIMIT**

### **Format e bashkëpunimit të institucioneve të arsimit të lartë**

### **Neni 89**

(1) Për shkak të shqyrtimit dhe harmonizimit të çështjeve me rëndësi të përbashkët, formohet Konferenca interuniversitare si trup publik juridik me të drejta dhe obligime të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Anëtarët e konferencës interuniversitare janë të gjitha universitetet e akridetuara.

(3) Organizimi dhe puna e konferencës interuniversitare rregullohet me statutin e konferencës interuniversitare.

(4) Konferenca interuniversitare përbëhet nga rektorët e universiteteve, kryetarët e kuvendeve studentore të universiteteve, 20 anëtarë nga radhët e profesorëve të rregullt të zgjedhur nga senati i universiteteve me votim sekret, përfaqësimi procentual sipas pjesëmarrjes së tyre në numrin e plotë të studentëve të rregullt të regjistruar për herë të parë në vitin studimor dhe një anëtar i zgjedhur nga radhët e drejtorëve të shkollave të larta profesionale të pavarura.

(5) Në punën e konferencës interuniversitare marrin pjesë ministri kompetent për punët e arsimit të lartë pa të drejtë të vendimmarrjes.

(6) Konferenca interuniversitare miraton rregullore me të cilën rregullohet mënyra e punës së vendimmarrjes.

(7) Konferenca interuniversitare ka ueb faqe, përmbajtja e së cilës rregullohet me akt të përgjithshëm të cilin e miraton Konferenca interuniversitare në pajtim me këtë ligj.

(8) Rendi i ditës dhe materialet e mbledhjes së Konferencës interuniversitare publikohen në ueb faqen e Konferencës interuniversitare më së paku shtatë ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.

(9) Procesverbalet e njësisive dhe Vendimet e Konferencës interuniversitare publikohen në ueb faqen e konferencës interuniversitare, ndërsa të njëjtat detyrimisht u dorëzohen të gjitha universiteteve të cilat janë anëtare në konferencën interuniversitare.

(10) Mbledhjet e konferencës interuniversitare janë të hapura për opinionin.

(11) Konferenca interuniversitare për punën e vet dorëzon raport vjetor në senatet e universiteteve të cilat janë anëtare të saj. Raporti dorëzohet më së voni deri me një mars vitin e ardhshëm dhe publikohet në ueb faqen e Konferencës interuniversitare.

(7) Mjetet për punën e Konferencës interuniversitare sigurohen nga anëtarët e Konferencës interuniversitare, në pajtim me Statutin e Konferencës interuniversitare.

### **Kompetencat e Konferencës interuniversitare**

### **Neni 90**

(1) Konferenca interuniversitare i ka këto kompetenca:

1. propozon në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë gjashtë anëtarë të Këshillit Nacional, me procedurë të zbatuar paraprakisht për zgjedhje nëpërmjet thirrjes publike.

2. zgjedh gjashtë anëtarë të Bordit për akreditim nga radhët e profesorëve, në mënyrë përkatëse me përfaqësimin e universiteteve sipas pjesëmarrjes së tyre në numrin e plotë të studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin studimor, me procedurë të zbatuar paraprakisht për zgjedhje nëpërmjet thirrjes publike.

3. zgjedh gjashtë anëtarë të Bordit për evaluim nga radhët e profesorëve, në mënyrë përkatëse me përfaqësimin e universiteteve sipas pjesëmarrjes së tyre në numrin e plotë të studenteve të regjistruar për herë të parë në vitin studimor, me procedurë të zbatuar paraprakisht për zgjedhje nëpërmjet thirrjes publike.

4. zgjedh dhe propozon anëtarë të organeve dhe trupave në pajtim me këtë ose me ligj tjetër, me procedurë të zbatuar paraprakisht për zgjedhje nëpërmjet thirrjes publike,

5. përcakton qëndrime dhe mendime për çështje të interesit të përbashkët në arsimin e lartë,

6. miraton Statut me të cilin e përcakton organizimin e vet dhe punën.

7. miraton rregullore me të cilën rregullohet mënyra e saj e punës dhe vendimmarrjes,

8. miraton akt të përgjithshëm me të cilin e rregullon përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së ueb faqes në pajtim me këtë ligj dhe

9. kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj ose me ligj tjetër.

### **Forma të tjera të bashkëpunimit të përbashkët**

#### **Neni 91**

Për shkak të realizimit edhe të interesave të tjera, universitetet, përkatësisht shkollat profesionale të pavarura mund me marrëveshje të organizojnë edhe forma të tjera të bashkëpunimit të përbashkët dhe kryerje të punëve të veçanta.

#### **Kapitulli i tetë**

### **ORGANE DHE TRUPA TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË**

#### **Seksioni 1**

### **ORGANE DHE TRUPA TË UNIVERSITETIT**

#### **Organe dhe trupa të universitetit**

#### **Neni 92**

(1) Organe të universitetit janë senati universitar, rektori dhe drejtoria rektoriale.

(2) Në universitet formohet këshilli i universitetit si trup i universitetit.

(3) Universiteti privat, përkatësisht privat-publik në vend të këshillit universitar mund të ketë organ të themeluesit, me të drejta dhe obligime të përcaktuara me aktin për themelimin dhe statutin e universitetit, në pajtim me këtë ligj.

(4) Në universitet formohet kuvend studentor i universitetit si trup i universitetit.

(5) Për shkak të mbrojtjes së të drejtave të studentëve, formohet avokati i studentëve si trup i pavarur.

#### **Senati universitar**

#### **Neni 93**

(1) Senati universitar (në tekstin e mëtejshëm: senati) është organ i menaxhimit dhe organ profesional të cilin e përbëjnë përfaqësues të njëjësive të universitetit, anëtarë shoqëruar edhe nga kuvendi studentor universitar.

(2) Anëtar i senatit mund të jetë personi i zgjedhur në titull mësimitor -shkencor, profesional-shkencor, shkencor mësimitor dhe studenti i rregullt i universitetit në momentin e zgjedhjes.

(3) Si anëtar i senatit nuk mund të zgjidhet personi i cili është i zgjedhur për dekan, prodekan ose drejtor i njësisë së universitetit.

(4) Anëtarët e senatit nga njësitë e universitetit dhe nga anëtarët shoqërues zgjidhen me votim sekret nga ana e anëtarëve të këshillit mësimitor-shkencor, përkatësisht mësimitdhënës ose shkencor për kohëzgjatje prej tre vitesh, me të drejtë për edhe një zgjedhje.

(5) Me përjashtim të paragrafit (4) të këtij neni, kuvendi universitar studentor i zgjedh përfaqësuesit e studentëve në senat me votim sekret, për kohë prej një viti pa të drejtë të rizgjedhjes.

(6) Në senat çdo njësi e universitetit ka së paku nga një, ndërsa më së shumti dy përfaqësues.

(7) Rektori dhe prorektorët janë anëtarë të Senatit sipas pozitës, pa të drejtë që të marrin pjesë në vendimmarrje dhe pa të drejtë të jenë të zgjedhur për kryetarë të senatit.

(8) Anëtarët shoqërues të universitetit zgjedhin nga një anëtar të senatit. Anëtarët e senatit të zgjedhur nga anëtarët shoqërues të universitetit marrin pjesë në punën dhe vendimmarrjen e senatit për çështje të përcaktuara me statutin e universitetit.

(9) Përfaqësuesit e studentëve përbëjnë më së paku 10%, por jo më shumë se 15% të anëtarëve të senatit.

(10) Numri i anëtarëve të senatit, procedura për zgjedhjen e tyre, bazat dhe procedura për shkarkimin e tyre, si dhe konvokimi dhe udhëheqja e mbledhjeve të senatit, rregullohen me statut të universitetit në pajtim me këtë ligj.

(11) Konvokimi dhe puna e Senatit më afërsisht rregullohet me Rregulloren e senatit në pajtim me këtë ligj dhe me statutin e universitetit.

### **Kompetenca e senatit**

#### Neni 94

Senati i universitetit:

1. miraton statutin e universitetit dhe jep pëlqim për statutet e njësive në përbërjen e tij,
2. vendos për veprimtarinë mësimore, shkencore, artistike dhe të lartë profesionale (aplikative),
3. miraton programet studimore të fakulteteve, respektivisht shkollave të larta profesionale dhe institutet shkencore në përbërjen e tij që kryejnë veprimtari të arsimit të lartë në pajtim me këtë ligj,
4. i propozon Këshillit Nacional të Arsimit të Lartë bazat mbi të cilat përcaktohet taska shkollore për studim,
5. vendos për themelimin dhe ndërprerjen e njësive të brendshme organizative, organizatave dhe shoqërive tregtare,
6. vendos për ndryshime statusore në pajtim me këtë ligj,
7. përcakton mendim për ndërprerjen e nevojës për ekzistimin e njësive të caktuara në universitet dhe për transformimin e tyre,
8. miraton programin vjetor dhe programin trevjeçar për zhvillimin dhe punë në universitet,
9. jep mendimin dhe paraqet propozime për programin e arsimit të lartë dhe jep mendim për programin vjetor për zhvillimin e njësive në përbërjen e tij,
10. jep mendimin dhe paraqet propozime për programin nacional për veprimtarinë kërkimore-shkencore të Republikës së Maqedonisë,
11. e miraton raportin vjetor për punë të universitetit, parashtruar nga Rektori,
12. Miraton plan vjetor financiar të universitetit,
13. miraton llogari financiare vjetore dhe raport financiar të mbaruar vjetor të universitetit,



14. miraton program për investime në universitet,
15. vendos për ankesat kundër vendimit për ankesë nga personi i cili nuk është zgjedhur as në titullin ekzistues, në pajtim me nenin 165 të këtij ligji,
16. vendos për ndarjen e titullit doktor nderi i shkencave (doctor honoris causa), titullin e profesorit të nderit në universitet (profesor honoris causa) dhe titullin profesor emeritus,
17. e zgjedh komisionin zgjedhor universitar,
18. vendos për vërtetimin e suspendim të dekanit, ose drejtorit të njësisë së universitetit,
19. e konfirmon zgjedhjen e dekanit, respektivisht drejtorin e njësisë të universitetit,
20. jep mendimin këshillit nacional për arsimin e lartë sipas normativave dhe standardeve për themelimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë,
21. miraton rregullore për kushtet e veçanta dhe procedurën e përzgjedhjes në titujt mësimdhënës-shkencorë, mësimdhënës-profesionalë, shkencorë, mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë,
22. miraton rregullore për kushtet, kriteret dhe rregullat për regjistrimin dhe studimin e tre cikleve të studimeve,
23. miraton rregullore për sistemin unik të transferimit të kredive dhe kalimin nga një program studimor në tjetrin, respektivisht nga një njësi në një njësi tjetër të universitetit,
24. miraton rregullore për lëshimin e diplomave, shtojcë të diplomave, titullin profesional respektivisht shkencor dhe dokumentet e tjera për studimet e përfunduara në arsimin e lartë dhe kushtet dhe procedurën për revokimin e diplomës së lëshuar,
25. miraton rregullore për mënyrën në të cilën kryhen çështjet profesionale-administrative të interesit të përbashkët të njësisë të universitetit,
26. miraton rregullore për organizimin e veprimtarisë botuese dhe vendos për veprimtarinë botuese,
27. miraton program për bashkëpunim ndërkombëtar,
28. i përcakton detyrimet e punës të të punësuarve dhe përcakton parimet për rregullimin e marrëdhënieve të punës të të punësuarve që kryejnë veprimtari të arsimit të lartë, veprimtari shkencore dhe artistike,
29. me propozimin e rektorit zgjidhet dhe shkarkohet sekretari i përgjithshëm i universitetit,
30. formon komision për vetevaluim të universitetit dhe zgjedh anëtarët e tij,
31. miraton Udhëzim për vetevaluim dhe sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e kualitetit të universitetit dhe njësisë të tij në pajtim me Rregulloren për standardet dhe procedurën për vetevaluim dhe evaulim të jashtëm të miratuar nga Këshillit Nacional për Arsim të Lartë,
32. miraton rregullore për punën e senatit,
33. merr masa për avancim dhe mbrojtjen e standardit të studentit dhe të punësuarit.
34. zgjedh kryetar të senatit,
35. miraton akt të përgjithshëm për rregullimin e punës së qendrës për karrierë të universitetit,
36. miraton aktin e përgjithshëm nga neni 150 paragrafi (2) të këtij ligji, me të cilin përcaktohen kushtet për regjistrimin e programeve studimore për personat që nuk kanë përfunduar arsimin e barabartë jashtë shtetit,
37. miraton aktin e përgjithshëm nga neni 154 paragrafi (4) të këtij ligji i cili përcakton mënyrat e mundshme të kontrollit të njohurive të studentëve,
38. zgjedh ushtruesin e detyrës rektor në pajtim me këtë ligj,
39. nga radhët e profesorëve të rregullt të universitetit, zgjedh person të autorizuar për pranimin e kallëzimeve për korrupsion,
40. miraton akt të përgjithshëm që rregullon punën dhe kompensimin mujor të personit të autorizuar për pranimin e kallëzimeve për korrupsion,

41. me propozim të kuvendin studentor universitar, zgjedh avokat të studentëve,
42. miraton program për sigurimin e teknologjisë dhe/ose adaptimin e hapësirës në të cilën zhvillohet mësimi me qëllim të ofrimit të qasjes në arsimin e lartë të personave me pengesa dhe
43. kryen punë tjera përckatuara me këtë ligj dhe me statutin e universitetit.

### **Mënyra e vendimmarrjes në Senat**

#### **Neni 95**

(1) Senati mund të vendos nëse në mbledhje janë prezentë më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Senatit kurse vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, përveç nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj.

(2) Për zgjedhjen e organeve të universitetit dhe zgjedhjen e Kryetarit të Senatit, senati mund të vendosë në mbledhje nëse janë prezent së paku 2/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Senatit, kurse vendos me shumicë nga anëtarët e pranishëm.

### **Kryetari i Senatit**

#### **Neni 96**

(1) Kryetari i senatit zgjidhet nga radhët e senatorëve me votim të fshehtë për një periudhë njëvjeçare, me të drejtë edhe për një zgjedhje.

(2) Kryetari i Senatit i thërret seancat e Senatit, propozon rendin e ditës dhe kryeson seancat e Senatit.

(3) Kryetari i Senatit thërret seancë të Senatit së paku një herë në muaj.

(4) Kryetari i Senatit, është i obliguar me kërkesë të së paku një të pestës së anëtarëve të Senatit, ose me kërkesën e Rektorit të thërrasë seancë të Senatit.

(5) Nëse kryetari i Senatit nuk vepron në pajtim me dispozitat e paragrafëve (3) dhe (4) të këtij neni, Rektori e thërret mbledhjen e Senatit.

(6) Në rast të mungesës ose pengesës së kryetarit të Senatit, seancat e Senatit do t'i udhëheq anëtar i Senatit, në përputhje me statutin e universitetit.

(3) Kryetari i senatit është përgjegjës për ligjshmërinë dhe statutshmërinë e punës së senatit.

(4) Procedura për zgjedhjen e kryetarit të Senatit rregullohet me statutin e universitetit.

(5) Ushtrimi i detyrës kryetar i Senatit është i papërputhshëm me ushtrimin e ndonjë funksioni tjetër shtetëror ose funksioni në parti politike.

### **Rektori dhe prorektorët**

#### **Neni 97**

(1) Rektori është organ udhëheqës i universitetit.

2) Rektori e paraqet dhe përfaqëson universitetin në vend dhe jashtë.

(3) Rektori zgjidhet nga radhët e profesorëve të rregullt me publikimin e shpalljes publike.

(4) Rektori zgjidhet për periudhë prej tre vitesh, me të drejtë për zgjedhje të sërishme.

(5) Rektori zgjidhet në zgjedhje të lira, të drejtpërdrejta dhe sekrete nga anëtarët e këshillave mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe të mësimdhënësve të njëjësive.

(6) Senati formon komision zgjedhor universitar të përbërë nga shtatë senatorë, që:

1. e vlerëson përmbushjen e kushteve për zgjedhjen e rektorit dhe rregullshmërinë e fletëparaqitjes,

2. e përcakton listën e kandidatëve për rektori dhe

3. i përmbledh rezultatet e votimit për zgjedhjen e rektorit.

(7) Çdo kandidat për rektor mund të autorizojë vëzhgues të punës së komisionit zgjedhor të universitetit.

(8) Këshilli mësimitor-shkencor, shkencor ose i mësimeve të njësive të zgjedh komision prej pesë anëtarësh që e zbatojnë votimin e njësive universitare. Çdo kandidat për rektor mund të autorizojë vëzhguesit e procesit të votimit të secilës njësi në universitet.

(9) Votimi për rektor realizohet në të njëjtën ditë në periudhën prej orës 12 deri 14 në të gjitha njësive të universitetit.

(10) Pas përfundimit të votimit i qaset përcaktimit të rezultateve të votimit, me ç'rast numri i fituar i votave të çdo kandidati të secilës njësi veç e veç është shprehur në përqindje të numrit nga numri i përgjithshëm i votave të vlefshme të njësive dhe shumëzohet me numrin e senatorëve që i zgjedh njësia, e cila jep numrin e pikëve të fituara nga secili prej kandidatëve.

(11) Rezultatet e votimit dërgohen deri te komisionit zgjedhor i universitetit në afat prej dy orëve nga mbarimi i votimit

(12) Komisioni Zgjedhor Universitar i përmbledh rezultatet e votimit të të gjitha njësive në universitet, ku për rektor zgjidhet kandidati që ka marrë numrin më të madh të pikëve në nivel të universitetit, respektivisht shuma e pikëve është më e lartë pasi për secilin kandidat do të mbledhen pikët veças të cilat i ka marrë në secilën njësi veç e veç.

(13) Procedura për zgjedhjen e rektorit rregullohet me statutin e universitetit.

(14) Rektori e kryen detyrën e tij në mënyrë profesionale dhe të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës i realizon sipas marrëveshjes të lidhur me Senatin. Me marrëveshje rregullohet edhe vëllimi i angazhimit të tij si mësimeve në njësive ku është zgjedhur që nuk mund të jetë më shumë se 30% nga koha e punës.

(15) Universiteti ka një ose më shumë prorektorë që zgjidhen nga radhët e profesorëve të njësive të universitetit. Prorektorët zgjidhen me propozim të Rektorit, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me statutin e universitetit.

(16) Ushtrimi i detyrës rektor dhe prorektor është i papërputhshëm me ushtrimin e ndonjë funksioni tjetër publik ose funksioni në parti politike.

(17) Rektori ose prorektori, sipas kushteve të përcaktuara me statutin e universitetit, mund të shkarkohet përpara skadimit të kohës për të cilën është zgjedhur. Mënyra e shkarkimit të rektorit ose të prorektorit nga afër rregullohet me statutin e universitetit.

### **Kompetencat e rektorit**

#### Neni 98

(1) Rektori në kuadër të udhëheqjes me universitetin:

1. e harmonizon veprimtarinë e arsimit të lartë, artistike, hulumtuese-shkencore dhe aplikative dhe punën tjetër të universitetit,

2. i zbaton vendimet dhe konkluzionet e senatit,

3. jep iniciativa për konvokimin e senatit,

4. u paraqet senatit dhe drejtorisë rektoriale propozime dhe vendime dhe akte tjera të përgjithshme dhe konkluzione për çështje, shqyrtimi dhe zgjidhja e të cilave është në kompetencën e tyre,

5. vendos për çështje financiare dhe materiale që nuk janë në kompetencë të senatit të universitetit;

6. promovon doktorë shkencash;

7. ndan çmime universitare;

8. i konvokon, e propozon rendin e ditës dhe kryeson me mbledhjet e drejtorisë rektoriale;

9. propozon zgjedhje dhe shkarkim të prorektorit;

10. suspendon dekan ose drejtor të njësive universitare për mosrespektimin e ligjit, statutit, aktit të përgjithshëm ose vendimit të universitetit dhe cakton ushtrues detyre dekan, respektivisht drejtor të njësive universitare,

11. propozon zgjedhje dhe shkarkim të sekretarit të përgjithshëm të universitetit;
12. emëron ushtrues të përkohshëm të detyrës dekan, respektivisht ushtrues të detyrës drejtor i njësisë universitare;
13. e udhëheq bashkëpunimin ndërkombëtar të universitetit dhe inicion bashkëpunimin me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit,
14. u jep autorizim prorektorëve për kryerjen e një pjese të të drejtave dhe detyrimeve të tyre,
15. menaxhon me pronën e universitetit publik dhe kujdeset për mirëmbajtjen e tij dhe
16. kryen veprimtari të tjera të përcaktuara me ligj, statut dhe akte të tjera të përgjithshme të universitetit.

### **Raporti për senatin**

#### Neni 99

(1) Rektori detyrohet një herë në vit te senati, këshilli universitar dhe themeluesi të paraqesë raport për punën e tij dhe për punën e universitetit, që përmban edhe raport financiar.

(2) Nëse Senati nuk e pranon raportin nga paragrafi (1) të këtij neni, ngrihet procedurë për shkarkimin e rektorit të universitetit.

(3) Përmbajtja dhe forma e raportit nga paragrafi (1) i këtij neni rregullohen më afërsisht me Rregulloren për përmbajtjen dhe formatin e raportit për punën e rektorit që e miraton Këshilli Nacional.

### **Ndërprerja e mandatit të rektorit**

#### Neni 100

(1) Mandati i rektorit përfundon para skadimit të periudhës për të cilën zgjidhet, në njërin nga rastet në vijim:

1. nëse atë e kërkon vetë,
2. nëse e humb përgjithmonë aftësinë e tij për ushtrimin e detyrës rektor,
3. nëse i plotëson kushtet për pension të pleqërisë ose
4. nëse shkarkohet nga detyra para skadimit të mandatit të tij.

(2) Në rastet e ndërprerjes së mandatit të rektorit nga paragrafi (1) i këtij neni, deri në zgjedhjen e rektorit të ri, senati zgjedh për ushtrues detyre rektor një nga prorektorët e universitetit për periudhë maksimale prej më së shumti gjashtë muaj. Një person mund të zgjidhet ushtrues detyre rektor vetëm një herë. Nëse asnjëri nga prorektorët nuk e merr shumicën e kërkuar, zbatohet parimi i senioritetit ndërmjet prorektorëve, respektivisht funksionin ushtrues detyre rektor e kryen prorektori i zgjedhur i pari me titullin profesor i rregullt respektivisht titulli më i lartë në të cilin prorektorët janë zgjedhur për periudhë që nuk mund të jetë më e gjatë se gjashtë muaj.

(3) Ushtruesi i detyrës rektor i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e rektorit.

(4) Më së voni 30 ditë nga dita e zgjedhjes së ushtruesit të detyrës rektor nga paragrafi (2) i këtij neni, ngrihet procedura për zgjedhjen e rektorit.

### **Përgjegjësia e rektorit për ligjshmëri dhe statutshmëri**

#### Neni 101

(1) Rektori kujdeset për ligjshmërinë dhe statutshmërinë e punës së universitetit dhe të njësisve në përbërjen e tij dhe ka të drejtë dhe detyrim që ta ndalojë ekzekutimin ose të shfuqizojë akt të organeve të tyre, të cilat ai e konsideron se nuk janë në pajtim me ligjin, statutin, aktin e përgjithshëm ose vendimin e universitetit.

(2) Njësia e universitetit akti i të cilës është shfuqizuar, mund të paraqesë ankesë te senati. Vendi i senatit është përfundimtar.

(3) Në pajtim me statutin e universitetit rektori mund për mosrespektimin e ligjit, statutit, aktit të përgjithshëm ose vendimit të universitetit ta suspendojë dekanin ose drejtorin e njësisë së universitetit dhe përkohësisht të caktojë ushtrues detyre dekan, respektivisht drejtor i njësisë së universitetit.

(4) Senati në afat sa më të shkurtër, e më së voni në afat prej 30 ditëve nga suspendimi i dekanit ose drejtorit të njësisë universitare vendos për suspendimin e dekanit respektivisht drejtorit të njësisë së universitetit nga paragrafi (3) i këtij nen. Nëse senati e konfirmon pezullimin, dekanit respektivisht drejtorit i përfundon mandati me ditën e konfirmimit të vendimit të pezullimit.

### **Drejtoria rektoriale**

#### Neni 102

(1) Drejtoria rektoriale përbëhet nga rektori, prorektorët, prodekanët, dekanët e fakulteteve, drejtorët e shkollave të larta profesionale, drejtorët e institucioneve të akredituara shkencore dhe përfaqësuesit e studentëve.

(2) Me drejtorinë rektoriale udhëheq rektori.

(3) Organizimi dhe mënyra e punës së drejtorisë rektoriale, si dhe numri i përfaqësuesve të studentëve, përcaktohen në mënyrë më të detajuar me statutin e universitetit.

### **Kompetencat e drejtorisë rektoriale**

#### Neni 103

Drejtoria rektoriale:

1. I përgatit dhe propozon akte dhe materiale për çështje për të cilat Senati vendos,
2. e përcakton dhe publikon konkursin për regjistrimin e studimeve në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të universiteteve publike, me pëlqimin paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë,
3. e përcakton dhe publikon konkursin për regjistrimin e studimeve në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të universiteteve private,
4. jep mendim për programet studimore në fakultete, institute shkencore dhe shkolla të larta profesionale në përbërje të universitetit,
5. sjell vendime për bashkëpunimin rrjedhës ndërkombëtar të universitetit,
6. e rregullon lëshimin e diplomave dhe dokumenteve tjera për studime të mbaruara në arsimin e lartë,
7. përcakton propozim për shumën e participimit dhe taksës shkollore për studentët në institucionet publike të arsimit të lartë
8. kryen edhe punë tjera të përcaktuara me statutin e universitetit.

### **Këshilli i Universitetit**

#### Neni 104

(1) Këshilli i Universitetit ka më së shumti 11 anëtarë.

(2) Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit universitar, pesë anëtarë emëron senati i universitetit, nga personat që nuk janë anëtarë të Senatit, dy anëtarë emëron kuvendi studentor universitar nga studentët; tre anëtarë emëron themeluesi; dhe një anëtar emëron organizata më reprezentative e punëdhënësve në Republikën e Maqedonisë. Në punën e këshillit të universitetit merr pjesë edhe rektori pa të drejtë të votës.

(3) Mandati i anëtarëve të këshillit universitar është tre vjet pa të drejtë rizgjedhjeje, përveç për anëtarët e zgjedhur nga radhët e studentëve, mandati i të cilëve zgjat një vit pa të drejtë rizgjedhjeje.

(4) Këshilli i universitetit nga radhët e anëtarëve të veta zgjedh kryetar.

(5) Anëtari i këshillit të universitetit nuk mund të zgjidhet person i cili sipas dispozitave të Ligjit për institucione nuk mund të jetë anëtar i organit drejtues të institucionit, si dhe person i punësuar në administratën e universitetit, në ministrinë kompetente për punët e arsimit të lartë, respektivisht për shkencë, person i emëruar në funksion në organ shtetëror ose njësi të vetëqeverisjes lokale ose i zgjedhur në organ të partisë politike.

(6) Përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit universitar më afërsisht rregullohet me statutin e universitetit.

### **Kompetenca e këshillit të universitetit**

#### **Neni 105**

(1) Këshilli i Universitetit kryen mbikëqyrje mbi kryerjen e veprimtarisë së universitetit, detyrat e universitetit në përputhje me këtë ligj, ligjshmërinë e funksionimit të tij, përdorimin racional të resurseve kadrovike dhe materiale dhe kryen aktivitete të tjera të përcaktuara me aktin për themelimin dhe statutin e universitetit.

(2) Këshilli i Universitetit nuk mund të ketë kompetencë me të cilën kufizohet dhe cenohet autonomia e universitetit.

(3) Këshilli i Universitetit, më së paku një herë në vit, i paraqet informacion ministrisë kompetente për punët e arsimit të lartë dhe Senatit të Universitetit.

(4) Kompetenca dhe mënyra e vendimmarrjes në këshillin universitar nga afër rregullohet me këtë ligj dhe statutin e universitetit.

### **Organi i themeluesit të institucionit të arsimit të lartë privat**

#### **Neni 106**

(1) Universiteti privat, respektivisht universiteti publik-privat në vend të këshillit të universitetit, mund të ketë organ të themeluesit.

(2) Numri i anëtarëve dhe përbërja e organit nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohet nga themeluesi me aktin për themelimin e universitetit dhe statutin e universitetit.

(3) Organi i themeluesit nuk mund të ketë të drejta dhe detyrime që kufizojnë dhe cenojnë autonominë e institucionit të arsimit të lartë ose kufizojnë të drejtat dhe detyrimet e organeve të universitetit të përcaktuara me këtë ligj.

### **Personi i autorizuar për pranim të kallëzimeve për korrupsion**

#### **Neni 107**

(1) Me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes më efektive ndaj korrupsionit, Senati i Universitetit, nga profesorët e rregullt të universitetit, zgjedh person të autorizuar për pranimin e kallëzimeve për korrupsion.

(2) Kallëzimi i korrupsionit kryhet me gojë në procesverbal ose në formë të shkruar.

(3) Person i autorizuar për pranim të kallëzimit të korrupsionit, është i obliguar:

- të veprojë pas kallëzimit nga paragrafi (2) i këtij neni, në pajtim me procedurat e përcaktuara;

- t'i mbrojnë të dhënat personale të denoncuesit, respektivisht të dhënat që mund të zbulojnë identitetin e denoncuesit i cili kërkon të jetë anonim ose denoncon në mënyrë konfidenciale, në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale;

- ta informojë denoncuesin i cili është i njohur për masat e marra në lidhje me denoncimin pa prolongim, kurse më së voni në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të kallëzimit.

(4) Personi i autorizuar për pranimin e denoncimeve për korrupsion zgjidhet për periudhë prej tre vjetësh, me të drejtë për zgjedhje të sërishme.

(5) Personi i autorizuar për pranimin e denoncimeve për korrupsion të paktën dy herë në vit duhet të paraqesë raport mbi punën e tij në Senatin e Universitetit.

(6) Puna dhe kompensimi i personit të autorizuar për pranimin të denoncimeve për korrupsion rregullohen me akt të përgjithshëm që e miraton Senati i universitetit.

## Seksioni 2

### ORGANE DHE TRUPA TË NJËSISË SË UNIVERSITETIT

#### **Organe të fakultetit dhe shkollës së lartë profesionale**

##### Neni 108

(1) Organet e fakultetit janë këshilli mësimor-shkencor, dekani dhe administrata e dekanatit.

(2) Në fakultet formohet kuvendi i studentëve të fakultetit si trup i fakultetit.

(3) Organe të shkollës së lartë profesionale si njësi e universitetit janë këshilli i mësimdhënësve, drejtori dhe drejtorja e shkollës së lartë profesionale.

(4) Në shkollën e lartë profesionale si njësi e universitetit, formohet kuvend studentor i shkollës së lartë profesionale si trup i shkollës së lartë profesionale.

(5) Dispozitat e këtij kapitulli për shkollë të lartë profesionale si njësi të universiteti do të zbatohen në mënyrë adekuate edhe për shkollën e lartë profesionale të pavarur.

#### **Këshili mësimor - shkencor**

##### Neni 109

(1) Këshilli mësimor shkencor është organ drejtues dhe organ profesional i fakultetit.

(2) Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit në fushën e artit ose akademisë së artit mund të mbajë emërtimin e një këshilli mësimor -shkencor dhe artistik.

(3) Këshillin mësimor-shkencor e përbëjnë profesorët ordinarë, profesorët inordinarë dhe docentët që janë në marrëdhënie pune në fakultet.

(4) Në fakultetin në të cilin janë zgjedhur më shumë se 150 mësimdhënës, këshilli mësimor -shkencor përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur nga njësitë organizative (katedra, institutet, qendrat, etj.) nga ana e profesorëve ordinarë, inordinarë dhe docentët. Zgjedhja bëhet në proporcion me mësimdhënësit e zgjedhur, përkatësisht të sistemuar në njësinë organizative në mënyrën dhe sipas kushteve të përcaktuara në statutin e universitetit dhe statutin e njësisë. Këshillin mësimor-shkencor në këto fakultet e përbëjnë 150 përfaqësues.

(5) Në këshillin mësimor -shkencor përfaqësuesit e tyre zgjedhin edhe kuvendin e studentëve të fakultetit.

(6) Numri i përfaqësuesve të studentëve dhe koha për të cilën ata zgjidhen përcaktohen me statutin e universitetit dhe statutin e fakultetit.

(7) Përfaqësuesit e studentëve duhet të përbëjnë të paktën 10%, por jo më shumë se 15% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit mësimor-shkencor.

(8) Këshilli mësimor-shkencor mund për programe të caktuara programore dhe për nevoja tjera të formojë trupa profesionale, të përcaktuara me statutin e universitetit dhe / ose statutin e fakultetit.

## Kompetenca e këshillit mësimor-shkencor

### Neni 110

(1) Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit:

1. miraton statut të fakultetit,
2. miraton program trevjeçar për zhvillimin dhe programin vjetor të punës,
3. zgjedh dekan në fakultetit dhe ja dorëzon vendimin për zgjedhjen e senatit për vërtetim,
4. zgjedh prodekanë,
5. zgjedh anëtarë të senatit të universitet në përbërje të cilës është (senatorë),
6. i propozon senatit programe studimore,
7. miraton program për punë kërkimore shkencore, respektivisht punë artistike,
8. bën zgjedhjen në tituj mësimorë shkencorë docent, profesor inordinar, dhe profesor ordinar në titujt mësimor-profesional lektor dhe lektor i lartë, në tituj shkencorë, tituj të bashkëpunëtorëve dhe demonstratorë,
9. propozon numër të studentëve që regjistrohen në vitin e parë të të gjitha cikleve të studimit,
10. merr vendim për orarin e detyrave të punës për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët për çdo vit akademik,
11. miraton planin financiar dhe miraton llogari përfundimtare (raporti vjetor financiar) në suaza të planit të unifikuar financiar të universitetit dhe llogarinë përfundimtare të konsoliduar të universitetit publik,
12. i propozon universitetit, respektivisht kur përcaktohet me këtë ligj, ndryshimin e themeluesit ose zgjerimin e veprimtarisë në pajtim me këtë ligj,
13. i miraton aktet e përgjithshme të fakultetit,
14. miraton masat për krijimin dhe përmirësimin e brezit të ri mësimor-shkencor dhe artistik dhe për punë me studentë të suksesshëm dhe të talentuar. miraton masat dhe vendos për avancimin e punës mësimdhënies, kërkimit-shkencor, artit, punës aplikative dhe rrjetit kompjuterik,
16. zgjedh dhe shkarkon sekretarin e fakultetit, në përputhje me statutin e universitetit dhe statutin e fakultetit,
17. i zgjedh anëtarët e komisionit për vetëvlerësim dhe miraton udhëzim për evaulimin e fakultetit në pajtim me Rregulloren për standardet dhe procedurën për vetëevaluim dhe vlerësimin e jashtëm të miratuar nga Këshilli Nacional për Arsimit të Lartë,
18. vendos për bibliotekën, sistemin e informacionit të bibliotekës dhe për realizimin e veprimtarisë së informacionit dhe dokumentacionit të bibliotekës, në përputhje me statutin e universitetit dhe statutin e fakultetit,
19. vendos për organizimin e tubimeve, simpoziumeve, konferencave dhe të ngjashme,
20. vendos për realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në përputhje me statutin e universitetit dhe statutin e fakultetit dhe
21. kryen punë tjera përcaktuara me këtë ligj dhe me statutin.

(2) Këshilli mësimor -shkencor vendos në mënyrë të plotfuqishme nëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, kurse vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve prezent.

(3) Gjatë zgjedhjes në tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, shkencorë, bashkëpunëtorë dhe demonstratorë nuk marrin pjesë studentët.

(4) Për punët nga paragrafi (1) alineja 1, 3, 4, 5 dhe 7 të këtij neni këshilli mund të vendosë në mënyrë të plotfuqishme nëse janë të pranishëm dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, kurse vendimi konsiderohet i miratuar nëse për atë kanë votuar shumica e anëtarëve të pranishëm të këshillit.



(5) Për zgjedhje dhe shkarkim të dekanit, prodekanit dhe zgjedhje të senatorëve Këshilli i mësimdhënësve vendos me votim të fshehtë. Me statutin e universitetit ose me statutin e fakultetit mund të parashikohet që edhe për çështje tjera nga paragrafi (1) i këtij neni këshilli mësimor shkencor voton me votim të fshehtë.

(6) Për çështje të caktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, këshilli mësimor shkencor mund të zbatojë votim të fshehtë edhe pse me këtë ligj, statutin e universitetit ose në statutin e fakultetit nuk është paraparë votim i fshehtë.

### **Këshilli i mësimdhënësve**

#### Neni 111

(1) Këshilli i mësimdhënësve është organ drejtues dhe organ profesional i shkollës së lartë profesionale.

(2) Këshilli i mësimdhënësve përbëhet nga profesorë, ligjërues të lartë dhe ligjërues në shkollën e lartë profesionale.

(3) Në këshillin mësimor përfaqësuesit e tij i zgjedh edhe kuvendi i studentëve të shkollës së lartë profesionale.

(4) Numri i përfaqësuesve të studentëve dhe koha për të cilën ata zgjidhen përcaktohen me statutin e shkollës së lartë profesionale.

(5) Përfaqësuesit e studenteve përbëjnë të paktën 10%, por jo me shume se 15% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit të mësimdhënësve.

(6) Këshilli i mësimdhënësve mund për programe të caktuara programore ose për nevoja tjera të formojë organe profesionale të përcaktuara me statutin e shkollës së lartë profesionale.

### **Kompetenca e këshillit të mësimdhënësve**

#### Neni 112

(1) Këshilli i mësimdhënësve i shkollave të larta profesionale si njësi e universitetit:

1. miraton statut të shkollës së lartë profesionale,
2. miraton program dyvjeçar për zhvillimin dhe programin vjetor për punë,
3. zgjedh drejtor dhe ja dorëzon vendimin për zgjedhje senatit për vërtetim,
4. zgjedh zëvendësdrejtor,
5. zgjedh anëtar të senatit të universitet në përbërje të cilës është (senatori),
6. i propozon senatit programe studimore,
7. kryen zgjedhje në titujt mësimorë, profesor, ligjërues i lartë dhe ligjërues,
8. propozon numër të studentëve që regjistrohen në vitin e pare të studimeve,
9. sjell vendim për orarin e detyrave të punës për profesorët, ligjëruesit e lartë dhe ligjëruesit,
10. miraton planin financiar dhe miraton llogari përfundimtare (raporti vjetor financiar) në suaza të planit të unifikuar financiar të universitetit dhe llogarinë përfundimtare të konsoliduar të universitetit publik,
11. i propozon universitetit, respektivisht kur përcaktohet me këtë ligj, ndryshimin e themeluesit ose zgjerimin e veprimtarisë në pajtim me këtë ligj,
12. miraton aktet e përgjithshme të shkollës së lartë profesionale si njësi të universitetit,
13. miraton masa për punën me sukses të veçantë dhe studentë të talentuar,
14. miraton masat dhe vendos për avancimin e punës mësimore dhe aplikative dhe rrjetit kompjuterik,
15. zgjedh sekretar të shkollës së lartë profesionale, në përputhje me statutin e universitetit dhe statutin e shkollës së lartë profesionale,

16. zgjedh anëtarët e komisionit për vetevaluim dhe miraton udhëzim për evaluimin e shkollës së lartë profesionale

17. vendos për bibliotekën, sistemin informativ-të bibliotekës dhe për realizimin e veprimtarisë informative-të bibliotekës dhe të dokumentacionit, në përputhje me statutin e universitetit dhe statutin e shkollës së lartë profesionale,

18. vendos për organizimin e takimeve, simpoziumeve, konferencave dhe të ngjashme,

19. vendos për realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në përputhje me statutin e universitetit dhe statutin shkollës së lartë profesionale dhe

20. kryen punë tjera përcaktuara me këtë ligj dhe me statutin.

(2) Këshilli i mësimdhënësve vendos në mënyrë të plotfuqishme nëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, kurse vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve prezentë.

(3) Gjatë zgjedhjes në tituj mësimorë nuk marrin pjesë studentët.

(4) Për punët nga paragrafi (1) alineja 1, 3, 4, 5 dhe 7 të këtij neni këshilli mund të vendosë nëse janë të pranishëm dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, kurse vendimi konsiderohet i miratuar nëse për atë kanë votuar shumica e anëtarëve të këshillit të pranishëm.

(5) Për zgjedhjen dhe shkarkimin e drejtorit, zëvendës drejtorit dhe zgjedhjes së senatorëve këshilli i mësimdhënësve vendos me votim të fshehtë. Me statutin e universitetit ose me statutin e shkollës së arsimit të lartë mund të parashihet se edhe për çështje tjera nga paragrafi (1) i këtij neni këshilli i mësimdhënësve voton në mënyrë të fshehtë.

(6) Për çështje të caktuara nga paragrafi (1) të këtij neni, këshilli i mësimdhënësve mund të zbatojë votim të fshehtë edhe me këtë ligj, statutin e universitetit ose në statutin e shkollës së lartë profesionale nuk është paraparë votim i fshehtë.

(7) Dispozitat e paragrafëve (1) deri në (6) të këtij neni zbatohen gjithashtu edhe në këshillin e mësimdhënësve të shkollës së lartë profesionale të pavarur.

### **Këshilli shkencor**

#### Neni 113

Institucionet shkencore të akredituara për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë, themelojnë këshill shkencor për studimet e ciklit të dytë dhe të tretë, që përbëhet nga persona të zgjedhur në tituj shkencorë të cilët marrin pjesë në realizimin e mësimimit.

### **Dekani i fakultetit dhe kompetencat e tij**

#### Neni 114

(1) Dekani i fakultetit, është organ udhëheqës.

(2) Dekani e përfaqëson fakultetin brenda dhe jashtë vendit në përputhje me statutin e universitetit dhe statutin e fakultetit.

(3) Kryerja e detyrës dekan dhe prodekan, është e papërputhshme me ushtrimin e ndonjë funksioni tjetër publik ose funksioni në parti politike.

(4) Dekani, në kuadër të kryerjes së funksionit të tij udhëheqës:

1. i zbaton vendimet dhe konkluzionet e senatit dhe rektorit të universitetit,

2. i zbaton vendimet dhe konkluzionet e këshillit mësimor-shkencor,

3. kujdeset për kryerjen e harmonizuar të arsimit të lartë, artistik, kërkimin shkencor dhe veprimtarinë aplikative,

4. i thërret mbledhjet e këshillit mësimor-shkencor, propozon rendin e ditës dhe i kryeson ato,

5. i përgatit dhe propozon akte dhe materiale për çështje për të cilat vendos drejtoria e dekanatit,

6. këshillit mësimor shkencor i paraqet propozime të vendimit dhe konkluzione për çështje, shqyrtimi dhe zgjidhja e të cilave është në kompetencë të tij,

7. shpall konkursin për përzgjedhjen e personave në titujt mësimor-shkencorë, mësimor-profesionalë, shkencorë dhe bashkëpunëtorë,

8. i promovon studentët e diplomuar dhe ndan çmime,

9. menaxhon me pronën e fakultetit dhe kujdeset për mirëmbajtjen e saj në kuadër të autorizimeve përcaktuara me statutin e fakultetit dhe statutin e universitetit publik dhe

10. kryen veprimtari të tjera në pajtim me këtë ligj, statutin e universitetit dhe statutin e fakultetit

(5) Dekani është i detyruar, së paku një herë në vit, deri te këshilli mësimor-shkencor dhe deri te rektori i universitetit të dorëzojë raport për punën e tij. Nëse këshilli mësimor-shkencor nuk e pranon raportin për punën e dekanit, konsiderohet se dekani është shkarkuar dhe njoftohet rektori të emërohet ushtrues i detyrës dekan. Në të njëjtën ditë kur këshilli mësimor--shkencor nuk do ta pranojë raportin e punës së dekanit, fillon procedura për zgjedhjen e dekanit të ri.

(6) Dekani është përgjegjës për ligjshmërinë dhe statutshmërinë e punës së organeve të fakultetit dhe ka të drejtën dhe detyrimin për të ndaluar ekzekutimin e aktit të përgjithshëm dhe vendimin e këtyre organeve që konsideron se nuk janë në pajtim ligjin, statutin e universitetit dhe statutin e fakultetit , dhe për këtë do ta njoftojë rektorin i cili merr vendim për çështjen kontestuese.

(7) Për kryerjen e një pjesë nga të drejtat dhe detyrimet e veta dekani mund të autorizojë prodekanë të caktuar.

### **Zgjedhja dhe shkarkimi i dekanit të fakultetit**

#### Neni 115

(1) Dekani zgjidhet nga radhët e profesorëve ordinarë dhe inordinarë në fakultet, kurse nëse nuk ka profesorë ordinarë dhe inordinarë edhe nga radhët e docentëve për kohë prej tre vitesh, me të drejtë edhe për një zgjedhje, me kushte të përcaktuara me statutin e universitetit.

(2) Fakulteti, mund të ketë një ose më shumë prodekanë, të cilët i propozon dekani.

(3) Procedura për zgjedhjen dhe shkarkimin e dekanit dhe prodekanit, më afërsisht rregullohen me statut të fakultetit, në pajtim me statutin e universitetit.

(4) Nëse në afatin e përcaktuar me statut njësia e universitetit nuk zgjedh dekanin, më së voni në afat prej tri ditë pas skadimit të mandatit të dekanit, rektori emëron ushtrues detyre dekan, me pëlqimin paraprak të dhënë nga personi që e emëron për kohë të caktuar me statutin e universitetit.

(5) Mandati i ushtruesit të detyrës dekan mund të zgjasë më së shumti gjashtë muaj, me ç'rast si ushtrues i përkohshëm i detyrës dekan një person mund të emërohet vetëm një herë.

(6) Ushtruesi i përkohshëm i detyrës dekan nuk mund të kandidohet për dekan deri sa e kryen funksionin ushtrues i përkohshëm i detyrës dekan.

### **Ndërprerja e mandatit të dekanit para kalimit të afatit për të cilin është zgjedhur**

#### Neni 116

(1) Mandati i dekanit ndërpritet para kalimit të afatit për të cilin është zgjedhur nëse:

1. parashtron dorëheqje nga funksioni për të cilin është zgjedhur,

2. paraqitet pengesë e përhershme për kryerjen e funksionit,

3. është shkarkuar nga ana e këshillit mësimor-shkencor të fakultetit,

4. senati e vërteton vendimin për suspendim të dekanit nga ana e rektorit,

5. në raste tjera përcaktuar me ligj dhe me statutin e universitetit.

(2) Në rast të ndërprerjes së mandatit të dekanit para kalimit të afatit për të cilin është zgjedhur nga paragrafi (1) të këtij neni, rektori emëron ushtrues detyre dekan, me pëlqimin paraprak të dhënë nga personi që e emëron për kohë të caktuar atë përcaktuar me statutin e universitetit.

(3) Mandati i ushtruesit të detyrës dekan mund të zgjasë me së shumti gjashtë muaj, me ç' rast ushtrues i përkohshëm i detyrës dekan një person mund të emërohet vetëm një herë.

(4) Ushtruesi i detyrës së përkohshme dekan nuk mund të kandidohet për dekan deri sa e kryen funksionin e ushtruesit të përkohshëm të detyrës dekan.

(5) Më së voni në afat prej 30 ditëve nga dita e emërimit të ushtruesit përkohshëm të dekanit, Këshilli mësimor shkencor i fakultetit fillon procedurën për zgjedhjen e dekanit të ri.

(6) Shkarkimi i dekanit dhe prodekanit, më afërsisht rregullohen me statutin e fakultetit, në pajtim me statutin e universitetit.

### **Drejtori i shkollës së lartë profesionale si njësi e universitetit dhe kompetencat e tij**

#### Neni 117

(1) Drejtori i shkollës së lartë profesionale është organ udhëheqës.

(2) Drejtori i shkollës së lartë profesionale e prezanton shkollën e lartë profesionale në vendin tonë dhe vendin e huaj në pajtim me statutin e universitetit dhe statutin e shkollës së lartë profesionale.

(3) Ushtrimi i detyrës drejtor dhe zëvendësdrejtor i shkollës së lartë profesionale është i papërputhshëm me kryerjen e funksionit tjetër shtetëror ose funksionit në parti politike.

(4) Drejtori në suazat e kryerjes së funksionit të tij udhëheqës:

1. i zbaton vendimet dhe konkluzionet e senatit dhe rektorit të universitetit,
2. i zbaton vendimet dhe konkluzionet e këshillit të mësimshënësve,
3. kujdeset për kryerjen e harmonizuar të veprimtarisë së arsimit të lartë, artistike dhe aplikative,
4. i konvokon mbledhjet e këshillit të mësimdhënësve, e propozon rendin e ditës dhe kryeson me ato,
5. i përgatit dhe propozon aktet dhe materialet për çështje për të cilat vendos drejtorja,
6. këshillit të mësimdhënësve i parashton propozime të vendimeve, dhe konkluzione për çështjet shqyrtimi dhe zgjidhja e të cilave është në kompetencë të tij,
7. Shpall konkurs për zgjedhjen e personave të zgjedhur në tituj mësimorë, gjashtë muaj para kalimit të kohës për të cilën janë zgjedhur,
8. i promovon studentët e diplomuar dhe ndan çmime,
9. menaxhon me pronën e shkollës së lartë profesionale dhe kujdeset për mirëmbajtjen e saj në suazat e autorizimeve të caktuara me statutin e shkollës së lartë profesionale dhe statutin e universitetit publik dhe
10. kryen edhe punë tjera në pajtim me këtë ligj, statutin e universitetit dhe statutin e shkollës së lartë profesionale.

(5) Drejtori është i obliguar më së paku një herë në vit në këshillin e mësimdhënësve dhe te rektori i universitetit të dorëzojë raport për punën e tij. Nëse këshilli i mësimdhënësve nuk e pranon raportin për punën e drejtorit, drejtori konsiderohet i shkarkuar.

(6) Drejtori është përgjegjës për ligjshmërinë dhe statutshmërinë e punës së organeve të shkollës së lartë profesionale dhe ka të drejtë dhe obligim të ndalojë ekzekutimin e aktit të përgjithshëm dhe vendimin e këtyre organeve për të cilin konsideron se nuk është në pajtim me ligj, statutin e universitetit dhe statutin në shkollën e lartë profesionale dhe për atë e njofton rektorin i cili merr vendim për çështjen kontestuese.

(7) Për kryerjen e një pjese të të drejtave dhe obligimeve të tij drejtori mund ta autorizojë zëvendësdrejtorin.

(8) Dispozitat e paragrafëve (1) deri (7) të këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe për drejtorin e shkollës së lartë profesionale të pavarur.

### **Zgjedhja dhe shkarkimi i drejtorit të shkollës së lartë profesionale**

#### Neni 118

(1) Drejtori i shkollës së lartë profesionale zgjidhet nga radhët e profesorëve të shkollës së lartë profesionale, ndërsa nëse nuk ka profesorë edhe nga radhët e ligjëruesve të lartë për një periudhë prej tre vjetësh, me të drejtë edhe për një zgjedhje, sipas kushteve të përcaktuara me statutin e shkollës së lartë profesionale, në pajtim me statutin e universitetit.

(2) Shkolla e lartë profesionale mund të ketë një zëvendësdrejtor, i cili e zëvendëson drejtorin.

(3) Procedura për zgjedhjen dhe shkarkimin e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit, rregullohen me statutin e shkollës së lartë profesionale, në pajtim me statutin e universitetit.

(4) Nëse në afatin e përcaktuar të paraparë me statutin e universitetit nuk zgjedhet drejtori i njësisë, jo më vonë në afat prej tri ditëve nga kalimi i mandatit të drejtorit, rektori emëron ushtrues të detyrës të përkohshëm drejtor, me pëlqim paraprak të personit që e emëron, për kohën e caktuar me statutin e universitetit.

(5) Nëse në afatit e caktuar me statutin e shkollës së lartë profesionale të pavarur nuk zgjidhet drejtori, emërohet ushtrues i përkohshëm i detyrës drejtor në mënyrë të caktuar me statutin e shkollës së lartë profesionale të pavarur.

(6) Më së voni në afat prej tridhjetë ditë nga dita e emërimit të ushtruesit të përkohshëm të detyrës drejtor, këshilli i mësimdhënësve i shkollës së lartë profesionale fillon procedurë për zgjedhjen e drejtorit të ri.

(7) Në rastet nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni, mandati i ushtruesit të përkohshëm të detyrës drejtor mund të zgjasë më së shumti gjashtë muaj, me ç'rast ushtruesi i përkohshëm i detyrës drejtor një person mund të emërohet vetëm një herë.

(8) Ushtruesi i përkohshëm i detyrës drejtor nuk mund të kandidohet për drejtor derisa e kryen funksionin ushtrues i përkohshëm i detyrës drejtor.

### **Pushimi i mandatit të drejtorit para kalimit të afatit për të cilin është zgjedhur**

#### Neni 119

(1) Mandati i drejtorit ndërpritet para kalimit të afatit për të cilin është zgjedhur nëse:

1. jep dorëheqje nga funksioni për të cilin është zgjedhur,
2. ndodh pengesë e përhershme për kryerjen e funksionit,
3. është shkarkuar nga ana e këshillit të mësimdhënës të shkollës së lartë profesionale,
4. senati e vërteton vendimin për suspendim të drejtorit nga ana e rektorit dhe
5. Në raste tjera të caktuara me ligj dhe me statutin e universitetit, përkatësisht me statutin e shkollës së lartë profesionale të pavarur.

(2) Në rast të pushimit të mandatit të drejtorit të shkollës së lartë profesionale e cila është njësia e universitetit para kalimit të afatit për të cilin është zgjedhur nga paragrafi (1) i këtij neni, rektori i universitetit emëron ushtrues të përkohshëm detyre drejtor për kohën e caktuar me statutin e universitetit.

(3) Në rast të ndërprerjes së mandatit të drejtorit të shkollës së lartë profesionale të pavarur para kalimit të afatit për të cilin është zgjedhur nga paragrafi (1) i këtij neni, emërohet ushtrues i përkohshëm i detyrës drejtor, me pëlqim paraprak të personit i cili e emëron, në mënyrë dhe kohë të caktuara me statutin e shkollës së lartë profesionale të pavarur.

(4) Мë së voni në afat prej tridhjetë ditë nga dita e emërimit të ushtruesit të përkohshëm të detyrës drejtor, këshilli i mësimdhënësve i shkollës së lartë profesionale fillon procedurë për zgjedhjen e drejtorit të ri.

(5) Shkarkimi i drejtorit dhe zëvendësdrejtorit rregullohen me statutin e shkollës së lartë profesionale, në pajtim me statutin e universitetit.

(6) Mandati i ushtruesit të përkohshëm të detyrës drejtor mund të zgjasë më së shumti gjashtë muaj, me ç'rast si ushtrues i përkohshëm i detyrës drejtor një person mund të emërohet vetëm një herë.

### **Drejtoria e dekanatit**

#### Neni 120

(1) Drejtoria e dekanatit, është organ i menaxhimit të fakultetit dhe mund të ketë më së paku pesë, ndërsa më së shumti pesëmbëdhjetë anëtarë.

(2) Drejtorinë e dekanatit, e përbëjnë dekani, prodekanët, dhe udhëheqësit e njësive të brendshme organizative mësimore-shkencore të caktuar me statutin e fakultetit, të zgjedhur në zgjedhje të fshehta dhe të drejtpërdrejta nga ana e anëtarëve të njësive organizative për periudhën prej tre vjet me të drejtë për një rizgjedhje dhe më së paku një anëtarë të zgjedhur nga kuvendi studentor i fakultetit.

(3) Drejtorinë e dekanatit e konvokon dhe mbledhjet i kryeson dekani.

(4) Drejtoria e dekanatit, në suazat e kompetencës së vet:

1. kujdeset për realizimin e veprimtarisë dhe zhvillimit të fakultetit, dhe për marrëdhëniet me bashkësinë më të gjerë shoqërore dhe organet shtetërore,

2. miraton akte për të cilat me statutin e universitetit ose statutin e fakultetit është caktuar se miratimi i tyre është në kompetencë të drejtorisë së dekanatit dhe e ndjek realizimin e tyre,

3. i përgatit dhe propozon aktet dhe materialet për çështje për të cilat vendos mësimorë-shkencorë, dekani dhe,

4. kryen punë tjera të caktuara me statutin e fakultetit.

(5) Drejtorisë së dekanatit nuk mund t'i besohen kompetencat as nuk mund të vendos për çështje me të cilat kufizohet dhe cenohet autonomia si njësi e universitetit.

(6) Organizimi, mënyra e punës së drejtorisë së dekanatit, si dhe numri dhe mënyra e zgjedhjes së përfaqësuesve të studentëve, më afër përcaktohen me statutin e fakultetit.

### **Drejtoria e shkollës së lartë profesionale**

#### Neni 121

(1) Drejtoria e shkollës së lartë profesionale është organ i menaxhimit të shkollës së lartë profesionale dhe mund të ketë së paku pesë, ndërsa më së shumti 15 anëtarë.

(2) Drejtoria e shkollës së lartë profesionale përbëhet prej drejtorit, zëvendësdrejtorit dhe udhëheqësve të njësive të brendshme mësimore organizative të përcaktuara me statutin e shkollës së lartë profesionale, të zgjedhur në zgjedhje të fshehta dhe të drejtpërdrejta nga anëtarët e njësive organizative për periudhë prej tre viteve me të drejtë për rizgjedhje dhe së paku një anëtar i zgjedhur nga kuvendi studentor i shkollës së lartë profesionale.

(3) Drejtoria e shkollës së lartë profesionale konvokon dhe me mbledhjet kryeson drejtori.

(4) Drejtoria e shkollës së lartë profesionale në suazat e kompetencave të saj:

1. kujdeset për realizimin e veprimtarisë dhe zhvillimin e fakultetit dhe për marrëdhëniet me komunitetin më të gjerë shoqëror dhe organet shtetërore,

2. miraton akte për të cilat me statutin e universitetit ose statutin e shkollës së lartë profesionale është përcaktuar se miratimi i tyre është në kompetencë të drejtorisë dhe e përcjell zbatimin e tyre,

3. i përgatit dhe propozon aktet dhe materialet për çështje për të cilat vendos këshilli i arsimtarëve dhe drejtori dhe

4. kryen edhe punë tjera të caktuara me statutin e shkollës së lartë profesionale.

(5) Drejtorisë së shkollës së lartë profesionale nuk mund t'i besohen kompetenca dhe as nuk mund të vendosë për çështje me të cilat kufizohet dhe shkelet autonomia si njësi e universitetit.

(6) Organizimi, mënyra e punës së drejtorisë së shkollës së lartë profesionale, si dhe numri dhe mënyra e zgjedhjes së përfaqësuesve të studentëve, më së afërmi caktohen me statutin e shkollës së lartë profesionale.

### **Këshilli për bashkëpunim dhe besim me publikun**

#### Neni 122

(1) Për të realizuar bashkëpunim dhe besim me publikun, bashkësia afariste, odat profesionale dhe institucionet tjera dhe shoqatat e qytetarëve nga rajoni në të cilin e kryen veprimtarinë e arsimit të lartë dhe punën shkencore-hulumtuese ose krijimtarinë artistike, si dhe për të realizuar publicitetin dhe përgjegjësinë për kryerjen e veprimtarisë me interes publik, njësi universitare krijon një bord të fakultetit për bashkëpunim dhe besim me publikun, përkatësisht këshill të shkollës së lartë profesionale për bashkëpunim dhe besim me publikun.

(2) Këshillat për bashkëpunim dhe besim me publikun të institucioneve të arsimit të lartë kanë rol këshillëdhënës dhe në to anëtarësojnë përfaqësues të themeluesit, përfaqësues relevant të bashkësisë afariste apo joekonomizimit nga fushëveprimi i programeve studimore.

(3) Anëtari i këshillit për bashkëpunim dhe besim me publikun nuk mund të jetë person i cili në pajtim me dispozitat e Ligjit për institucione nuk mund të jetë anëtarë i organit të menaxhimit të institucionit. Përbërja, mandati, mënyra e propozimit të anëtarëve të këshillit për bashkëpunim dhe kompetencat e tij caktohen me statutin e fakultetit, përkatësisht shkollës së lartë profesionale.

(3) Për çështjet për të cilat këshilli për bashkëpunim dhe besim me publikun debaton, miratohen rekomandime.

#### Kapitulli i nëntë

### **FINANCIMI DHE PRONA E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË**

#### **Mjetet për financim të arsimit të lartë**

#### Neni 123

(1) Mjetet për financimin e universiteteve publike, përkatësisht të shkollave të larta publike të pavarura profesionale dhe studimeve me interes publik sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe nga burime tjera të caktuara me ligj.

(2) Këshilli nacional çdo vit buxhetor, më së voni deri më 15 maj, ministrit kompetent për punët e arsimit të lartë ia propozon shumën e përgjithshme të mjeteve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për financimin e universiteteve dhe shkollave të larta profesionale të pavarura për vitin e ardhshëm buxhetor, në pajtim me Dekretin për matje dhe kritere për financimin e arsimit të lartë.

(3) Bazë kalimtare për financimin e institucioneve të arsimit të lartë janë planet financiare vjetore të institucioneve të arsimit të lartë.

(4) Planet financiare të institucioneve të arsimit të lartë përmbajnë:

1. Numrin e studentëve për regjistrim me participim dhe bursë,
2. Shpenzimet reale për realizim të çdo programi studimor në pajtim me specifikat e tij,

3. Shpenzimet rrjedhëse për punën e institucionit dhe

4. Shpenzimet për investime dhe zhvillim.

(5) Shpenzimet rrjedhëse (shpenzime komunale, mirëmbajtje, pajisje dhe material harxhues për realizimin e programeve studimore dhe për punën e institucionit të arsimit të lartë) të institucioneve të arsimit të lartë plotësisht kompensohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

### **Financim me mjete të personave fizikë dhe juridikë**

#### **Neni 124**

(1) Institucionet e arsimit të lartë mund të fitojnë mjete nga persona të vendit dhe të huaj juridikë dhe fizikë.

(2) Në mjetet e paragrafit (1) të këtij neni personat juridikë dhe fizikë të vendit dhe të huaj mund të kenë përshtatje tatimore dhe doganore të përcaktuara me ligj.

### **Të hyra tjera të institucioneve të arsimit të lartë**

#### **Neni 125**

(1) Institucionet e arsimit të lartë mund të fitojnë mjete edhe nga:

- participime;
- bursa;
- kryerjen e shërbimeve arsimore të personave juridikë dhe fizikë të vendit dhe të huaj;
- shitja e shërbimeve dhe prodhimeve shkencore dhe profesionale të personave juridikë dhe fizikë të vendit dhe të huaj;
- kamatat;
- të hyrat në bazë të të drejtave të pronësisë intelektuale bartësi i të cilës është institucioni i arsimit të lartë;
- të hyrat nga kryerja e veprimtarisë artistike;
- legate, dhurata, testamente, kontribute dhe
- burime tjera.

(2) Mjetet e paragrafit (1) të këtij neni janë të hyra personale të institucionit të arsimit të lartë me të cilat ai lirisht disponon në pajtim me ligjin dhe aktet e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë.

(3) Institucionet e arsimit të lartë janë të detyruara së paku 40% të mjeteve nga participimet t'i investojnë në zhvillim të mësimin, veprimtarisë shkencore-hulumtuese, përkatësisht artistike dhe mobilitetit.

(4) Mjetet e paragrafit (1) të këtij neni mund të akumulohen dhe të transferohen në vitin e ardhshëm fiskal.

### **Participimi**

#### **Neni 126**

(1) Universiteti publik, me propozim të njësisë së universitetit mund të vendosë participim në shpenzimet për studim, për studentët arsimimi i të cilëve financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(2) Shumën maksimale nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton Këshilli Nacional, me pëlqim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.



## **Bursa**

### **Neni 127**

(1) Universiteti privat, universiteti privat-publik apo shkolla e lartë e pavarur private profesionale, në suazat e numrit të studentëve të caktuar me konkursin cakton bursë për studim.

(2) Universiteti publik apo shkolla e lartë e pavarur publike profesionale, në suazat e numrit të studentëve të caktuar me konkursin mund të vendosë bursë për studim, për studentët arsimimi i të cilëve nuk financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(3) Shumën maksimale të paragrafit (2) të këtij neni e përcakton Këshilli Nacional, me pëlqim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(4) Studenti financimi i të cilit bëhet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë i cili pa shkaqe të arsyeshme nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me rregullat për studim në universitet publik, përkatësisht në shkollë të lartë profesionale të pavarur publike, i mban shpenzimet në shumën e bursës.

(5) Me bursën përcaktohen shpenzimet e studimit për një vit studimor, përkatësisht për fitimin e 60 SETK kredi.

## **Lirimi nga pagimi i participimit**

### **Neni 128**

(1) Institucioni i arsimit të lartë publik nuk do të paguajë participim për:

- persona pa prind më të rinj se mosha 26 vjeçare, nëse janë të papunësuar;
- persona me invaliditet, në pajtim me dekretin të cilin e miraton Qeveria me propozim të Këshillit Nacional;
- invalidë ushtarakë
- persona të rritur në shtëpi për fëmijë të braktisur nëse janë të papunësuar dhe
- persona tjerë të përcaktuar me dekretin e Qeverisë të miratuar me propozim të Këshillit Nacional.

(2) Mjetet për participim të këtyre personave do të mbulohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

## **Prona e patundshme dhe mjetet tjera të institucioneve të arsimit të lartë**

### **Neni 129**

(1) Prona e patundshme dhe gjërat tjera të institucionit të pavarur të arsimit të lartë dhe gjërat e fituara nga legate, shtojca me dedikim, dhurata, testamente dhe mjetet tjera të fituara në pajtim me ligj, janë pronë në pronësi të institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

(2) Institucioni i pavarur i arsimit të lartë disponon dhe menaxhon me pronën dhe i shfrytëzon gjërat, mjetet në para, të drejtat me pronësi intelektuale dhe të drejtat tjera materiale për kryerje të veprimtarisë së arsimit të lartë dhe shkencore hulumtuese, me kushte të caktuara me këtë Ligj dhe me statutin e institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

(3) Institucioni i pavarur publik i arsimit të lartë mund ta tjetërsojë pronën e patundshme me pëlqim paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(4) Mjetet e fituara nga shitja e pronës të paragrafit (3) të këtij neni përdoren për investime, mbajtje investuese dhe pajisje me pëlqim të marrë paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

## **Shfrytëzimi me dedikim i testamenteve, mjeteve të fondacioneve apo фондеve tjera me dedikim**

### Neni 130

(1) Patundshmëritë dhe mjetet tjera të dhëna si teste, mjetet e fondacioneve apo фондет tjera me dedikim institucioni i arsimit të lartë i shfrytëzon ekskluzivisht sipas dedikimit që e ka caktuar donatori, në pajtim me ligj.

(2) Patundshmëritë dhe prona tjetër të cilat institucioni i arsimit të lartë i ka fituar në bazë të testeve dhe dhuratave, janë pronësi e institucionit të arsimit të lartë i cili e ka fituar pronën.

## **Pronë e institucionit të arsimit të lartë që e ka ndërprerë punën**

### Neni 131

(1) Kur njësi e universitetit do ta ndërpret punën, prona, mjetet dhe të hyrat që mbesin pas plotësimit të obligimeve, i takojnë universitetit në përbërjen e të cilit është njësi e universitetit.

(2) Kur universiteti, përkatësisht shkolla e lartë e pavarur profesionale do ta ndërpret punën, prona, mjetet dhe të hyrat që mbesin pas plotësimit të obligimeve, i takojnë themeluesit.

### Kreu i dhjetë\

## **VEPRIMTARIA E ARSIMIT TË LARTË**

### Pjesa 1

## **CIKLE TË ARSIMIT TË LARTË**

### **Studime akademike dhe profesionale**

### Neni 132

(1) Arsimi i lartë realizohet nëpërmjet realizimit të studimeve akademike dhe profesionale në bazë të programeve të akredituara studimore.

(2) Studimet akademike i aftësojnë studentët për ndërtimin e karrierës akademike dhe profesionale nëpërmjet fitimit të kualifikimeve akademike dhe profesionale të arsimit të lartë.

(3) Studimet profesionale i aftësojnë studentët për ndërtimin e karrierës profesionale nëpërmjet fitimit të kualifikimeve profesionale të arsimit të lartë në pajtim me tregun e punës.

(4) Pas përfundimit të studimeve akademike jepet diplomë me të cilën vërtetohet përfundimi i studimeve dhe fitimi i titullit të caktuar akademik.

(5) Pas përfundimit të studimeve profesionale jepet diplomë me të cilën vërtetohet përfundimi i studimeve dhe fitimi i titullit të caktuar profesional.

## **Cikle të arsimit të lartë**

### Neni 133

(1) Programet studimore për fitimin e arsimit të lartë shpërndahen në tre cikle të arsimit të lartë.

(2) Studime të ciklit të parë janë:

1. cikli i parë i studimeve akademike (studime universitare) dhe
2. cikli i parë i studimeve profesionale.

(3) Studime i ciklit të dytë janë:

1. cikli i dytë i studimeve akademike (studime pasuniversitare) dhe

2. cikli i dytë i studimeve profesionale

(4) Studime të ciklit të tretë të studimeve akademike janë studime të doktoraturës.

(5) Secili cikël i studimeve përfundon me marrjen e emrit të caktuar në pajtim me Kornizën nacionale të kualifikimeve të arsimit të lartë të përcaktuar me Ligjin për kornizë nacionale të kualifikimeve.

(6) Programe të caktuara studimore mund të realizohen në mënyrë të integruar nëpërmjet ciklit të parë dhe të dytë.

(7) Secili cikël i studimeve patjetër duhet të jetë në pajtim me sistemin evropian për transfer të kredive me bartjen dhe akumulimin e kredive (në tekstin e mëtutjeshëm: SETK), sipas të cilit për një vit të studimeve fitohen 60 SETK kredi.

(8) Kualifikimet e arsimit të lartë regjistrohen në Regjistrin e Kornizës nacionale të kualifikimeve në pajtim me Ligjin për kornizë nacionale të kualifikimeve.

### **Cikli i parë i studimeve akademike - studime universitare**

#### Neni 134

(1) Cikli i parë i studimeve akademike (studime universitare) zgjat tre ose katër vjet dhe me përfundimin e tij fitohen 180, përkatësisht 240 SETK kredi.

(2) Në ciklin e parë të studimeve akademike, si dhe në studime akademike nga sfera e arteve mund të regjistrohet person i cili e ka kaluar maturën shtetërore apo maturën ndërkombëtare apo i cili ka mbaruar arsimin e mesëm katërvjeçar sipas rregullave të cilat kanë pasur vlerë para vendosjes së maturës shtetërore.

(3) Universiteti, përkatësisht shkolla e pavarur e lartë profesionale vendos cilat programe mësimore për arsim të mesëm janë adekuate për regjistrim në studime të veçuara akademike apo profesionale.

(4) Me programin studimor për studime universitare mund të parashihet puna përfundimtare (puna e diplomës).

(5) Personi i cili i ka përfunduar studimet universitare fiton titullin i diplomuar dhe shtesë të sferës përkatëse, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(6) Kualifikimet të cilat fitohen me përfundimin e programit studimor të studimeve universitare bëjnë pjesë në nivelin VI B për studimet universitare trevjeçare, përkatësisht në nivelin VI A për studimet universitare katërvjeçare të Kornizës nacionale të kualifikimeve të përcaktuar me Ligjin për kornizë nacionale të kualifikimeve dhe përputhen në nivelin VI të Kornizës Evropiane të kualifikimeve.

(7) Në qarkullimin ndërkombëtar dhe diploma në gjuhë angleze, titulli akademik pas përfundimit të studimeve universitare është bachelor apo baccalaureus, përkatësisht baccalaurea.

(8) Programet studimore të studimeve universitare studentit i sigurojnë kompetenca dhe aftësi metodologjike në një apo më shumë sfera shkencore apo artistike dhe e kualifikojnë të punojë në mënyrë të pavarur në suazat e profesionit të tij.

(9) Programet studimore nga studimet universitare sipas përmbajtjes dhe rezultateve nga mësimi duhet:

1. ta vendosin studentin në disiplinat akademike në një apo më shumë sfera shkencore ose artistike nëpërmjet inkuadrimin të teorive dhe metodave që të mund të fitojë njohuri dhe aftësi të gjera akademike,

2. t'i mundësojnë studentit njohuri akademike, kualifikime teorike dhe metodologjike të cilat do ta aftësojnë për identifikim të pavarur, formulim dhe zgjidhje të problemeve të komplikuar në suazat e pjesëve përbërëse adekuate të sferave në fjalë dhe

3. ta aftësojnë studentin aftësitë e fituara themelore të domosdoshme t'i zbatojë për praktikumin e profesionit në vende të caktuara profesionale të punës dhe për hyrjen në ciklin e dytë të studimeve akademike.

### **Cikli i dytë i studimeve akademike - studime pasuniversitare**

#### Neni 135

(1) Studimet e ciklit të dytë të studimeve akademike - studimet pasuniversitare organizohen si studime që zgjasin një vit, përkatësisht dy vjet dhe me përfundimin e tyre fitojnë 60 përkatësisht 120 SETK kredi.

(2) Studimet pasuniversitare mund të zgjasin edhe më shumë se dy vjet, nëse kjo është në përputhje me standardet e pranura ndërkombëtarisht për profil të dhënë.

(3) Në studime pasuniversitare mund të regjistrohet person i cili ka përfunduar programe përkatëse studimore të ciklit të parë. Universiteti dhe njësitë e tij përcaktojnë cilat studime universitare janë të përshtatshme për t'u regjistruar në programe individuale studimore në studimet pasuniversitare, si dhe kushtet për regjistrimin e kandidatëve të cilët kanë përfunduar programe tjera studimore.

(4) Në program studimor nga studime pasuniversitare i cili zgjat një vit dhe me të cilin fitohen 60 SETK kredi mund të regjistrohet vetëm një person i cili ka përfunduar studimet universitare në kohëzgjatje prej së paku 4 vitesh me të cilën ka fituar së paku 240 SETK kredi.

(5) Numri i përgjithshëm i kredive të cilat fitohen në studime akademike universitare dhe pasuniversitare arrin së paku 300 SETK kredi.

(6) Programi studimor për studime pasuniversitare në mënyrë të detyrueshme përmban obligimin për përpunimin e punimit të magjistraturës, si pjesë përfundimtare të programit studimor në studimet pasuniversitare.

(7) Programi studimor për studime pasuniversitare nga sfera e arteve përfshin edhe punim të magjistraturës dhe shfaqje/paraqitje të veprës apo ekspozitës artistike.

(8) Kushtet e veçanta për studimet akademike pasuniversitare nga sfera e artit i përcakton institucioni i arsimit të lartë me akt të veçantë.

(9) Personi i cili pas përfundimit të studimeve pasuniversitare ka fituar së paku 300 SETK kredi, gjithsej nga studimet universitare dhe pasuniversitare, fiton titullin – magjistër nga sfera përkatëse.

(10) Për mbrojtjen e punimit të magjistraturës të paragrafit (6) të këtij neni formohet komision i përbërë prej tre anëtarëve, nga të cilët së paku dy janë nga sfera përkatëse shkencore.

(11) Anëtar i komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të magjistraturës të paragrafit (6) të këtij neni, nuk mund të jetë person i cili me personin i cili e mbron punimin e magjistraturës është farefis gjaku në linjë të drejtë deri në cilën do shkallë, ndërsa në linjë anësore deri në shkallën e katërt, apo e ka bashkëshort/e, person me të cilin jeton në bashkësi jashtë martesore apo farefis sipas miqësisë deri në shkallën e dytë.

(12) Anëtarët e komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të magjistraturës nuk guxojnë ndërmjet tyre të jenë farefis gjaku në linjë të drejtë deri në cilën do shkallë, ndërsa në linjë anësore deri në shkallën e katërt, apo të jenë bashkëshortë, person të cilët jetojnë në bashkësi jashtë martesore apo farefis sipas miqësisë deri në shkallën e dytë.

(13) Personi i cili i ka përfunduar studimet pasuniversitare me së paku 300 SETK kredi të programeve studimore nga studimet universitare dhe pasuniversitare nga sfera e artit fiton titullin – magjistër i arteve.

(14) Në qarkullimin ndërkombëtar dhe diplomën e gjuhës angleze, emri shkencor pas përfundimit të studimeve pasuniversitare është master, Master of Science (MSc), përkatësisht Master of Arts (MA).

(15) Gjatë një viti mësimor, një mësimdhënës mund të caktohet mentor i më së shumti 12 kandidatëve të cilët përpunojnë punime të magjistraturës.

(16) Kualifikimet të cilat fitohen me përfundimin e programit studimor të studimeve pasuniversitare të paragrafit (1) të këtij neni bëjnë pjesë në nivelin VII A të Kornizës nacionale të kualifikimeve të përcaktuar me Ligjin për kornizë nacionale të kualifikimeve përputhen në nivelin VII të Kornizës Evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë.

(17) Kualifikimet të cilat fitohen me përfundimin e programit studimor të studimeve të integruara akademike të ciklit të parë dhe të dytë bëjnë pjesë në nivelin VII A të Kornizës nacionale të kualifikimeve të arsimit të lartë të përcaktuar me Ligjin për kornizë nacionale të kualifikimeve dhe përputhen në nivelin VII të Kornizës Evropiane të kualifikimeve.

### **Cikli i tretë i studimeve akademike - studime të doktoraturës**

#### **Neni 136**

(1) Studimet e doktoraturës zgjasin së paku tre vjet dhe kanë së paku 180 SETK kredi. Me mbrojtjen publike të punimit të doktoraturës fitohet titulli shkencor doktor i shkencave (dr.sc, PhD) përkatësisht doktor i arteve (dr. art).

(2) Studimet e doktoraturës mund të regjistrohen pas përfundimit të studimeve përkatëse të ciklit të dytë të studimeve akademike me së paku 300 SETK kredi të fituara nga cikli i parë dhe i dytë i studimeve (studime deri universitare dhe pasuniversitare) në mënyrë përmbledhëse. Me programin studimor të studimeve të doktoraturës mund të parashihet edhe se numri i nevojshëm i SETK kredive për regjistrimin e atij programi studimor arrin 360 SETK kredi nga cikli i parë dhe i dytë i studimeve (studime universitare dhe pasuniversitare) në mënyrë përmbledhëse. Universiteti mund të vendosë edhe kushte tjera për regjistrimin e studimeve të doktoraturës.

(3) Universiteti mund të organizojë studime nga cikli i tretë në kohëzgjatje më pak se tre vjet, me të cilat fitohet emërtimi specialist për rajon të caktuar (spec.). Emërtimit specialist përkatësisht shkurtesa e tij i shtohet titulli akademik i fituar nga cikli i dytë i studimeve akademike.

(4) Universiteti mund të përcaktojë se me përfundimin e studimeve të specializimit nga cikli i tretë fitohet emërtimi i ndryshëm nga emërtimi i përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni, në rast kur për një rajon të caktuar profesional me ligj të veçantë është përcaktuar përsosja e specializuar.

(5) Universiteti me akt të përgjithshëm e rregullon fitimin e SETK kredive të studimeve të doktoraturës dhe i përcakton SETK kreditë të nevojshme për paraqitjen e punimit të doktoraturës.

(6) Programi studimor për studimet e doktoraturës në mënyrë të detyrueshme përmban obligimin për përpunimin e punimit të doktoraturës (disertacion i doktoraturës), si pjesë përfundimtare e programit studimor të studimeve të doktoraturës.

(7) Në institucionet e arsimit të lartë të cilat realizojnë programe studimore të ciklit të tretë të studimeve universitare - të doktoraturës, mentor i punimeve të doktoraturës mund të jetë profesori–ordinar ose inordinar nga sfera shkencore përkatëse i cili është i punësuar në institucionin e arsimit të lartë, profesori ordinar ose inordinar marrëdhënia e punës e të cilit është në pezullim ose profesori i rregullt në pension, i cili ka qenë në marrëdhënie pune në institucionin e arsimit të lartë.

(8) Mentori i punimit të doktoraturës duhet të jetë i akredituar për mentor të studimeve të doktoraturës nga ana e Këshillit për Akreditim. Profesorët e paragrafit 7 të këtij neni mund të akreditohen për mentor për studime të doktoraturës nëse kanë botuar gjashtë punime shkencore

në publikim shkencor referent ose nëse kanë realizuar së paku tri ekspozita artistike kulmore përkatëse të ngjarjeve relevante të vendit dhe ndërkombëtare në pajtim me listën të cilën e përpilon Këshilli Nacional.

(9) Komisioni për Mbrojtjen e Punimit të Doktoraturës përbëhet prej pesë anëtarëve prej të cilët së paku tre janë nga sfera shkencore përkatëse të institucionit i cili i organizon studimet e doktoraturës.

(10) Anëtarë të komisionit nga paragrafi (9) i këtij neni mund të jenë persona të zgjedhur në titujt mësimorë-shkencorë profesor ordinar ose profesor inordinar.

(11) Në komisionin nga paragrafi (9) i këtij neni, anëtar nuk mund të jetë personi i cili me personin i cili e mbron punimin e doktoraturës (disertacion) është farefis gjaku në linjë të drejtë deri në cilën do shkallë, ndërsa në linjë anësore deri në shkallën e katërt, apo e ka bashkëshort/e, person me të cilin jeton në bashkësi jashtë martesore apo farefis sipas miqësisë deri në shkallën e dytë.

(12) Anëtarët i komisionit nga paragrafi (9) i këtij neni nuk guxojnë ndërmjet tyre të jenë farefis gjaku në linjë të drejtë deri në cilën do shkallë, ndërsa në linjë anësore deri në shkallën e katërt, apo janë bashkëshortë, persona të cilët jetojnë në bashkësi jashtë martesore apo farefis sipas miqësisë deri në shkallën e dytë.

(13) Institucioni i arsimit të lartë nuk do të lejojë mbrojtjen e punimit të doktoraturës kandidatit i cili para mbrojtjes së punimit të doktoraturës nuk ka botuar dy punime në publikim shkencor referent.

(14) Para mbrojtjes së disertacionit të doktoratës, e njëjta është e detyrueshme të botohet në ueb faqen e institucionit të arsimit të lartë ku zhvillohet cikli i tretë i studimeve, si dhe në bazën e resurseve të hapura arsimore dhe shkencore të cilën e mban Ministria kompetente për arsimin e lartë dhe e cila patjetër duhet të jetë e arritshme për publikun në internet.

(15) Numri i studentëve të cilët regjistrohen në programin e studimeve të doktoratës për të tre vitet e studimeve të doktoratës duhet të jenë në përputhje me numrin e mentorëve në dispozicion.

(16) Një profesor njëkohësisht mund të jetë mentor më së shumti për tre studentë të doktoraturës të cilët trajnohen tek ai për punë shkencore.

(17) Për një sferë shkencore mund të organizohet vetëm një program studimor të doktoraturës, përveç nëse raste të programeve studimore interdisiplinare.

(18) Programi studimor për studime të doktoraturës nga paragrafi 1 i këtij neni kryesisht përfshin punë hulumtuese aktive nën punën e mentorit dhe përfshin:

1. trajnim të organizuar akademik, që përmban kurse të përparuara dhe profesionale,
2. projekt hulumtues të pavarur nën punën e mentorit (projekt të doktoraturës),
3. mobilitet ndërkombëtar, së paku qëndrim njëjavësh,
4. ligjërata ose lloj tjetër të aktiviteteve komunikuese,
5. botimin e publikimeve shkencore referente dhe pjesëmarrje aktive në mbledhje ndërkombëtare në lidhje me punimin e doktoraturës dhe
6. përpunim dhe mbrojtje publike të punimit të doktoraturës në bazë të projektit të doktoraturës.

(19) Punimi i doktoraturës nga sfera e arteve përbëhet prej dy pjesëve: pjesa teorike dhe shfaqje/paraqitje publike e veprës artistike ose ekspozita.

(20) Dispozitat nga paragrafët (13) dhe (18) alinetë 5 dhe 6 të këtij neni nuk kanë të bëjnë me studimet e doktoraturës nga sfera e artit.

(21) Kualifikimet të cilat fitohen me përfundimin e programit studimor të studimeve të doktoraturës të paragrafit 1 të këtij neni bëjnë pjesë në nivelin VIII të Kornizës nacionale të kualifikimeve të arsimit të lartë të përcaktuar me Kornizën nacionale të kualifikimeve të përcaktuar me Ligjin për kornizë nacionale për kualifikime dhe përputhen me nivelin VIII të Kornizës Evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë.

## Studime profesionale

### Neni 137

(1) Studimet profesionale zbatohen në universitetin dhe në shkollën e lartë profesionale të pavarur.

(2) Në ciklin e parë të studimeve profesionale mund të regjistrohet person i cili e ka kaluar maturën shtetërore apo maturën ndërkombëtare apo i cili ka mbaruar arsimin e mesëm katërvjeçar sipas rregullave të cilat kanë pasur vlerë para vendosjes së maturës shtetërore.

(3) Studimet profesionale të ciklit të parë zgjasin tre vjet dhe me përfundimin e tyre fitohen 180 SETK kredi, përveç nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.

(4) Në suazat e ciklit të parë të studimeve profesionale mund të realizohen edhe programe të shkurtra studimore profesionale me 60 deri 120 SETK kredi.

(5) Me përfundimin e studimeve profesionale prej 60 deri 120 SETK kredi fitohet titulli profesional përkatës, në pajtim me ligj.

(6) Me përfundimin e studimeve profesionale me 180 SETK kredi merret diploma me shtesën e profesionit përkatës, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(7) Në qarkullimin ndërkombëtar dhe diplomën në gjuhën angleze, titulli profesional pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve profesionale është bachelor ose baccalaureus, përkatësisht baccalaurea, me shtimin e profesionit, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(8) Kualifikimet e fituara me përfundimin e programit studimor në ciklin e parë të studimeve profesionale i përkasin nivelit VI B për studimet profesionale trevjeçare në ciklin e parë, përkatësisht në nivelin V A për programet e shkurtra profesionale në ciklin e parë me 60 deri 120 SETK kredi të Kornizës nacionale për kualifikimet e arsimit të lartë të përcaktuara në Ligjin për kornizën nacionale të kualifikimeve dhe përputhen me nivelin VI, përkatësisht nivelin V të Kornizës Evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë.

(9) Universitetet dhe shkollat e larta profesionale mund të organizojnë studime profesionale të ciklit të dytë për personat të cilët kanë përfunduar programet përkatëse studimore në ciklin e parë të studimeve profesionale, përkatësisht akademike.

(10) Studimet profesionale të ciklit të dytë organizohen si studime të cilat zgjasin një vit dhe me përfundimin e tyre fitohen 60 SETK kredi.

(11) Numri i përgjithshëm i kredive të cilat fitohen në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve profesionale arrin 240 SETK kredi.

(12) Programi studimor nga cikli i dytë i studimeve profesionale prej 60 SETK në mënyrë të detyrueshme përmban obligimin për përpunimin e punimit të specializimit, si pjesë përfundimtare të programit studimor nga cikli i dytë të studimeve profesionale.

(13) Pjesa përfundimtare e programit studimor nga cikli i dytë prej 60 SETK të studimeve profesionale nga sfera e arteve përbëhet nga shfaqja/paraqitja publike e veprës artistike ose ekspozitës.

(14) Kushtet e veçanta për ciklin e dytë të studimeve profesionale nga sfera e artit i përcakton institucioni i arsimit të lartë me akt të veçantë.

(15) Për studimet profesionale nga paragrafi 14 i këtij neni zbatohen dispozitat e nenit 135 paragrafët (10), (11), (12) dhe (15).

(16) Personi i cili ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve profesionale prej 60 SETK kredi fiton emrin specialist të profesionit të caktuar.

(17) Në qarkullimin ndërkombëtar dhe diplomën e gjuhës angleze, emri pas përfundimit të studimeve profesionale nga cikli i dytë me të cilat janë fituar 60 SETK kredi është Specialist (Spec.).

(19) Kualifikimet të cilat fitohen me përfundimin e programit studimor nga cikli i dytë i studimeve profesionale bëjnë pjesë në nivelin VII B të Kornizës nacionale të kualifikimeve të arsimit të lartë të përcaktuar me Ligjin për kornizë nacionale të kualifikimeve përputhen me nivelin VII të Kornizës Evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë.

### **Titulli profesional dhe shkencor**

Neni 138

Titujt profesionalë dhe shkencorë caktohen në pajtim me ligj dhe me aktin e përgjithshëm të Këshillit nacional me të cilin përcaktohen titujt profesionalë dhe shkencorë.

Pjesa 2

### **PROGRAMET STUDIMORE**

#### **Programet studimore**

Neni 139

(1) Programet studimore vlerësohen me kredi sipas SETK. Secili vit i programit studimor përmban 60 kredi.

(2) Secila lëndë e programit studimor vlerësohet me numër të caktuar të SETK kredi.

(3) Programet e studimeve në të gjitha vitet e studimeve të studimeve universitare, pasuniversitare dhe të doktoratës duhet të përmbajnë lëndë të detyrueshme dhe zgjedhore mësimore, përveç programeve të studimit për profesionet e rregulluara të nenit 147 të këtij ligji, programet e studimit për studimet juridike dhe programet e studimit për trajnimin bazë të mësimdhënësve në arsimin fillor dhe të mesëm.

(4) Lëndët e detyrueshme mësimore në programin studimor duhet të jenë nga sfera përkatëse e njësisë së universitetit, përkatësisht të njësisë organizative të brendshme (institut, katedra, seksion).

(5) Lëndët zgjedhore mësimore studentët i zgjedhin nga lista e lëndëve zgjedhore mësimore në programin e dhënë studimor.

(6) Lëndët zgjedhore mësimore përbëjnë së paku 10% ndërsa më së shumti 30% nga numri i SETK kredive në programin studimor.

(7) Shuma e SETK kredive të lëndëve të cilat janë të përfaqësuara në listën e lëndëve zgjedhore mësimore të programit studimor është së paku dyfish më e madhe se numri i SETK kredive të parapara në programin mësimor për lëndët zgjedhore mësimore.

(8) Secila nga lëndët mësimore në listën e lëndëve zgjedhore mësimore në mënyrë të detyrueshme mban numrin e barabartë të SETK kredive.

(9) Në listën e lëndëve zgjedhore mësimore të programit mësimor i cili realizohet në njësinë e universitetit, mund të inkuadrohen edhe lëndë mësimore të cilat realizohen në njësi tjetër të universitetit.

(10) Programet e studimit të institucioneve të arsimit të lartë, në pjesën e lëndëve të detyrueshme dhe zgjedhore mësimore mund të përmbajnë edhe "dritare për mobilitet", përkatësisht lëndë mësimore aktivitetet e të cilave mund të realizohen edhe në gjuhën angleze.

(11) Kur universiteti i vendit realizon program studimor për fitimin e diplomës së përbashkët me universitetin e huaj, zbatohen rregullat e institucionit të arsimit të lartë ku realizohet program studimor në kuptim të krahasimit të përfaqësimit të lëndëve të detyrueshme dhe zgjedhore.



(12) Programi arsimor i cili është titulluar si program studimor i cili nuk është akredituar sipas këtij ligji nuk konsiderohet si program studimor nga cili do nga ciklet e arsimit, as me përfundimin e tij mund të fitohet cili do titull profesional ose shkencor i caktuar me këtë ligj.

### **Përmbajtja e programeve studimore**

Neni 140

(1) Programi studimor së paku përmban:

1. emrin e programit studimor në gjuhën maqedonase dhe angleze në pajtim me Klasifikimin e Fraskatit të rajoneve, fushave dhe sferave shkencore. Nëse programi studimor realizohet në gjuhë tjetër ndryshe nga gjuha maqedonase, ndërsa të cilën e shfrytëzojnë përfaqësuesit e bashkësive në Republikën e Maqedonisë, emri i programit studimor është në atë gjuhë, gjuhë maqedonase dhe gjuhë angleze,

2. qëllimet e programit studimor dhe rezultatet nga mësimi,

3. titulli akademik ose profesional i cili fitohet me përfundimin e studimeve,

4. shkalla ose niveli sipas kornizës nacionale për kualifikime e cila fitohet me përfundimin e studimeve.

5. Mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë nga fusha përkatëse shkencore dhe artistike për realizimin e përmbajtjeve në fjalë për të cilat zgjidhen edhe kualifikimet e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve për realizimin e përmbajtjeve në fjalë,

6. Ngarkim i programit studimor i shprehur në SETK dhe nëse është paraparë, kurse përgatitore,

7. Kushte për regjistrimin e programit studimor posaçërisht për: studentë të rregullt, të çrregullt dhe studentë të huaj të cilët inkuadrojnë lëndë relevante për programin studimor, nga matura shtetërore ose provim pranues me përmbajtje të qartë, të padyshimtë dhe të saktë të provimit, kohëzgjatjen, realizimin dhe vlerësimin e tij.

8. lista e lëndëve mësimore të detyrueshme dhe zgjedhore,

9. rregulla me të cilat rregullohen modulet, lëndët e detyrueshme dhe zgjedhore dhe përshkrimi i tij me:

- qëllim të lëndës dhe rezultate nga mësimi në pajtim me Kornizën nacionale të kualifikimeve të arsimit të lartë,

- përmbajtja e hollësishme e lëndës sipas kapitujve dhe njësive me rezultatet nga mësimi për secilin kapitull,

- ngarkim me lëndën i shprehur në SETK kredi,

- përshkrim i hollësishëm i metodave mësimore dhe të punës për lëndën,

- lidhje e ndërsjellë e lëndëve dhe

- parakushte të domosdoshme për dëgjim dhe dhënie të lëndës.

10. Rregulla me të cilat rregullohet shkrimi i provimeve me shkrim, detyrave, eseve, punimeve seminarike, projekteve, punimit të diplomës dhe aktiviteteve tjera të cilat realizohen me shkrim të cilat përfshijnë së paku përmbajtjen, madhësinë, mënyrën e të shkruarit dhe kërkesa tjera relevante.

11. vlera në SETK kredie punës përfundimtare të studimeve profesionale dhe akademike universitare dhe pasuniversitare, përkatësisht disertacionit të doktoraturës të studimeve akademike të doktoraturës,

12. mënyra e vlerësimit dhe përshkrimi i vlerësimit të arritjeve të studentit.

13. mundësi për realizimin e mësimin në gjuhë të huaj,

14. mundësitë për zgjedhjen e lëndëve nga programet tjera të akredituara studimore,

15. afatet për përfundimin e aktiviteteve të parapara nga programi studimor,

16. rregulla, mundësi dhe kushte për studim të çrregullt të programit studimor,

17. përmbajtja e shtesës së diplomës e cila jepet me përfundimin e programit studimor,  
18. fusha shkencore për programe studimore të ciklit të dytë të studimeve akademike dhe profesionale, për të cilat me përfundimin e programit studimor përkatës të ciklit të parë të studimeve, sigurohet kalimi përkatës,

19. mentorë të punimeve të doktoraturës ose magistraturës, për programet studimore të ciklit të dytë dhe të tretë dhe

20. çështje tjera me rëndësi për realizimin e programit studimor.

(2) Përmbajtja e programeve studimore rregullohet më hollësisht me Rregullore për përmbajtjen e programeve studimore të cilën e miraton Këshilli Nacional për Arsimin e Lartë.

(3) Programi studimor akreditohet, përkatësisht riakreditohet nga Këshilli për Akreditim në periudhën prej pesë vjet studimore.

### **Programe për përsosje profesionale**

#### Neni 141

(1) Universitetet dhe shkollat e larta profesionale mund të organizojnë programe të ndryshme të përsosjes profesionale duke pasur parasysh konceptin për mësim të përgjithshëm.

(2) Programet nga paragrafi (1) i këtij neni organizohen për shkak të përsosjes, plotësimit, thellimit dhe modernizimit të njohurisë dhe nuk konsiderohen për studime në kuptim të këtij ligji. Pas përfundimit të programeve për përsosje profesionale merret vërtetimi, përkatësisht certifikata të cilën e jep universiteti, përkatësisht shkolla e lartë e pavarur profesionale.

(3) Pjesëmarrësit në format për përsosje profesionale nuk kanë status të studentëve.

(4) Format për përsosje profesionale dhe kushtet tjera për organizimin e tyre, si dhe të drejtat dhe obligimet e personave të cilët i kanë vizituar rregullohen me akt të përgjithshëm të universiteteve dhe njësive të tyre, në pajtim me statutin e universitetit, përkatësisht të shkollës së lartë të pavarur profesionale.

(5) Përveç programeve për përsosje profesionale, universiteti dhe njësiti e tij, përkatësisht shkolla e lartë e pavarur profesionale, mund të organizojnë edhe forma të ndryshme e mësimi joformal, si kurse, universitete verore dhe dimërore, shkolla, punëtori dhe ngjashëm. Pas përfundimit të formës përkatëse të mësimi joformal merret vërtetimi, përkatësisht certifikatë të cilën e jep universiteti apo njësia e universitetit, përkatësisht shkolla e lartë e pavarur profesionale.

### **Arsimi profesional më i shkurtër se tre vjet**

#### Neni 142

(1) Për fitimin e njohurive dhe trajnimeve profesionale institucionet e arsimit të lartë mund të organizojnë arsim profesional me kohëzgjatje edhe më të shkurtër se tre vjet.

(2) Për njohuritë e fituara profesionale dhe trajnimet nga paragrafi (1) i këtij neni jepet certifikatë apo dokument tjetër të përcaktuar në statutin e universitetit, përkatësisht me statutin e njësisë së universitetit, përkatësisht me statutin e shkollës së lartë të pavarur profesionale.

(3) Personit i cili ka marrë certifikatë apo dokument tjetër për njohuri profesionale, sipas programit i cili është pjesë e programit të akredituar studimor nga cikli i parë i studimeve profesionale të arsimit të lartë mundet njohuria profesionale dhe trajnimi të fituar të shprehur në kredi t'i pranohet si pjesë e programit studimor të arsimit të lartë. Kreditë e fituara shënohen në certifikatën apo dokumentin tjetër nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Personi i cili ka fituar njohuri dhe kredi në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni dhe ka njohuritë e fituara nga forma të tjera të të mësuarit që do të vlerësohen në mënyrë adekuate nga institucioni i arsimit të lartë mund t'i vazhdojë studimet sipas programit studimor të

përshtatshme për kreditë e fituara dhe njohuritë e vlerësuara, sipas kushteve të përcaktuara me statutin e universitetit dhe statutin e njësisë, përkatësisht statutin e shkollës së pavarur të lartë profesionale.

### **Programi studimor për diplomë të përbashkët**

#### Neni 143

(1) Programi studimor për marrjen e diplomës së përbashkët është program studimor të cilin universiteti, përkatësisht njësia e tij, përkatësisht shkolla e lartë profesionale e pavarur e pranon dhe realizon së bashku me një ose më shumë universitete, përkatësisht shkolla të larta të pavarura profesionale nga Republika e Maqedonisë ose nga vendi i huaj të akredituara në vendin në të cilin edhe është selia.

(2) Diploma e përbashkët është dokument publik në të cilin në mënyrë të detyrueshme janë theksuar universitetet dhe njësitë e tyre, përkatësisht shkollat e larta të pavarura profesionale të cilat në mënyrë të përbashkët kanë marrë pjesë gjatë realizimit të programit studimor. Përbajtjen dhe vëllimin e diplomës së përbashkët si dhe shtojcat e diplomës i caktojnë universiteti, përkatësisht shkolla e lartë profesionale e pavarur e cila ka marrë pjesë gjatë realizimit të programit studimor për diplomë të përbashkët.

### **Gjuhët në të cilat realizohet mësimi**

#### Neni 144

(1) Mësimi në institucionet e arsimit të lartë realizohet në gjuhën maqedonase.

(2) Përfaqësuesit e bashkësive për shkak të shprehjes, edukimit dhe zhvillimit të identitetit të tyre dhe veçorive të tjera, kanë të drejtë mësimin në institucionet publike të arsimit të lartë, sipas programeve dhe përbajtjeve përkatëse të studimit, ta realizojnë në gjuhën e bashkësisë, ndryshe nga gjuha maqedonase, në pajtim me këtë ligj dhe statutin e institucionit të arsimit të lartë. Financimi nga ana e shtetit do të sigurohet për arsimin e lartë edhe në gjuhën në të cilën flasin së paku 20% e popullsisë në Republikën e Maqedonisë.

(3) Mësimi në institucionet e arsimit të lartë pedagogjik publik për edukimin e edukatorëve për edukimin parashkollor dhe mësimdhënësit për arsimin fillor si dhe për lëndët didaktiko-metodike për mësimdhënësit e arsimit të mesëm, mund të zhvillohen edhe në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive tjera të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, mësimi në institucionet e arsimit të lartë mund të zhvillohet në ndonjë nga gjuhët botërore.

(5) Mësimi në institucionet private të arsimit të lartë mund të zhvillohet edhe në gjuhët e përfaqësuesve të bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë apo në gjuhët botërore.

(6) Kur mësimi zhvillohet në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë ose në gjuhët botërore, në pajtim me paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni, gjuha maqedonase mësohet si një lëndë e veçantë mësimore dhe mësimi zhvillohet në gjuhën maqedonase së paku edhe për dy lëndë mësimore nga programi studimor.

(7) Në universitet mësimi për së paku dy programe studimore për ciklin e parë të studimeve akademike dhe së paku dy programe studimore për ciklin e dytë të studimeve akademike dhe profesionale në mënyrë të detyrueshme zhvillohet dhe jepet në gjuhën angleze.

## **Organi që i miraton programet studimore**

### Neni 145

(1) Programet studimore nga cikli i parë, dytë dhe tretë dhe programet studimore për përsosje i miraton senati i universitetit me propozim të këshillit mësimor-shkencor të fakultetit, këshilli i mësimdhënësve të shkollës së lartë profesionale apo këshilli shkencor i institutit shkencor në përbërje të universitetit, përkatësisht këshilli i mësimdhënësve të shkollës së lartë profesionale të pavarur.

(2) Akreditimin e programeve studimore nga cikli i parë, i dytë dhe i tretë e kryen Këshilli për Akreditim me aktvendim. Aktvendimi për akreditim e programit studimor nga cikli i dytë dhe i tretë në mënyrë të detyrueshme i përmban mentorët e punimeve të magistraturës dhe doktoraturës të programeve studimore.

(3) Aktvendimi për akreditim i Këshillit për Akreditim jepet për periudhën prej pesë vite shkollore.

(4) Pas aktvendimit të marrë për akreditim nga Këshilli për Akreditim, Drejtori i Agjencisë për Kualitet formon komision për përcaktimin e plotësimit të kushteve për fillimin me punë të programeve studimore.

(5) Komisioni nga paragrafi (4) është përbërë prej tre anëtarëve nga të cilët dy janë nga radha e të punësuarve në Agjencinë për Kualitet, ndërsa një është nga personat e zgjedhur në titujt mësimorë-shkencorë, mësimorë apo shkencorë të institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë.

(6) Aktvendim për fillimin me punë të programeve studimore nga cikli i parë dhe i dytë jep Drejtori i Agjencisë për Kualitet pas akreditimit të marrë nga ana e Këshillit për Akreditim dhe pas raportit të marrë pozitiv për plotësimin e kushteve për fillimin me punë të programeve studimore. Aktvendimi në mënyrë të detyrueshme botohet në ueb faqen e Agjencisë për Kualitet.

(7) Aktvendim për fillimin me punë të programeve studimore nga cikli i tretë jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë pas akreditimit të marrë nga ana e Këshillit për Akreditim dhe pas raportit të marrë pozitiv për plotësimin e kushteve për fillimin me punë të programeve studimore. Aktvendimi në mënyrë të detyrueshme botohet në ueb faqen e Agjencisë për Kualitet.

(8) Raportet dhe aktvendimet për akreditim të programeve studimore plotësisht botohen në ueb faqen e Agjencisë për Kualitet.

(9) Njësia e universitet, instituti shkencor apo institucioni i pavarur i arsimit të lartë në mënyrë të detyrueshme i boton publikisht programet studimore dhe aktvendimin për fillimin me punë të programit studimor në ueb faqe dhe në mënyrë tjetër më së voni deri në shpalljen e konkursit për regjistrim të studentëve.

(10) Institucionet publike të arsimit të lartë mund të realizojnë edhe programe të akredituara të cilat nuk financohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

## **Afatet për miratimin e aktvendimit për akreditim dhe aktvendim për fillimin me punë të programeve studimore**

### Neni 146

(1) Këshilli për akreditim e miraton aktvendimin për akreditim të programit studimor në afat prej 90 ditë nga dita e parashtrimit të dokumentacionit të plotë.

(2) Aktvendimi për akreditim i programit studimor është përfundimtar dhe kundër tij mund të parashtrohet padi te Gjykata Administrative.

(3) Drejtori i Agjencisë për Kualitet e miraton aktvendimin për fillim me punë të programit studimor të nenit 145 paragrafi (6) të këtij ligji në afat prej 30 ditë nga dita e parashtrimit të dokumentacionit të plotë.

### **Programme studimore për profesione të rregulluara**

#### **Neni 147**

Me përjashtim të dispozitave të këtij ligji, kohëzgjatja dhe përmbajtja e studimeve për titujt të cilët fitohen në secilin cikël të studimeve të cilët janë të lidhur me kryerjen e profesioneve të rregulluara janë:

1. Programet studimore akademike nga sfera e mjekësisë së përgjithshme përfshijnë së paku gjashtë vjet të shkollimit ose 5.500 orë në trajnim teorik dhe praktik i cili zhvillohet në universitet;

2. Programi i specializuar për mjekësi përfshin mësimin teorik dhe praktik në universitet ose në spital universitar ose, ku është e përshtatshme, institucion për kujdes shëndetësor, i miratuar për atë qëllim nga ana e ministrisë kompetente për punët nga sfera e shëndetësisë;

3. Specializimi nga sfera e mjekësisë rregullohet me ligj të veçantë;

4. Programi studimor akademik nga sfera e stomatologjisë (doktor i mjekësisë dentare) përfshin programin studimor në kohëzgjatje prej së paku pesë vjet ose 5.000 orë i cili përbëhet nga pjesa teorike dhe praktike;

5. Programi stomatologjik i specializuar përfshin mësimin teorik dhe praktik në qendrën klinike universitare të miratuar për atë qëllim nga ana e Ministrisë kompetente për punët nga sfera e shëndetësisë;

6. Specializimi nga sfera e stomatologjisë rregullohet me ligj të veçantë;

7. Programi studimor akademik themelor për doktor të mjekësisë veterinerë përfshin mësimin teorik dhe praktik në formë të rregullt me kohëzgjatje minimale prej pesë vjetësh, i cili e përfshin si minimum programin e përshkruar me rregullat e Bashkimit Evropian, të zbatuar në njësinë e universitetit e cila kryen mësim në pajtim me këtë ligj;

8. Programi studimor i studimeve profesionale për infermiere me profil të përgjithshëm zgjat së paku tre vjet ose përfshin 4.600 orë trajnim teorik dhe klinik, gjatë të cilit periudha e mësimit teorik paraqet së paku një të tretën dhe periudha e mësimit klinik paraqet së paku gjysmën e kohëzgjatjes minimale të trajnimit;

9. Programi studimor i studimeve profesionale për akushere përfshin mësimin teorik dhe praktik me kohëzgjatje minimale prej tre vjetësh, i cili si minimum e përfshin programin e përshkruar me rregullat e Bashkimit Evropian;

10. programi studimor akademik themelor për farmacistë përfshin mësimin teorik dhe praktik në formë të rregullt me kohëzgjatje prej së paku pesë vjetësh, i cili e përfshin si minimum programin e përshkruar me rregullat e Bashkimit Evropian, të zbatuar në njësinë e universitetit e cila kryen mësim në pajtim me këtë ligj dhe i cili përfshin së paku:

a) mësimin e rregullt katërvjeçar teorik dhe praktik të siguar në universitet dhe

b) stazh gjashtëmujor në barnatore të hapur për publikun ose në spital, nën mbikëqyrjen e repartit farmaceutik të spitalit;

11. Specializimi nga sfera e farmacisë rregullohet me ligj të veçantë dhe

12. Programi studimor akademik për arkitekt në mënyrë të detyrueshme përfshin së paku studime pesëvjeçare të cilat përfundojnë me dhënien e suksesshme të provimit përfundimtar.

## **Bartja e kredive**

### Neni 148

(1) Kreditë mund të barten prej njërit në programin tjetër studimor të njëjtë, të ngjashëm ose të ndryshëm në suazat e një universiteti, përkatësisht prej njërit në universitetin tjetër, përkatësisht prej njërit në institucionin tjetër të arsimit të lartë të pavarur.

(2) Kriteret dhe kushtet për bartjen e kredive dhe kushtet për kalim ndërmjet programeve studimore rregullohen më afër me akt të përgjithshëm të universitetit, përkatësisht të shkollës së lartë profesionale të pavarur, përkatësisht me marrëveshjen e lidhur ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë.

### Kreu 3

## **KUSHTET DHE MËNYRA E REGJISTRIMIT TË STUDIMEVE**

### **Mënyra e regjistrimit të studimeve**

### Neni 149

(1) Regjistrimi i studimeve kryhet në bazë të konkursit publik të shpallur nga universiteti, përkatësisht shkolla e lartë profesionale e pavarur që i realizon studimet së paku pesë muaj përpara fillimit të mësimet.

(2) Konkursi për regjistrimin e studimeve nga paragrafi (1) i këtij neni përmban: 1. emrin e institucionit të arsimit të lartë dhe adresën e tij,

2. titullin e programit studimor,

3. vendin e realizimit të programit studimor,

4. kohëzgjatjen e studimeve,

5. kushtet e regjistrimit,

6. numrin e parashikuar të vendeve të lira për regjistrim,

7. procedurat dhe afatet për paraqitjen dhe për realizimin e regjistrimit të studimeve.

8. shumën e participimit ose e shkollimit, nëse studenti është i detyruar t'i paguajë.

(3) Universiteti, përkatësisht shkolla e lartë profesionale e pavarur, përcakton procedurën për zgjedhjen e kandidatëve për regjistrim në atë mënyrë që garanton barazinë e të gjithë kandidatëve pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, bindjet politike ose të tjera, origjina nacionale ose sociale, prona, lindja, statusi social, aftësia e kufizuar, orientimi seksual dhe mosha.

(4) Universiteti, përkatësisht shkolla e lartë profesionale e pavarur, përcakton kriteret në bazë të të cilave bëhet selektimi dhe zgjedhja e kandidatëve për regjistrim të studimeve.

(5) Për institucion publik të arsimit të lartë, konkursi shpallet nga universiteti ose shkolla e lartë profesionale e pavarur në mënyrën e përcaktuar me statut dhe me pëlqimin paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(6) Për institucionet private-publike dhe arsimin e lartë privat konkursi publikohet nga institucioni i arsimit të lartë në mënyrën e përcaktuar me statutin e tij.

(7) Studentët shtetas të huaj regjistrohen në studimet e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë nën të njëjtat kushte si shtetasit e Republikës së Maqedonisë dhe paguajnë bursë të shkollimit në shumën e përcaktuar nga universiteti ose shkolla e lartë profesionale e pavarur.

### **Vlerësimi i barabartë i arsimit të huaj**

#### Neni 150

(1) Konsiderohet se kushtet për regjistrim nga nenet 134, 135 dhe 136 të këtij ligji i përmbush dhe personi që ka kryer arsimin përkatës jashtë shtetit.

(2) Me aktin e përgjithshëm që e miraton senati i universitetit përcaktohen kushtet për regjistrim nga paragrafi (1) i këtij neni për personin që nuk ka kryer arsimin e barabartë jashtë shtetit.

### **Vendimi për numrin e studentëve që regjistrohen**

#### Neni 151

(1) Vendimi për numrin e studentëve që regjistrohen në institucionet publike të arsimit të lartë, arsimit i të cilëve financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, me propozim të institucioneve publike të arsimit të lartë, miraton Qeveria e Republika e Maqedonisë.

(2) Vendim për numrin e studentëve që regjistrohen në institucionet publike të arsimit të lartë jashtë nga numri të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, miraton universiteti, sipas kushteve të përcaktuar në këtë ligj.

(3) Numri i përgjithshëm i studentëve që mundën të regjistrohen në institucionet të arsimit të lartë sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni përcaktohet sipas kapacitetit të përcaktuar me aktvendim për akreditim të institucionit të arsimit të lartë.

(4) Vendim për numrin e studentëve që regjistrohen në institucionet private të arsimit të lartë, miraton këshilli mësimor-shkencor, përkatësisht këshilli mësimdhënës, sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj. Numri i studentëve nuk mund të jetë më i lartë se numri i përcaktuar sipas kapacitetit të përcaktuar nga aktvendimi i akreditimit të institucionit privat të arsimit të lartë.

(5) Për vendimin për numrin e studentëve që regjistrohen në studime nga cikli i tretë në institucionin privat të arsimit të lartë pëlqimi jep Qeveria, me propozim të këshillit mësimor-shkencor, përkatësisht të këshillit të institucionit shkencor.

(6) Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton vendim dhe për kuota plotësuese për regjistrimin e studentëve që janë anëtarë të sindikatave që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

### **Kapitulli 4**

## **VËLLIMI I STUDIMIT DHE KONTROLI I NJOHURIVE**

### **Fillimi dhe mbarimi i vitit studimor**

#### Neni 152

(1) Vitit studimor fillon me 1 tetor, ndërsa mbaron më 30 shtator vitin e ardhshëm dhe ndahet në dy semestra, i dimrit dhe i verës ose në tre semestra, me mundësi që mësimi të realizohet në cikle.

(2) Fillimi dhe kohëzgjatja e mësimit me semestra përcaktohet me statutin e universitetit, përkatësisht institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

## **Vëllimi dhe organizimi i studimeve**

### **Neni 153**

(1) Në kuadër të më së shumti 40 javëve në vit, gjithsej ngarkesa e studentëve arin prej 1.500 deri në 1.800 orë në vit.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni programet studimore nga cikli i parë përmbajnë më së shumti 20, ndërsa më shumë 30 orë ligjërata, ushtrime dhe seminare javore dhe 30 javë në vit.

(3) Me përjashtim, nëse programi i studimit përmban trajnim praktik, ngarkesa e përgjithshme e studentëve nuk duhet të kalojë 40 orë në javë dhe 45 javë në vit.

(4) Ngarkesa e studentëve nga paragrafi (1) i këtij neni përfshin ligjërata, ushtrime, seminare, mësimet individuale dhe lloje tjera të studimeve që janë përkatëse në specifikat e fushës arsimore-shkencore dhe artistike (trajnim praktik, hospitation, shfaqje, punë në terren dhe të ngjashme), mësimdhënie konsultative-udhëzuese, format e vlerësimit të vazhdueshëm të njohurive dhe provimeve të cilat konsiderohen si orë të kontaktit dhe punës studimore individuale (punë sportive, letërsi kërkimore, detyra të seminarit, punë të projektit), mësim i pavarur, si dhe punimi i detyrës së diplomimit (magjistraturës, doktoraturës).

## **Verifikimi i njohurive**

### **Neni 154**

(1) Verifikimi i njohurisë së studentit, sipas lëndëve mësimore, kryhet gjatë procesit mësimor-arsimor dhe shprehet në pikë.

(2) Për plotësimin e detyrimeve për dhënien e provimit (në pjesë ose në tërësi) studenti merr notën e shprehur në numra prej 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë), me ç'rast nota 5 (pesë) shënon sukses të pamjaftueshëm.

(3) Verifikimi i njohurive në lëndët të caktuara mësimore kryhet në mënyrën e përcaktuar nga mësimdhënësi i lëndës, ndërsa në cilën mënyrë përfshihet në programin studimor dhe zbatohet brenda afateve të përcaktuara me statutin e institucionit të arsimit të lartë.

(4) Universiteti, ose shkolla e lartë profesionale e pavarur me akt të përgjithshëm të miratuar nga senati i universitetit, Këshilli i arsimtarëve të shkollës së lartë profesionale përcakton mënyrat e mundshme të kontrollit të njohurive.

(5) Vlerësimi përfundimtar është i detyrueshëm të shënohet në indeks ose në ndonjë dokument tjetër dhe në aplikacionin për vlerësimin përfundimtar dhe / ose në sistemin elektronik.

(6) Certifikata ose dokumenti i vlerësimit përfundimtar do të lëshohet në bazë të të dhënave në paraqitjen e provimeve për çdo program të kursit, të nënshkruar nga mësimdhënësi.

(7) Arritja mesatare e studentit është mesatarja aritmetike e notave të vlerësimit përfundimtar për të gjitha lëndët gjatë studimeve të programit studimor, duke përfshirë provimin përfundimtar nëse e njëjta është e përcaktuar në programin studimor.

### **Seksioni 5**

## **DIPLOMA**

### **Diploma dhe Shtesa e diplomës**

### **Neni 155**

(1) Studenti i cili i plotëson të gjitha detyrimet në kuadër të programit studimor për të marrë arsimin e lartë në çdo cikël arsimor, universitetin dhe njësinë universitare ose shkollën e lartë profesionale të pavarur, në bazë të evidencës që mbahet për të i lëshon diplomë.



(2) Diploma nga paragrafi (1) i këtij neni konfirmon që studentit ka përfunduar program studimor të ciklit të parë, të dytë ose të tretë dhe fiton titullin përkatës profesional ose shkencor. Pjesë përbërëse e diplomës është shtesa e diplomës.

(3) Diploma dhe shtesa e diplomës universitare nënshkruhet nga rektori, dekani ose drejtori i njësisë universitare dhe vërtetohet me vulë universitare të thatë.

(4) Diplomën dhe shtojcën e diplomës së shkollës së lartë profesionale të pavarur e nënshkruan drejtori dhe vërtetohet me vulën e thatë të shkollës së lartë të pavarur profesionale.

(5) Diplomën dhe shtesën e diplomës së përbashkët e nënshkruajnë personat e autorizuar të institucioneve të arsimit të lartë, të cilët organizojnë program studimor për marrjen e diplomës së përbashkët.

(6) Studentit i cili i plotëson të gjitha detyrimet sipas programit studimor për përsosje ose vetëm një pjesë e programit studimor për marrjen e arsimit, i lëshohet një certifikatë për pjesën e përfunduar të programit studimor që përmban të dhëna për nivelin, natyrën dhe përmbajtjen e studimeve, si dhe rezultatet e arritura.

(7) Dokumentet e tjera publike, në kuptim të këtij ligji, janë: certifikata, legjitimacioni i studentit dhe indeksi.

(8) Certifikata, legjitimacioni i studentit dhe indeksi i studentit për pjesëtarët e komunitetit që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase ndërsa e flasin paktën 20% e qytetarëve, ndërsa të cilët ndjekin mësimin në gjuhë tjetër zyrtare përveç gjuhës maqedonase, lëshohet në gjuhë maqedonase alfabetin cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin e asaj bashkësie.

(9) Diploma dhe shtesa e diplomës për pjesëtarët e komunitetit që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, ndërsa e flasin së paku 20% të qytetarëve, ndërsa të cilët ndjekin mësimin në gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin e asaj bashkësie, nëse përcaktohet kështu nga statuti i universitetit.

(10) Përmbajtja dhe forma e diplomës dhe udhëzimi për përgatitjen e një shtojce të diplomës dhe dokumenteve të tjera publike të përcaktuara me këtë ligj, përcaktohen nga ministri përgjegjës për çështjet e arsimit të lartë.

### **Heqja e diplomës**

#### **Neni 156**

(1) Studentit i cili ka fituar diplomë, në pajtim me këtë ligj, mund t'i hiqet diploma e lëshuar, përkatësisht titulli i fituar profesional apo shkencor, nëse përcaktohet se ai nuk i ka plotësuar kushtet për marrjen e statutit të studentit në institucionin përkatës të arsimit të lartë, se ka fituar titullin profesional ose shkencor në kundërshtim me kushtet për fitimin e titullit profesional përkatësisht shkencor të përcaktuara me statutin e institucionit të arsimit të lartë ose me ligj.

(2) Kushtet dhe procedura për heqjen e diplomës së lëshuar përcaktohen me rregulloren e universitetit ose shkollës së lartë profesionale të pavarur.

### **Promovimi për studime të përfunduara**

#### **Neni 157**

(1) Promovimin e personave që kanë përfunduar programet e studimeve profesionale ose akademike në ciklin e parë të studimeve ose programet studimore në ciklin e dytë të studimeve e kryen dekani, që është drejtori i njësisë së universitetit ose drejtori i shkollës së lartë profesionale të pavarur sipas procedurës të përcaktuar me rregullat e njësisë së universitetit, shkollës së lartë profesionale të pavarur ose institucionit shkencor.

(2) Promovimi i personave që kanë përfunduar programet e studimeve të doktoraturës në ciklin e tretë, kanë fituar titullin shkencor doktor i shkencave e kryen rektori i universitetit, në përputhje me procedurën e përcaktuar me statutin e universitetit.

### **Mbajtja dhe mbrojtja e të dhënave personale**

#### Neni 158

(1) Institucionet e arsimit të lartë mbajnë evidencën në vijim me të dhënat personale për studentët:

- 1) evidencën e studentëve të paraqitur për regjistrim dhe studentëve të regjistruar;
- 2) kartë personale që mbahen për secilin student që nga fillimi i studimeve deri në përfundimin e studimeve ose deri në çregjistrim;
- 3) procesverbalin e provimit me të cilin evidentohet fletëparaqitja e provimit, rrjedha e provimit dhe nota e fituar dhe
- 4) evidencën e dokumenteve të lëshuara për studimet e përfunduara.

(2) Evidencat nga paragrafi (1) pikat 1), 2) dhe 4) të këtij neni përfshijnë: emrin dhe mbiemrin e studentit (për studentet dhe mbiemrin e vajzërisë), gjininë, datën, vendin dhe datën e lindjes, vendin e lindjes, vendbanimin ose vendqëndrimin, numrin unik emë të qytetarit, shtetësinë, arsimin e mëparshëm, mënyrën e studimit si dhe të dhëna të tjera sipas rregullave të veçanta.

(3) Evidenca nga paragrafi (1) pika 2 të këtij neni, krahas të dhënave të parapara në paragrafin (2) të këtij neni përfshin edhe të dhëna për provimet e kaluara, për progresin dhe përfundimin e studimeve.

(4) Evidenca nga paragrafi (1) pika 3 e këtij neni përfshin: emrin dhe mbiemrin e studentit, (për studentet edhe mbiemrin e vajzërisë), gjininë, numrin unik amë të qytetarit, mënyrën e studimit, vitin studimor dhe vitin studimor të regjistrimit të parë, datën e provimit, të dhënat për atë nëse e jep provimin për herë të parë ose e përsërit atë, si dhe notën e fituar në provim.

(5) Dispozitat lidhur me mbajtjen, shfrytëzimin dhe ruajtjen e të dhënave personale nga evidencat sipas këtij ligji do të përdoren gjithashtu edhe për dokumentacionin, në bazë të të cilit janë grumbulluar të dhënat personale. Dokumentet për arsimin e mëparshëm pas përfundimit të procedurës së regjistrimit i kthehen studentit.

### **Libri amë i studentëve të regjistruar, libri kryesor i studentëve të diplomuar**

#### Neni 159

(1) Në institucionet e arsimit të lartë mbahen libri amë i studentëve të regjistruar dhe libri kryesor i studentëve të diplomuar dhe dosje të secilit student. Formën dhe mënyrën e mbajtjes (në letër dhe elektronike) dhe përmbajtjen e regjistrimit të studentëve të regjistruar dhe librit kryesor të studentëve të diplomuar e përcakton ministri përgjegjës për çështjet e arsimit të lartë.

(2) Libri amë i studentëve të regjistruar dhe libri i përgjithshëm i të diplomuarve janë dokumente të përhershme.

Kapitulli i njëmbëdhjetë

TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, MËSIMORË- PROFESIONALË, MËSIMORË DHE  
BASHKËPUNËTORË

Seksioni 1

DISPOZITAT THEMELORE

**Personat e punësuar në institucionet e arsimit të lartë**

Neni 160

(1) Të punësuarit në institucionet e arsimit të lartë janë:

1. persona të zgjedhur me tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, tituj mësimorë dhe tituj bashkëpunëtorë, që kryejnë veprimtari të arsimit të lartë (në tekstin e mëtejshëm: kuadri mësimor) dhe

2. persona të punësuar në shërbimin profesional dhe administrativ dhe persona të ndihmës-tekhnike (në tekstin e mëtejshëm: kuadri mësimor) dhe

(2) Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në institucionet e arsimit të lartë rregullohen me rregulla të përgjithshme për marrëdhënie pune, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e kuadrit mësimor rregullohen me dispozitat e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(4) Shtetasi i huaj mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë njësoj si shtetasi i Republikës së Maqedonisë, me kushte të përcaktuara me këtë ligj.

(5) Në institucionet e arsimit të lartë mbahet evidencë elektronike gjatë kohës së punës të kuadrit arsimor në pajtim me rregullat për marrëdhënie pune, ndërsa për kuadrin arsimor mbahet evidencë për mësimin e mbajtur.

(6) Në të njëjtën njësi të universitetit nuk mund të jenë të zgjedhur me tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, tituj mësimorë dhe tituj bashkëpunëtorë që janë në lidhje gjaku në vijë të drejtë në cilën do shkallë.

(7) Në të njëjtën shkollë profesionale të lartë të pavarur nuk mund të zgjidhen persona me tituj mësimorë që janë në lidhje në vijë të drejtë në cilën do shkallë.

(8) Dispozitat nga paragrafët (6) dhe (7) nuk kanë të bëjnë me persona të zgjedhur me tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, tituj mësimorë dhe tituj bashkëpunëtorë para hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

**Titujt mësimorë-shkencorë, mësimorë- profesionalë dhe më tituj mësimorë**

Neni 161

(1) Veprimtari të arsimit të lartë mund të kryejë peroni i zgjedhur me tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, tituj mësimorë dhe tituj bashkëpunëtorë për kohën për të cilën është zgjedhur

(2) Personi i zgjedhur me titull mësimor-shkencor, mësimor-profesional, titull mësimor dhe titull bashkëpunëtor mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë në fakultet ose shkollë të lartë profesionale.

(3) Personi i zgjedhur në titull mësitor mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë vetëm në shkollë të lartë profesionale.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni personi i zgjedhur në titullin shkencor në pajtim me dispozitat e Ligjit për veprimtari shkencore-hulumtuese, mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë në studime nga cikli i dytë dhe i tretë në pajtim me këtë ligj sipas ekuivalencës së titujve të përcaktuar në këtë Ligj.

(5) Në fakultet tituj mësitorë-shkencorë janë docent, profesor ordinar dhe profesor inordinar.

(6) Në fakultetet në sferën e shkencave filologjike dhe në institucionet tjera të arsimit të lartë në të cilat realizohet mësimi i gjuhës, tituj shkencorë mësitorë janë lektor dhe lektor i lartë.

(7) Në shkollat e arsimit të lartë titujt mësitorë janë ligjërues, ligjërues i lartë dhe profesor në shkollë të lartë profesionale.

(8) Në institucionet e arsimit të lartë mund të kryhet zgjedhje edhe në tituj shkencorë në pajtim me Ligjin për veprimtari profesionale-hulumtuese.

(9) Personi i zgjedhur në titull mësitor-shkencor dhe mësitor gjatë një semestri të vitit akademik mund të mbajë ligjërata më së shumti për katër lëndë mësimore në ciklin e parë të studimeve, në një ose më shumë universitete.

(10) Personi i zgjedhur në titull mësitor-shkencor, mësitor dhe shkencor gjatë një semestri të vitit akademik mund të mbajë ligjërata më së shumti për katër lëndë në ciklin e dytë të studimeve, në një ose më shumë universitete.

(11) Në qarkullimin ndërkombëtar, për titujt mësitorë-shkencorë në fakultet shfrytëzohen emrat në vijim në gjuhën angleze:

1. Për docent- Assistant professor, me shkurtesë - Ass.Prof.Dr.sc,
2. Për profesor inordinar- Associate professor, me - Assoc.Prof.Dr.sc dhe
3. Për profesor ordinar- Professor, me shkurtesë - Prof.Dr.sc

(12) Me përjashtim nga paragrafi (10) i këtij neni, në qarkullimin ndërkombëtar, për titujt mësitorë-shkencorë në lëndët profesionale-artistike në fakultet shfrytëzohen emrat në vijim në gjuhën angleze:

1. për docent -Assistant professor, me shkurtesë - Asst.Prof.Dr.art, përkatësisht Asst. Prof.mr.art,
2. për profesor inordinar- Associate professor, me shkurtesë - Assoc.Prof.Dr.art, përkatësisht Assoc. Prof.mr.art, dhe
3. për profesor ordinar -Professor, me shkurtesë - Prof.Dr.art, përkatësisht Prof.Mr.art

### **Asistentët, bashkëpunëtorët artistikë dhe profesionalë**

#### Neni 162

(1) Në fakultet titulli bashkëpunëtor është asistent.

(2) Në fakultetin nga sfera e akademisë së artit ose akademisë artistike mund të zgjidhet bashkëpunëtor artistik (korepetitor, kameraman, montazhist, producent dhe të ngjashme)

(3) Në fakultetet ku realizohet mësim në laborator dhe lloj tjetër i mësimit mund të zgjidhet bashkëpunëtor profesional (laborant dhe të ngjashme).

(3) Bashkëpunëtorët nga paragrafi (1) i këtij neni zgjidhen për sferën mësimore-shkencore, përkatësisht sferën artistike të përcaktuar me Klasifikimin e rajoneve, fushave dhe sferave shkencore-hulumtuese (klasifikimi ndërkombëtar fraskativ).

(4) Bashkëpunëtorët nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni marrin pjesë në procesin mësitor-arsimor në mënyrë dhe në vëllim të përcaktuar me statutin e universitetit dhe statutin e njësisë, përkatësisht me statutin e shkollës së lartë profesionale të pavarur.

## **Demonstratori**

### Neni 163

(1) Në fakultet, përkatësisht në shkollën e lartë profesionale, mund të zgjidhen demonstrues si ndihmës në procesin mësimor-arsimor të ciklit të parë të studimeve.

(2) Demonstrator mundet të jetë personi që është student në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve.

(3) Demonstrator mund të zgjidhet studenti i cili studimet nga cikli i parë (studimet universitare) i ka mbaruar me notë mesatare së paku 8.00 (tetë).

(4) Demonstrator i programit studimor nga cikli i integruar i parë dhe i dytë mund të zgjidhet studenti që ka realizuar së paku 180 SEKT kredi dhe notë mesatare së paku 8.00 (tetë).

(4) Demonstrator zgjidhet për periudhë prej një viti akademik, me të drejtë të jetë ri-emëruar edhe dy herë në të njëjtën njësi të universitetit.

(5) Kushtet e posaçme dhe procedura për zgjidhje të demonstratorit, si dhe të drejtat e tyre dhe të detyrime në procesin mësimor-arsimor rregullohen me akt të përgjithshëm të universitetit dhe akt të përgjithshëm të njësisë të universitetit, përkatësisht me akt të përgjithshëm të shkollës së lartë profesionale të pavarur.

(6) Demonstratorët janë pjesëmarrës në procesin mësimor-arsimor në vëllim dhe në mënyrë përcaktuar me programin studimor.

(7) Fakulteti, përkatësisht shkolla e lartë profesionale dhe demonstratori lidhin marrëveshje me të cilën i rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella. Pagesa e kompensimit për demonstrator të zgjedhur kryhet nga të hyrat personale të fakultetit, përkatësisht shkolla profesionale e lart e pavarur, për çka nuk kërkohet pëlqim nga Ministria e Financave.

### Seksioni 2

## **Kriteret dhe kushtet për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, tituj mësimorë dhe bashkëpunëtorë**

### **Kriteret për zgjedhje në tituj**

#### Neni 164

(1) Kriteret për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, mësimorë dhe bashkëpunëtorë janë:

1. arsimi i fituar,
2. rezultate nga punët e hulumtimit-shkencor dhe
3. rezultatet dhe përvoja në veprimtarinë mësimore dhe përgatitje të kuadrove të reja mësimore dhe shkencore-hulumtuese,
4. veprimtari profesionale-aplikuese ose artistike-profesionale.

(2) Në bazë të kriterëve nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohen kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, mësimorë dhe bashkëpunëtorë.

### **Llojet e kushteve për zgjedhje në tituj**

#### Neni 165

(1) Zgjedhja në tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, mësimorë dhe bashkëpunëtorë kryhet sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta.

(2) Kushtet e përgjithshme për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, mësimorë dhe bashkëpunëtor përcaktohen me këtë ligj.

(3) Kushtet e veçanta për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, tituj mësimorë dhe tituj bashkëpunëtorë përcaktohet me akt e përgjithshëm të universitetit, përkatësisht me akt të përgjithshëm të shkollës së lartë profesionale.

### **Kushtet e përgjithshme në tituj mësimorë-shkencorë**

#### **Neni 166**

(1) Në titullin mësimor –shkencor docent, mund të jetë personi i zgjedhur që:

1. ka realizuar sukses mesatar së paku 8.00 (tetë) në studime të ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël në veçanti, përkatësisht ka realizuar sukses mesatar së paku 8.00 (tetë) në studime të integruara të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë,

2. ka shkallë shkencore doktor shkence nga sfera shkencore për të cilën është zgjedhur,

3. ka publikuar së paku katër punë shkencore në publikimin referent profesional në pajtim me këtë Ligj në pesë vitet e fundit para publikimit të shpalljes për zgjedhje,

4. ka njohuri të paktën për një gjuhë të huaj, të përcaktuar me akt të përgjithshëm të universitetit, përkatësisht të shkollës së pavarur profesionale të lartë dhe

5. ka aftësinë për kryerje të veprimtarisë së lartë arsimore

(2) Në titullin mësimor –shkencor profesor inordinar, mund të zgjidhet personi që:

1. ka realizuar sukses mesatar së paku 8.00 (tetë) të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël veçmas, përkatësisht ka arritur sukses mesatar së paku 8.00 (tetë) në studimet e integruara të ciklit të parë dhe ciklit të dytë,

2. ka shkallë shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore për të cilën zgjedhet.

3. ka botuar të paktën pesë punë shkencore të recenzuara në publikimin shkencor referues në përputhje me këtë ligj në pesë vitet e fundit para publikimit të shpalljes për zgjedhje,

4. është zgjedhur paraprakisht në titull mësimor-shkencor docent dhe

5. ka aftësinë për të kryer veprimtari të arsimit të lartë

(3) Në titullin mësimor – shkencor profesor inordinar, mund të jetë personi që:

1. ka realizuar sukses mesatar së paku 8.00 (tetë) të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël veçmas, përkatësisht, ka arritur sukses mesatar së paku 8.00 (tetë) në studimet e integruara të ciklit të parë dhe ciklit të dytë,

2. ka shkallë shkencore doktor i shkencave nga sfera përkatëse,

3. ka botuar të paktën gjashtë punë shkencore të recenzuara në publikimin shkencor referues në përputhje me këtë ligj në pesë vitet e fundit para publikimit të shpalljes për zgjedhje,

4. të jetë i zgjedhur më parë me titull profesor inordinar,

5. ka publikuar libër shkollor të recenzuar ose monografi ose praktikum ose koleksion të detyrave nga fusha shkencore për të cilën është zgjedhur dhe

6. ka aftësinë për të kryer veprimtari të arsimit të lartë

(4) Gjuha e huaj, përkatësisht gjuhët, njohja e të cilave kërkohet për përmbushjen e kushteve nga paragrafi (1) alineja 4 të këtij neni, niveli i njohurive dhe mënyra e kontrollimit të njohurive të gjuhës së huaj, përkatësisht gjuhëve, rregullohen më ngushtësisht me akt të përgjithshëm të universitetit, përkatësisht me aktin e përgjithshëm të shkollës së lartë profesionale të pavarur.

(5) Për personat që kanë themeluar marrëdhënie pune si docent, profesor inordinar, asistent, asistent doktorant, ose asistent i ri në një nga universitetet në Republikën e Maqedonisë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk do të zbatohen dispozitat e paragrafit (2) alinesë 1 dhe paragrafit (3) alinesë 1, gjatë zgjedhjes së tyre në titullin e njëjtë ose më të lartë mësimor-shkencor, pavarësisht nga cili institucion i arsimit të lartë kryen zgjedhjet e reja.

### **Kushtet e përgjithshme për zgjedhje të titullit mësimor –shkencor në lëndët profesionale-artistike**

Neni 167

Për docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar në lëndët profesionale-artistike mund të zgjidhet edhe personi pa shkallë shkencore doktor shkence, që ka të kryer arsimin e lartë përkatës nga cikli i dytë, vepra të pranuar artistike dhe profesionale, përkatësisht realizime që kanë rëndësi themelore për afirmim të kulturës dhe artit në dhe jashtë shtetit, si dhe aftësi për punë mësimore.

### **Kushtet e përgjithshme për tituj mësimorë -profesionalë**

Neni 168

(1) Lektor mund të zgjidhet personi i cili:

1. ka kryer studime të ciklit të dytë të studimeve akademike,
2. ka fituar titullin magjistër nga sfera përkatëse,
3. ka realizuar sukses mesatar së paku 8.00 (tetë) të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël të veçantë,
4. ka përvojë mësimore dhe praktike në fushën në të cilën zgjidhet.

(2) Lektor i lartë mund të zgjidhet personi i cili:

1. ka kryer studime të ciklit të dytë të studimeve akademike,
2. ka fituar titullin magjistër nga sfera përkatëse,
3. ka realizuar sukses mesatar së paku 8.00 (tetë) të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël në veçanti,
3. ka përvojë mësimore dhe shkencore në sferën që zgjidhet,
4. është zgjedhur më parë lektor në institucionin e arsimit të lartë dhe
5. ka publikuar punime shkencore dhe profesionale në sferën në të cilën zgjidhet.

(3) Për personat që janë zgjedhur në titull mësimor-profesional me marrëdhënie të punës të themeluar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk do të zbatohen dispozitat nga paragrafi (1) alineja 3 dhe paragrafi (2) alineja 3, gjatë zgjedhjes së tyre në titull të njëjtë ose më të lartë mësimor-profesional pa marrë parasysh se në cilin institucion të arsimit të lartë kryhet zgjedhja e re.

### **Kushtet e përgjithshme për zgjedhje në tituj mësimor në shkollën e lartë profesionale**

Neni 169

(1) Ligjërues në shkollë të lartë profesionale mund të zgjidhet personi i cili:

1. ka kryer ciklin e dytë të studimeve akademike,
2. ka fituar titullin magjistër nga sfera përkatëse,
3. tregon aftësi për punë mësimore dhe punë profesionale të lartë,
4. ka publikuar punime profesionale
5. ka realizuar sukses mesatar së paku 8.00 (tetë) të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël të veçantë dhe,
6. ka përvojë të suksesshme shumë vjeçare në punët nga profesioni i vet.

(2) Ligjërues i lartë në shkollë të lartë profesionale mund të zgjidhet personi i cili ka:

1. kryer ciklin e dytë të studimeve akademike,
2. ka fituar titullin magjistër nga sfera përkatëse,
3. ka publikuar numër më të madh të punimeve shkencore, përkatësisht profesionale,

4. ka arritur sukses mesatar së paku 8.00 (tetë) të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël të veçantë,

5. ka treguar aftësi për punë mësimore dhe punë të larta profesionale sipas zgjedhjes ligjërues në shkollën e lartë profesionale.

(3) Profesor i shkollës së lartë profesionale mund të zgjidhet personi që ka:

1. shkallën shkencore doktor i shkencave,

2. publikuar punime shkencore dhe profesionale pas zgjedhjes ligjërues i lartë në shkollë të lartë profesionale,

3. ka realizuar sukses mesatar së paku 8.00 (tetë) të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël të veçantë,

4. ka treguar aftësi për punë mësimore dhe të larta profesionale pas zgjedhjes ligjërues në shkollën e lartë profesionale.

(4) Për personat që janë të zgjedhur me titull mësimor me marrëdhënie të punës të themeluar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk do të zbatohen dispozitat nga paragrafi (1) alineja 5, paragrafi (2) alineja 4 dhe paragrafi (3) alineja 3, gjatë zgjedhjeve të tyre në titull të njëjtë ose më të lartë mësimor pa marrë parasysh se në cilin institucion të arsimit të lartë kryhet zgjedhja e re.

### **Kushtet e përgjithshme për zgjedhje në tituj bashkëpunëtorë**

#### **Neni 170**

(1) Asistent mund të zgjidhet personi që:

1. ka kryer ciklin e parë dhe të dytë të studimeve akademike me së paku 300 SETK kredi,

2. ka fituar titullin magjistër nga sfera përkatëse,

3. ka realizuar me sukses mesatar së paku 8.00 (tetë) të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël në veçanti,

4. ka njohuri së paku për një gjuhë të huaj.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni „në institucionet e arsimit të lartë që kanë program studimor të integruar të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, asistent mund të jetë personi i zgjedhur që:

1. ka kryer ciklin e parë dhe të dytë të integruar të studimeve akademike së paku 300 SETK kredi me sukses mesatar të realizuar së paku me 8,00 (tetë) ose

2. ka mbaruar studime universitare dhe të magjistraturës me programe studimore para vendosjes së sistemit evropian kredit-transfer dhe ka realizuar sukses mesatar së paku 8,00 (tetë) në studime akademike universitare dhe të magjistraturës në veçanti,

3. ka njohuri për së paku një gjuhë të huaj.

(3) Bashkëpunëtor artistik dhe profesional mund të jetë personi i zgjedhur që :

1. ka të kryer ciklin e parë dhe të dytë të studimeve akademike së paku 240 SETK kredi nga sfera përkatëse,

2. ka përvojë në profesion së paku tre vjet,

3. ka njohuri së paku për një gjuhë të huaj.

(4) Niveli i njohurive dhe mënyra e përcaktimit të plotësimit të kushteve për njohje të së paku një gjuhe të huaj nga paragrafi (1) alineja 4 dhe paragrafi (2) alineja 3 të këtij neni më afër rregullohet me akt të përgjithshëm të universitetit, përkatësisht me akt të përgjithshëm të shkollës profesionale të lartë të pavarur.



Seksioni 3

PROCEDURA PËR ZGJEDHJE NË TITULL

**Të drejtat për procedurë për zgjedhje në titull**

Neni 171

Zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, mësimorë dhe bashkëpunëtorë kryhet sipas procedurës të përcaktuar me këtë ligj me akt të përgjithshëm të universitetit, përkatësisht me akt të përgjithshëm të shkollës së lartë profesionale të pavarur.

**Konkursi për zgjedhje në titull dhe themelimi i marrëdhënies së punës**

Neni 172

(1) Zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, mësimorë dhe shkencorë kryhet me konkurs publik që e shpall këshilli mësimor-shkencor, përkatësisht mësimdhënës, që e publikon institucioni i arsimit lartë në shtypin ditor.

(2) Konkursi për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, përkatësisht arsimorë shpallet për marrëdhënie pune shpallet për zgjedhje në të gjithë titujt mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, përkatësisht mësimorë.

(3) Konkursi për zgjedhje në tituj bashkëpunëtorë dhe themelimin e marrëdhënies së punës shpallet për zgjedhje në titull të përcaktuar bashkëpunëtor.

(4) Konkursi për zgjedhje në titull dhe themelimin e marrëdhënies së punës duhet ta përmbajë sferën mësimorë-shkencore përkatëse, për të cilën zgjidhet personi, e përcaktuar me Kualifikimin e rajoneve, fushave dhe sferave mësimorë-hulumtuese (Klasifikimi Fraskatativ Ndërkombëtar), llojin e marrëdhënies së punës, afatin e kohëzgjatjes dhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për zgjedhje, dokumentacionin i cili është me rëndësi për zgjedhje dhe kushtet tjera të përcaktuara me ligj ose me akt të përgjithshëm të universitetit dhe njësisë së universitetit, përkatësisht akt të përgjithshëm të shkollës profesionale të lartë të pavarur.

(5) Fitimi i titullit mësimor-shkencor, mësimor-profesional, përkatësisht titullit mësimor të arsimtarëve të zgjedhur është procedural.

(6) Procedura me konkurs mund të zgjasë më së shumti gjashtë muaj konsideruar nga dita e shpalljes së konkursit publik në shtypin ditor. Nëse procedura nuk kryhet në këtë afat, procedura ndërpritet dhe shpallet konkurs i ri.

(7) Afati nga paragrafi (6) i këtij neni nuk rrjedh në periudhën nga 15 korrik deri më 25 gusht në vitin kalendarik.

**Procedura për zgjedhje**

Neni 173

(1) Zgjedhjen e kandidatëve në tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-profesionalë, arsimorë, shkencorë dhe bashkëpunëtorë e kryen këshilli mësimor-shkencor i fakultetit, përkatësisht këshilli mësimor i shkollës së arsimit të lartë në bazë të notës së referatit të komisionit recensues.

(2) Zgjedhjen e profesorit ordinar të realizuar nga këshilli arsimor-shkencor i fakultetit, e përcakton senati i universitetit.

(3) Komisioni Recensues nga paragrafi (1) i këtij neni, përbëhet së paku nga tre anëtarë dhe e formon këshilli mësimor-shkencor i fakultetit, përkatësisht këshilli i arsimtarëve i shkollës profesionale të lartë të pavarur, pas mbarimit të afatit për paraqitje të kandidatëve.

(4) Anëtarët e komisionit recensues mund të jenë nga institucioni i lartë arsimor në të cilin kryhet zgjedhja ose nga institucionet tjera të arsimit të lartë ose institucionet shkencore, që kryejnë veprimtari të arsimit të lartë në pajtim me këtë ligj.

(5) Anëtari i komisionit recensues, me kushtet e njëjta të përcaktuara me këtë ligj për anëtarë të komisionit recensues, mund të jetë edhe arsimtar nga institucioni i arsimit të lartë akreditues nga jashtë me të cilin universiteti ose njësia e tij, përkatësisht shkolla profesionale e lartë e pavarur ka lidhur marrëveshje për bashkëpunim ndërkombëtar.

(6) Më shumë se gjysmën e anëtarëve të komisionit recensues e përbëjnë persona të zgjedhur në tituj mësues-shkencorë, mësues-profesionalë, shkencorë dhe mësues nga sfera e njëjtë mësues-shkencorë, përkatësisht sfera artistike në të cilën zgjidhet kandidati, ndërsa anëtarët e tjerë mund të jenë nga sfera e ngjashme mësues-shkencorë, përkatësisht sfera artistike.

(7) Anëtarët e komisionit recensues nuk mund të jenë me tituj më të ulët nga titulli në të cilin zgjidhet kandidati.

(8) Për të gjithë kandidatët e paraqitur komisioni recensues parashtron referat në me shkrim në afat prej tre muajsh nga dita e dorëzimit të dokumentacionit të plotë të të gjithë anëtarët e komisionit recensues. Referati përmban notë për realizimet e kandidatëve në pajtim me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për zgjedhje në titull përkatës, si dhe propozim për zgjedhje të kandidatit në titull përkatës.

(9) Institucioni i Arsimit të lartë e shpall referatin e komisionit recensues nga paragrafi (8) i këtij neni në buletin përkatës të universitetit dhe në ueb faqen e universitetit, përkatësisht shkollës profesionale të lartë të pavarur së paku 15 ditë para ditës së zgjedhjes.

(10) Komisioni recensues në referat i vlerëson realizimet e përgjithshme shkencore, profesionale, pedagogjike dhe realizime të tjera të kandidatëve nga fillimi i karrierës deri në ditën e paraqitjes, në bazë të tërë dokumentacionit të parashtruar që është me rëndësi për zgjedhjen.

(11) Nëse këshilli mësues-shkencor, përkatësisht këshilli mësuesdhënës nuk zgjedh kandidatin e propozuar, konkursi përsëritet.

(12) Zgjedhja në titull është bazë për themelimin e marrëdhënies së punës për kohë të caktuar, përkatësisht për kohë të pacaktuar.

(13) Procedura e zgjedhjes në tituj mësues-profesionalë, mësues-profesionalë, mësues dhe bashkëpunëtorë të universitetit më afër rregullohet me akt të përgjithshëm të universitetit, përkatësisht të shkollës profesionale të lartë të pavarur.

### **Themelimi i marrëdhënies së punës**

#### **Neni 174**

(1) Procedura për zgjedhje të titull mësues-shkencor, mësues-profesional, mësues dhe titull bashkëpunëtor mbaron me themelimin e marrëdhënies së punës me kohë të plotë të punës ndërmjet personave të zgjedhur dhe institucioneve të arsimit të lartë. Marrëdhënie pune themelohet për kohën në të cilën është zgjedhur personi.

(2) Personat e zgjedhur me tituj mësues-shkencor, mësues-profesional, mësues dhe tituj bashkëpunëtor me marrëdhënie pune të themeluar realizojnë të drejtat dhe detyrimet e realizuara nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj dhe tjetër ligj dhe me marrëveshje kolektive.

(3) Personat e zgjedhur më titull mësues-shkencor, mësues-profesional, mësues dhe bashkëpunëtor që janë në marrëdhënie pune në institucionin publik të arsimit të lartë, kryejnë dhe veprimtari shëndetësore në institucionin shëndetësor publik.

(4) Personat që janë në marrëdhënie pune në institucionin shëndetësor publik, ndërsa janë zgjedhur në titullin mësimitor-shkencor, shkencor dhe mësimitor përkatësisht me titull bashkëpunëtor në institucionin publik të arsimit të lartë, kryejnë edhe veprimtari të arsimit të lartë në institucion publik të arsimit të lartë.

(5) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, personat nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni veprimtarinë e arsimit të lartë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese dhe veprimtarinë shëndetësore e kryejnë tërësi e pandashme funksionale me ndarje të orarit të punës në të dy institucionet.

(6) Kushtet dhe mënyra sipas të cilave personat nga paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij neni kryejnë veprimtari shëndetësore përkatësisht veprimtari të arsimit të lartë dhe veprimtari shkencore hulumtuese, rregullohen me marrëveshje ndërmjet institucionit publik të arsimit të lartë dhe institucionit shëndetësor publik, në pajtim me ligjin.

(7) Një person nuk mund të zgjidhet njëkohësisht në titull mësimitor-shkencor, mësimitor-profesional, mësimitor dhe bashkëpunëtor në më shumë se një institucion të arsimit të lartë.

(8) Gjatë pezullimit të marrëdhënies së punës, personi i zgjedhur në titull mësimitor-shkencor, mësimitor-profesional, mësimitor ose bashkëpunëtor, ka të drejtë të kryejë veprimtari të arsimit të lartë të ciklit të parë të studimeve pa kompensim financiar.

(9) Personi i zgjedhur me titull mësimitor-shkencor, mësimitor-profesional ose mësimitor, të cilit i pezullohet marrëdhënia e punës, ka të drejtë të mbajë ligjërata dhe të jetë mentor i ciklit të dytë dhe të tret të studimeve, si dhe të kryejnë aktivitete të tjera nga veprimtaria e arsimit të lartë.

### **Afatet për të cilat kryhen zgjedhjet**

#### **Neni 175**

(1) Docenti dhe profesori inordinar i fakultetit, përkatësisht akademisë artistike zgjidhen në kohë prej pesë vjetësh.

(2) Profesori ordinar i fakultetit, përkatësisht akademisë artistike me zgjedhje themelon marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar dhe e mban titullin profesor ordinar për gjithë jetën.

(3) Ligjërues dhe ligjërues i lartë i shkollës së lartë profesionale zgjidhen për kohë prej pesë vjetësh.

(4) Profesori i shkollës së lartë profesionale me zgjedhjen themelon marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar dhe e mban titullin profesor për gjithë jetën.

(5) Lektor i lartë dhe lektor i lartë zgjidhen për kohë prej katër vjetësh.

(6) Asistenti zgjidhet për kohë prej tre vjetësh, me të drejtë edhe për një zgjedhje në të njëjtin titull në institucionin e njëjtë të arsimit të lartë.

(7) Bashkëpunëtori artistik dhe profesional zgjidhen për kohë prej tre vjetësh, me të drejtë për ri-zgjedhje me numër të pakufizuar.

### **Afati për zgjedhje në titull më të lartë, përkatësisht për rrizgjedhje në titull**

#### **Neni 176**

(1) Më herët shtatë muaj, ndërsa më së voni gjashtë muaj para skadimit të kohës për të cilën është kryer zgjedhje në titull mësimitor-shkencor, mësimitor-profesional, mësimitor dhe bashkëpunëtor, dekani i fakultetit, përkatësisht drejtori i shkollës profesionale të lartë shpall konkurs për zgjedhje në të gjithë titujt mësimitorë-shkencorë, mësimitorë-profesionalë, mësimitorë dhe shkencorë, për zgjedhje në titull bashkëpunëtor asistent, përkatësisht për zgjedhje të bashkëpunëtorit artistik ose profesional.

(2) Gjatë zgjedhjes nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohen dispozitat e këtij ligji për zgjedhje në tituj mësimitorë-shkencorë, mësimitorë-profesionalë, mësimitorë dhe bashkëpunëtorë nga neni 172 i këtij ligji.

(3) Koha për shpallje të konkursit nga paragrafi (1) i këtij neni vazhdohet për kohën që është kaluar në pushim të lindjes, pushim mjekësor më të gjatë se tre muaj, si dhe pezullim të marrëdhënies së punës në rastet e përcaktuara me ligj. Me kërkesë të personit, afati nuk është e domosdoshme të vazhdohet.

### **Persona që nuk janë të zgjedhur**

#### Neni 177

(1) Nëse gjatë zgjedhjes, personi i cili më parë është zgjedhur në titull mësimitor-shkencor, mësimitor-profesional, shkencor dhe mësimitor është propozuar për zgjedhje në titull më të lartë dhe nuk zgjidhet në titullin më të lartë të propozuar, përsëri votohet për zgjedhje në titullin ekzistues në të cilin është zgjedhur më parë.

(2) Personit nga paragrafi (1) i këtij neni që nuk është zgjedhur as në titullin ekzistues, i ndërpritet marrëdhënia e punës.

(3) Personi nga paragrafi (2) i këtij neni ka të drejtë kundërshtimi te organi që ka vendosë për zgjedhje. Nëse kundërshtimi refuzohet, personi ka të drejtë ankese te senati i universitetit, që formon komision prej tre anëtarësh, i përbërë nga profesorë ordinarë të sferës së njëjtë ose të ngjashme shkencore nga e cila është parashtruesi i ankesës, nga të cilat së paku dy anëtarë janë nga institucion tjetër i arsimit të lartë. Komisioni parashtron raport në të cilin jep notë për zgjedhjen. Vendimi i senatit universitar është përfundimtar.

### **Ndërprerja e parakohshme e zgjedhjes**

#### Neni 178

(1) Personi i zgjedhur në titull mësimitor-shkencor, mësimitor-profesional, mësimitor dhe bashkëpunëtor është i detyruar të përsoset vazhdimisht dhe të dëshmohet në mënyrë profesionale, shkencore, përkatësisht artistike, me sukses ta realizojnë veprimtarinë e arsimit të lartë, të kontribuojë për krijimin e gjeneratave të reja mësimore-shkencore, përkatësisht artistike, të kujdeset për realizim të suksesshëm të programeve studimore dhe të kontribuojë për zhvillimin, përkatësisht zbatimin e veprimtarisë shkencore, përkatësisht artistike për të cilën është zgjedhur.

(2) Personit të zgjedhur me titull mësimitor-shkencor, mësimitor-profesional, mësimitor dhe bashkëpunëtor mund t'i ndërpritet marrëdhënia e punës edhe para skadimit të kohës për të cilin është zgjedhur, me kushte dhe procedurë të rregulluara me ligj dhe statutin e institucionit të arsimit të lartë, nëse përcaktohet se kohë më të gjatë nuk i plotëson detyrimet nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse i pengon veprimtaritë statutores dhe ligjore të institucionit të arsimit të lartë ose pengon anëtarët e tjerë në realizimin e të drejtave të tyre dhe kryerjen e detyrave të tyre në institucionin e arsimit të lartë, nëse kanë pushuar së ekzistuari kushtet themelore në bazë të të cilave është kryer zgjedhja dhe shkeljet tjera disiplinore.

(3) Vendimin për ndërprerjen e zgjedhjes dhe marrëdhënies së punës para përfundimit të kohës për të cilën është zgjedhur personi në titull mësimitor-shkencor, mësimitor-profesional, mësimitor dhe bashkëpunëtor, miraton këshilli mësimitor-shkencor me shumicën e dy të tretave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, në bazë të referatit të komisionit të përbërë nga tre profesorë ordinarë.

(4) Personi nga paragrafi (3) i këtij neni ka të drejtë të kundërshtimit te organi që ka vendosur për ndërprerjen e zgjedhjes.

(5) Nëse kundërshtimi refuzohet, personi ka të drejtë ankese te senati i universitetit, që formon komision nga tre anëtarë, i përbërë nga profesorë ordinarë nga sfera e njëjtë ose e ngjashme shkencore nga e cila është parashtruesi i ankesës, nga të cilat së paku dy anëtarë janë nga institucion tjetër i arsimit të lartë. Komisioni parashtron referat në të cilin jep notë për bazat ekzistuese për ndërprerjen e zgjedhjes dhe marrëdhënies së punës.

(6) Senati vendimin mbi ankesën e miraton me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

(7) Vendimi i senatit universitar është përfundimtar.

(8) Kundër vendimit të senatit mund të ngrihet procedurë gjyqësore.

(9) Dispozitat e këtij neni në mënyrë përkatëse kanë të bëjnë edhe me shkollat profesionale të larta të pavarura.

### **E drejta e kryerjes së veprimtarisë në institucion tjetër të arsimit të lartë**

#### **Neni 179**

(1) Personi nga një njësi universitare mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë në njësi tjetër universitare, në titullin në të cilin është zgjedhur në sferën e njëjtë ose të ngjashme mësimore-shkencore përkatësisht artistike.

(2) Personi nga një universitet mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë në njësi të universitetit tjetër, përkatësisht shkollë profesionale të lartë të pavarur me titullin në të cilin është zgjedhur në sferën e njëjtë ose të ngjashme mësimore-shkencore, përkatësisht artistike, në bazë të pëlqimit të senatit të universitetit në të cilin është zgjedhur të dhënë pas mendimit paraprak të këshillit mësimor-shkencor të njësisë së universitetit.

(3) Personi nga një shkollë e lartë profesionale e pavarur mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë në shkollë tjetër të lartë profesionale, në titullin në të cilin është zgjedhur në sferën e njëjtë ose të ngjashme mësimore-shkencore, përkatësisht artistike, në bazë të pëlqimit të shkollës së lartë profesionale të pavarur në të cilën është zgjedhur.

(4) Kushtet, mënyra dhe procedura sipas të cilës personi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë përcaktohen me statutin e universitetit, përkatësisht institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

### **Mësimdhënës vizitorë**

#### **Neni 180**

(1) Me ftesë të këshillit mësimor-shkencor të fakultetit, përkatësisht këshillit mësimor të shkollës së lartë profesionale, mësimdhënës nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë, shkencëtarë të njohur dhe artistë të shquar nga vendi dhe jashtë vendit, si vizitorë pa shpallje të konkursit, mund të kryejnë veprimtari të arsimit të lartë dhe veprimtari kërkimore-shkencore, përkatësisht artistike për kohë të caktuar.

(2) Mënyra, koha dhe kushtet në të cilat kryhet veprimtaria nga paragrafi (1) i këtij neni rregullohen me statutin e universitetit, përkatësisht shkollës së lartë profesionale të pavarur.

### **Shkencëtarët, artistët dhe ekspertët e afirmuar nga praktika**

#### **Neni 181**

Shkencëtarët, artistët dhe ekspertët e afirmuar nga praktika, pa marrë parasysh përmbushjen e kushteve të përcaktuara me këtë ligj për zgjedhje në titull si specialistë dhe ekspertë, me ftesë, mund të realizojnë mësim për pjesë të caktuara të lëndës mësimore, në masën dhe nën kushtet e përcaktuara me statutin e institucionit të arsimit të lartë.

### **Titujt akademikë**

#### **Neni 182**

(1) Shkencëtarë, artistë dhe profesionistë të afirmuar nga praktika, të cilët i përmbushin kushtet për zgjedhje në tituj, ndërsa për të cilët nuk ka vend të lirë për zgjedhje në titullin mësimor-shkencor mund të zgjidhen në universitet në titullin docent akademik ose profesor inordinar akademik, sipas kushteve dhe procedurës së përcaktuar në këtë ligj.

(2) Personat e zgjedhur në titujt akademikë mund të marrin pjesë në kryerjen e veprimtarisë së lartë arsimore më së shumti deri në 30% nga obligimet e rregullta në titullin adekuat mësimor-shkencor. Lloji dhe vëllimi i pjesëmarrjes së personit të zgjedhur në titullin akademik në kryerjen e veprimtarisë së lartë arsimore e përcakton këshilli mësimor-shkencor, në pajtim me aktin e përgjithshëm të universitetit.

(3) Personat e zgjedhur në titujt akademikë nuk mund të jenë mentorë të punëve të magjistraturës ose doktoraturës.

(4) Personi i zgjedhur në titullin docent akademik ose profesor inordinar akademik mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë vetëm në universitet në të cilin e ka fituar atë titull.

(5) Një person nuk mundet njëkohësisht të zgjidhet në titullin akademik në më shumë se një universitet.

(6) Nëse personi i cili është zgjedhur në titullin akademik docent ose akademik profesor inordinar në një institucion të lartë arsimor, të zgjidhet në titull akademik ose akademik mësimor-shkencor dhe themelon marrëdhënie pune në atë institucion të lartë arsimor ose në tjetër, zgjedhja e titullit akademik i ndërpritet.

(7) Personit i ndërpritet titulli akademik docent ose titulli profesor inordinar në fund në vitit shkollor në të cilin ka mbushur 67 vjet.

### **Ekivalenca e titujve**

#### **Neni 183**

(1) Për shkak të kryerjes së veprimtarisë së lartë arsimore, më kushte të përcaktuara në këtë ligj titujt shkencorë të fituar sipas dispozitave të ligjit me të cilin rregullohet veprimtaria shkencore- hulumtuese, përgjigjen në titujt arsimorë të përcaktuar me këtë ligj:

- këshilltar shkencor i profesorit ordinar,
- bashkëpunëtor i lartë shkencor i profesorit inordinar,
- bashkëpunëtor shkencor i docentit dhe
- bashkëpunëtor në veprimtari shkencore-hulumtuese të bashkëpunëtorit në institucion të lartë arsimor.

(2) Pozita ekuivalente nga paragrafi (1) i këtij neni mund të shfrytëzohen si tituj mësimorë-shkencorë dhe bashkëpunëtorë nëse institucioni shkencor ka marrë akreditim për kryerjen e studimeve pasuniversitare dhe të doktoraturës, në vëllim dhe me kushte të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktvendim për akreditim.

### **Profesor nderi dhe doktor shkence i nderit**

#### **Neni 184**

(1) Profesorit të shquar në universitetin e Republikës së Maqedonisë dhe nga jashtë, i cili ka dhënë kontribut të posaçëm për zhvillimin e veprimtarisë së lartë arsimore, me propozim të njësisë, universiteti mund t'i ndaj titullin profesor nderi (profesor honoris causa).

(2) Personave të shquar shkencorë, kulturorë, afaristë dhe të tjerë nga vendi dhe nga jashtë, të cilët me veprat e veta kanë dhënë kontribut të posaçëm në zhvillimin e mendimit shkencor, kulturor, ose në mënyrë tjetër kanë kontribuar në zhvillimin e arsimit të lartë, me propozim të institucionit të lartë arsimor, përkatësisht institucionit të akredituar shkencor, universiteti mund të ndajë titullin doktor shkence i nderit (doktor honoris causa).

(3) Dispozita më të përafërta për ndarjen e titullit profesor nderi dhe titullit doktor shkence i nderit dhe për të drejtat e tyre përcaktohen me statusin e universitetit.

### **Profesor emeritus**

#### Neni 185

(1) Universiteti mundet, me propozim të këshillit arsimor-shkencor të fakultetit në përbërje të tij t'i ndajë titull profesor emeritus profesorit të rregullt në pension, i cili posaçërisht është theksuar me punën e tij shkencore, përkatësisht artistike, i cili ka fituar reputacion ndërkombëtar dhe ka arritur rezultate në sigurimin e pasardhësve mësimorë-shkencorë dhe bashkëpunëtorë në sferën në të cilën është zgjedhur.

(2) Numri i përgjithshëm i profesorëve emeritus nuk mund të jetë më shumë se 5 % e numrit të përgjithshëm të mësimit të universitetit.

(3) Profesor emeritus mund të marrë pjesë në realizimin e mësimit në ciklin e dytë edhe të tretë të studimeve, në sferën në të cilën është zgjedhur.

(4) Dispozita më të përafërta për ndarjen e titullit profesor emeritus dhe për të drejtat e tij përcaktohen me statusin e universitetit.

### **Mungesa me pagesë dhe pa pagesë dhe viti sabat**

#### Neni 186

(1) Personit të zgjedhur në titull mësimor-shkencor, mësimor-profesional, shkencor, mësimor dhe bashkëpunëtor me kërkesë të tij, çdo pesë vjet, institucioni i arsimit të lartë mund t'i lejoj mungesë me pagesë në kohëzgjatje prej një viti, përkatësisht mungesë pa pagesë në kohëzgjatje deri tre vjet për shkak të përsosjes profesionale, përkatësisht hulumtim në sferën adekuate shkencore, përkatësisht sferën artistike ose për qëndrim në institucion adekuat, me ç'rast obligimet e tij në mësim shpërndahen.

(2) Nëse përsosja profesionale, hulumtimi, përkatësisht qëndrimi nga paragrafi (1) i këtij neni është në njërin nga njëqind universitetet e para të ranguar në listën e fundit të shpallur nga këto institucione: Instituti për arsim të lartë pranë Universitetit të Shangait Xhio Tong, US news and Report dhe Times Higher Education Supplement – World University Ranking, krahas mungesës me pagesë, ministria kompetente për punët e arsimit të lartë i kompenson shpenzimet për vendosje, ushqim, sigurim shëndetësor dhe shpenzime për rrugë, nëse të njëjtat nuk janë kompensuar nga institucioni në të cilin realizohet qëndrimi ose nga institucion tjetër.

(3) Kushtet për shfrytëzimin e të drejtës nga paragrafi (1) i këtij neni për së afërmi rregullohen me statusin e universitetit, përkatësisht me statusin e institucionit të pavarur të lartë arsimor.

(4) Kushtet e shfrytëzimit të së drejtës nga paragrafi (2) i këtij neni për së afërmi rregullohen me akt të miratuar nga ministri kompetent për punët në arsimin e lartë.

### **Ndërprerja e marrëdhënies së punës për shkak të plotësimit të kushteve për pension**

#### Neni 187

(1) Personit të zgjedhur në titull mësimor-shkencor ose mësimor, i cili gjatë vitit shkollor ka vazhduar kontratën për punësim në pajtim me dispozitat për marrëdhëniet e punës, marrëdhënia e punës i zgjat deri në fund të vitit shkollor kur mbush moshën 67 vjeçare.

(2) Profesor ordinar në pension mund të mbajë mësim në studime të ciklit të tretë dhe të jetë mentor për studime të doktoraturës, si dhe të punojë në projekt shkencor-hulumtues me kushtet e caktuara me statutin e universitetit, përkatësisht statutin e shkollës së pavarur të lartë profesionale.

## **Afati gjatë të cilit fitohen të drejtat dhe obligimet e personave të zgjedhur në tituj nga komisioni amë**

Neni 188

Personi i zgjedhur në titull mësimitor-shkencor, mësimitor-profesional, mësimitor dhe bashkëpunëtor, asistent i komisionit amë në procedurën për themelimin të institucionit për arsim të lartë i fiton të drejtat dhe obligimet që rezultojnë nga titulli në të cilin është përzgjedhur, të caktuara me këtë ligj, me ditën e regjistrimit të institucionit për arsim të lartë në regjistrin e institucioneve për arsim të lartë.

## **Kompensime për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe punime të publikuara dhe qasje në bazat për punime**

Neni 189

(1) Ministri kompetent për punët e arsimit të lartë miraton rregullore me të cilën rregullohen kushtet, lartësia e mjeteve dhe procedura në pajtim me të cilat nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë u kompensohen shpenzimet për rrugë, akomodim, kuotizacion dhe ushqim, përkatësisht mëditje të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve të zgjedhur në tituj në universitetet e Republikës së Maqedonisë për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe tubime artistike nëse kanë paraqitur punim shkencor të materies në fjalë, përkatësisht vepër artistike ose projekt nga fusha në të cilën janë zgjedhur.

(2) Ministri kompetent për punët e arsimit të lartë miraton akt me të cilin rregullohen kushtet, lartësia e mjeteve dhe procedura në pajtim me të cilat institucionet e arsimit të lartë fitojnë të drejtën për kompensim të mjeteve për organizim të konferencave shkencore dhe mbledhjeve artistike.

(3) Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e zgjedhur në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë kanë të drejtën për kompensim të mjeteve të paguara për publikim të punimeve në revista me indeks në bazat Web of Science ose Scopus. Ministri kompetent për punët e arsimit të lartë miraton akt me të cilin rregullohet procedura për kompensim të mjeteve.

(4) Ministri kompetent për punët e arsimit të lartë miraton akt me të cilin rregullohet procedura për ndarje të shpërblimit të njëfishtë në lartësi të një neto rroge mesatare të paguar muajin e fundit në Republikën e Maqedonisë për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e zgjedhur në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë të cilët do të publikojnë punim shkencor në revista me faktor ndikimi, të referuara në bazat e Thomson Reuters ose Scopus.

(5) Ministria kompetente për punët e arsimit të lartë siguron qasje të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve të zgjedhur në universitetet publike së paku në një bazë të punimeve, me propozim të Këshillit Nacional. Ministri kompetent për punët e arsimit të lartë i cakton kushtet dhe procedurën për sigurim të qasjes në bazën e punimeve. Mjetet për qasje në bazën e punimeve sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

### **Kapitulli i trembëdhjetë**

## **EKUIVALENCA DHE NJOHJA E KUALIFIKIMEVE TË ARSIMIT TË LARTË**

### **Seksioni 1**

#### **DISPOZITA THEMELORE**

### **Lloje të njohjeve të kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë**

Neni 190

(1) Ekuivalenca dhe njohja e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë kryhet në pajtim me këtë ligj dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare.

(2) Njohja e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë mund të jetë:



1. profesionale ose
2. akademike.

(3) Njohja profesionale është njohje me rëndësi të barabartë të kualifikimit të huaj të arsimit të lartë me kualifikim të përshtatshëm të arsimit të lartë vendas, me të cilin mundësohet punësim dhe qasje në arsimim të mëtejshëm në Republikën e Maqedonisë.

(4) Njohja akademike paraqet barazim të kualifikimit të huaj të arsimit të lartë me kualifikim përkatës vendas të arsimit të lartë për shkak të realizimit të të drejtës për arsimim të mëtejshëm në Republikën e Maqedonisë.

(5) Njohja profesionale dhe akademike e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë kryhet me aktvendim, me të cilin bartësi i diplomës së huaj i pranohet përkatësisht përcakton shkallën, llojin dhe titullin e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë dhe klasifikohet në sistemin e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë të përcaktuar me këtë Ligj dhe ligjet dhe rregulloret e tjera të cilat kanë të bëjnë me lëvizjen e lirë të personave, kualifikimeve profesionale dhe profesioneve të rregulluara në Republikën e Maqedonisë.

(6) Gjatë procedurës për njohjen e kualifikimit të arsimit të lartë të huaj, kryhet dhe ekuivalenca, me çka së bashku me aktvendimin për njohjen e kualifikimi të huaj të arsimit të lartë, jepet edhe aktvendim për ekuivalencën ose të dhënat për ekuivalencë janë përmbajtur në aktvendimin për njohjen e kualifikimit.

(6) Rregullat e këtij ligji për ekuivalencën dhe për njohjen e kualifikimi të huaj të arsimit të lartë, në mënyrë përkatëse zbatohen edhe në ekuivalencën dhe njohjen e një pjese të studimeve të kaluara në institucion të huaj të arsimit të lartë, për shkak të vazhdimit dhe përfundimit të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë.

### **Personat që mund të kërkojnë mirënjohje**

#### **Neni 191**

Të drejtë të pranimit të kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë kanë shtetasit e Republikës së Maqedonisë, shtetasit e huaj dhe personat pa nënshtetësi.

### **Qendra Informative për njohje të kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë**

#### **Neni 192**

(1) Në Ministrinë kompetente për punët e arsimit të lartë funksionon Qendra Informative për njohje të kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë (në tekstin e mëtejshëm: Qendra informative) e cila është kompetente për punë profesionale administrative në zbatimin e procedurës për njohje të kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë.

(2) Qendra Informative e përcakton llojin dhe nivelin e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë duke e krahasuar me kualifikimet e arsimit të lartë të cilat arrihen në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë kurse duke marrë parasysh Kornizën Nacionale të Kualifikimeve (NQF). Njohja e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë bëhet në pajtim me tre ciklet kualifikuese të parapara me Procesin e Bolonjës në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ENEA), përkatësisht shkallë të parapara me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (EQF).

(3) Qendra informative:

1. kryen pranimin e kërkesave për ekuivalencë dhe njohje të kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë;

2. kryen kontroll të dokumenteve të dorëzuara;

3. grumbullon informata të nevojshme për ekuivalencën dhe njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë të fituara jashtë vendit dhe i njofton institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë si dhe institucionet arsimore të huaja për të gjitha aspektet nga sfera e ekuivalencës

dhe njohjes së arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë. Qendra informative informatat i dorëzon dhe te të gjitha subjektet dhe personat tjerë të interesuar në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë vendit.

4. në procedurën për ekuivalencën dhe njohjen e kualifikimi të huaj të arsimit të lartë, parashtron kërkesë për verifikimin e vlefshmërisë së dokumentit të huaj të arsimit të lartë, përkatësisht bartësit të saj te institucioni që e ka lëshuar dokumentin dhe

5. kryen kontroll të akreditimit të institucionit të huaj të arsimit të lartë që e ka lëshuar dokumentin e arsimit të lartë për të cilin është parashtruar kërkesë për njohje në pajtim me këtë ligj.

(4) Qendra Informative është pjesë e Rrjetit të Vetëm Evropian të Qendrave Informative/ Qendrave Nacionale Akademike Informative (ENIK / NARIK Rrjet) të formuar nga Këshilli i Evropës, UNESCO dhe Komisioni Evropian.

### **Evidenca për njohjen e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë**

#### **Neni 193**

(1) Për njohjen e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë mbahet evidencë.

(2) Mënyra e mbajtjes së evidencës nga paragrafi (1) të këtij neni me akt të përgjithshëm e përcakton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

(3) Ministria kompetente për arsim të lartë mban regjistër për njohjen e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë, i cili shpallet në ueb faqen e saj.

(4) Formën dhe përmbajtjen e regjistrit nga paragrafi (3) i këtij neni e përcakton ministri kompetent për arsimin e lartë.

(5) Ministri kompetent për arsimin e lartë, së paku një herë gjatë vitit kalendarik, formon komision të përbërë nga tre anëtarë, i cili bën revizion të procedurës të ekuivalencës dhe njohjes së kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë, të numrit të caktuar të lëndëve, sipas zgjedhjes së rastësishme.

### **Rregullorja për ekuivalencë dhe njohje të kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë**

#### **Neni 194**

Kushtet, mënyra dhe procedura për ekuivalencë dhe njohje të kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë, formulari i kërkesës për njohjen e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë, dokumentacioni i nevojshëm që bashkëngjitet ndaj kërkesës për njohje, lartësia e kompensimit, lirimi nga pagesa e kompensimit të shpenzimeve dhe çështje të tjera në lidhje me shpenzimet e procedurës për njohje si dhe kompetenca, përbërja dhe funksionimi i Qendrës Informative për së afërmi rregullohen me Rregulloren për ekuivalencë dhe njohje të kualifikimeve të arsimit të lartë të arritura jashtë vendit (në tekstin e mëtejme: Rregullore për njohje) të cilën e miraton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

#### **Seksioni 2**

### **PROCEDURA PËR NJOHJE TË KUALIFIKIMEVE TË HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË**

#### **Kërkesa për njohje të kualifikimit të huaj të arsimit të lartë**

#### **Neni 195**

(1) Procedura për njohjen e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë, ngritet me parashtrimin e kërkesës për njohjen e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë (në tekstin e mëtejme: kërkesë) nga bartësi i kualifikimit të huaj të arsimit të lartë te Qendra Informative.

(2) Kërkesa për njohjen e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë parashtrohet në formular, përmbajtja e së cilës përcaktohet në Rregulloren për njohje nga neni 194 i këtij ligji.

(3) Pas pranimit të kërkesës, Qendra Informativë drejton kërkesë për verifikimin e vlefshmërisë së dokumentit të huaj të arsimit të lartë, përkatësisht bartësit të tij te institucioni që e ka lëshuar dokumentin dhe e kontrollon akreditimin e institucionit të huaj të arsimit të lartë që e ka lëshuar atë.

(4) Kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni i bashkëngjiten këto dokumente:

1. diplomë origjinale e huaj e arsimit të lartë e vërtetuar me vulë apostil, përkatësisht vulë nga Ministria përkatëse e Punëve të Jashtme për vendet që nuk janë anëtare të Konventës së Hagës në shikim,

2. kopje nga diploma e arsimit të lartë e verifikuar në noter,

3. përkthim nga diploma e huaj e arsimit të lartë në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik, i verifikuar në noter,

4. Certifikatë në origjinal/transkript, përkatësisht shtesë e diplomës në shikim,

5. kopje nga certifikata me nota/transkript, përkatësisht shtesë të diplomës, të verifikuara në noter,

6. përkthim të certifikatës me nota/transkript në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik e verifikuar në noter,

7. plan studimor dhe program në kohëzgjatjen e studimit,

8. punimi i magjistraturës ose disertacioni i doktoraturës në formë të shtypur dhe elektronike (nëse kërkohet njohja e kualifikimi të arsimit të lartë të fituar në ciklin e dytë përkatësisht të tretë të studimeve),

9. librezë për specializim me turnuse të regjistruara (nëse bëhet fjalë për studime nga fusha shkencore e shkencave mjekësore dhe të shëndetësisë),

10. dëshmi se studimet kanë zgjatur së paku tre vjet ( nëse bëhet fjalë për njohje të kualifikimit të arsimit të lartë për studime të doktoraturës) dhe

11. fletëpagesë.

### **Komisioni për vlerësim të kërkesës për njohje të kualifikimit të huaj të arsimit të lartë**

#### Neni 196

(1) Për vlerësim të kërkesës për njohjen e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë, ministri kompetent për punët e arsimit të lartë formon komisione për zona të caktuara, të përbërë nga pesë anëtarë nga profesorët universitarë nga fusha përkatëse (në tekstin e mëtejme: Komisione për Pranim).

(2) Anëtarëve të Komisioneve për Njohje u paguhet kompensim në para të cilin e përcakton ministri përgjegjës për çështje e arsimit të lartë në bazë të pjesëmarrjes në mbledhje dhe vëllimit të punës.

(3) Punët profesionale dhe administrative-teknike të komisioneve nga paragrafi (1) i këtij neni i kryen ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit të lartë.

### **Kriteret për njohjen e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë**

#### Neni 197

(1) Kriteret bazë në bazë të të cilave komisionet për njohje sipas rajoneve të ndara i vlerësojnë kërkesat për njohjen e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë janë:

1. krahasueshmëria dhe ngjashmëria e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë me kualifikimet e arsimit të lartë vendor, përkatësisht harmonizimi me Kornizën Nacionale të Kualifikimeve,

2. vëllimi, lloji, kohëzgjatja dhe shkalla e programit studimor në pajtim me Sistemin Evropian për Transfer të Kredive (SETK),

3. sistemi dhe Korniza Nacionale e kualifikimeve nga e cila rrjedh kualifikimi,

4. statusi i institucionit të huaj të arsimit të lartë që e ka lëshuar kualifikimin, përkatësisht nëse e njëjta është akredituar dhe autorizuar në shtetin amë (ose tjetër) për lëshim të kualifikimeve, përkatësisht diplomave dhe dëftesave,

5. arritjet mësimore (learning outcomes),

6. të drejtat të cilat kualifikimi, përkatësisht diploma ose dëftesa i japin në shtetin amë, dhe

7. praktika e mëparshme, përkatësisht rastet e ngjashme të zgjidhura paraprakisht.

(2) Gjatë vlerësimit të kërkesës për njohjen e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë, merren parasysh dhe përmbajtjet tjera që janë me rëndësi për njohjen e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë.

### **Vlerësimi i kërkesës për njohje të kualifikimit të huaj të arsimit të lartë**

#### Neni 198

(1) Në procedurën për njohjen e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë, komisionet për njohje të formuara sipas rajoneve të ndara, kryejnë krahasim të lëndëve, programeve studimore si dhe shkallëve të arsimit, kushteve për regjistrimin në programin arsimor, të drejtave që diploma, përkatësisht certifikata i jep në vendin ku është lëshuar, të kredive të marra gjatë studimeve në pajtim me Sistemin Evropian të Transferit të Kredive (SETK), si dhe rezultatin e procesit arsimor (learning outcome).

Në rast të pjesës së përfunduar nga programi i studimeve të arsimit të lartë, përcaktohet pjesa e përfunduar e programit të arsimit të lartë dhe njihet i njëjti për shkak të vazhdimit të arsimit të lartë të institucionit të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë.

(2) Komisioni për Njohje pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës për njohje të kualifikimit të huaj të arsimit të lartë përgatit raport, në të cilin jep propozim:

- për njohje të kualifikimit të huaj të arsimit të lartë, ose
- për refuzim të njohjes së kualifikimit të huaj të arsimit të lartë.

(3) Komisioni për Njohje nga zona përkatëse e propozon llojin, shkallën dhe titullin e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë, përkatësisht përdorimin e emrit profesional ose shkencor, përkatësisht titullit ose titullit në Republikën e Maqedonisë në pajtim me dispozitat për kornizë nacionale për kualifikimet e arsimit të lartë dhe propozon ekuivalencë.

(4) Nëse komisioni për njohje nga zona përkatëse përcakton dallime thelbësore në vëllimin, përmbajtjen, kohëzgjatjen ose shkallën e arsimit të lartë të programit studimor të arsimit të lartë të huaj të përfunduar në krahasim me programin studimor (arsimor) vendas, kurse të njëjtat janë të rëndësishme për funksionin e kualifikimit, me propozim të komisionit kërkesa për njohjen e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë do të refuzohet. Në rast të tillë, komisioni është i detyruar të arsyetojë shkaqet për refuzimin e kërkesës për njohjen e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë, kurse veçanërisht vëllimin, llojin dhe thelbin e dallimeve të përcaktuara ndërmjet programit studimor të huaj dhe vendor.

(5) Nëse Komisioni për njohjen nga rajoni përkatës përcakton se nuk është dorëzuar dokumentacioni i plotë nga neni 195 paragrafi 4, e fton parashtruesin e kërkesës së kualifikimit të huaj të arsimit të lartë të plotësojë dokumentacionin në afat prej 30 ditëve.

Nëse, parashtruesi i kërkesës nuk e dorëzon dokumentacionin e plotë në afat prej 30 ditëve, kërkesa për njohjen e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë refuzohet.

(6) Gjatë mbledhjeve të komisioneve nga rajonet dhe sferat e caktuara mbahet procesverbal i cili përmban: vendin dhe kohën, emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të pranishëm të komisioneve, emrin dhe mbiemrin e parashtruesit të kërkesës, lëndën për të cilën veprohet, titujt / tutulat që i propozojnë komisionet te ministri kompetent për çështjet e arsimit të lartë, vërejtjet eventuale në lidhje me kërkesën, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me punën e komisioneve. Procesverbalin e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e komisioneve.

### **Aktvendimi për njohje të kualifikimit të huaj të arsimit të lartë**

#### Neni 199

(1) Ministria kompetente për punët e arsimit të lartë e miraton aktvendimin për njohje, përkatësisht për refuzimin e njohjes së kualifikimit të huaj të arsimit të lartë në afat 60 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për njohjen e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë, me propozim të komisionit për njohje nga zona përkatëse.

(2) Ministria kompetente për punët e arsimit të lartë e miraton aktvendimin për njohje të kualifikimit të arsimit të lartë të huaj në afat prej tetë ditë pune, nëse kualifikimi i arsimit të lartë është fituar në një nga 500 universitetet e para të renditura në listën e fundit të publikuar të këtyre institucioneve: Instituti i Arsimit të Lartë pranë Universitetit të Shangait Xhio Tong, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement –World University Ranking pa propozim të komisionit nga neni 198 paragrafi 2 të këtij ligji.

(3) Aktvendimi për njohje, përkatësisht refuzim të njohjes së një kualifikimi të arsimit të lartë të huaj është përfundimtar dhe jepet në tri kopje, nga të cilat njëra prej kopjeve i dorëzohet kërkuarit, ndërsa dy kopje mbeten në ministrinë kompetente për punët e arsimit të lartë.

(4) Kundër aktvendimit për njohje, përkatësisht refuzim të njohjes të kualifikimit të arsimit të lartë të huaj, mund të parashtrohet padi për gjykatën administrative.

(5) Aktvendimi për njohjen e kualifikimit të arsimit të lartë të huaj do të shfuqizohet nga ministria kompetente për punët e arsimit të lartë në procedurë të veçantë, nëse vërtetohet pavlefshmëri e dokumentit të arsimit të lartë të huaj ose i njëjti është lëshuar nga institucion i arsimit të lartë të huaj që nuk është akredituar në procedurë përkatëse.

### **Diploma ose dokumente tjera të fituara në ish Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe nga universitete të formuara nga organizata ndërkombëtare**

#### Neni 200

(1) Personave që deri më 31 dhjetor të vitit 1996 kanë marrë diplomë ose dokumente tjera për arsim të lartë, studime pasuniversitare dhe doktoraturë shkencore të fituara në territorin e ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, u pranohet përgatitje e lartë profesionale, titull profesional specialist, shkallë akademike magjistër, përkatësisht shkallë shkencore doktor i shkencave dhe për të njëjtën nuk zbatohet procedurë për njohje.

(2) Personave që kanë marrë diplomë ose dokument tjetër për përfundimin e ciklit të parë, të dytë ose të tretë të studimeve në universitete të formuara nga organizatat ndërkombëtare në të cilat Republika e Maqedonisë është anëtare e plotë u pranohet përgatitje e lartë profesionale, titulli profesional specialist, shkalla akademike magjistër, përkatësisht shkalla shkencore doktor shkencash dhe për të njëjtën nuk zbatohet procedurë për njohje.

## Kapitulli katërbëdhjetë

### MBAJTJA E EVIDENCAVE

#### Llojet e evidencave

##### Neni 201

(1) Ministria kompetente për punët e arsimit të lartë, institucionet e arsimit të lartë, Këshilli Nacional për Arsim të Lartë, Agjencia për Kualitet, Këshilli për Akreditim, Këshilli për Evaulim, Konferenca Ndëruniversitare dhe subjektet e tjera kompetente për arsimin e lartë, në pajtim me kompetencat e tyre, mbajnë evidenca përkatëse nëpërmjet mirëmbajtjes së bazave të të dhënave.

(2) Ministria kompetente për punët nga sfera e arsimit të lartë siguron kushte për formimin, sigurimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave.

(3) Mbahen evidenca për:

- institucione të akredituara të arsimit të lartë;
- evidenca në përbërje të universitetit;
- anëtare shoqëruese të universitetit;
- kandidatë për regjistrim të ciklit të parë, dytë dhe tretë për secilin afat të regjistrimit;
- studentët e regjistruar në ciklin e parë, dytë dhe të tretë për secilin afat të regjistrimit;
- studentët e përfunduar në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë;
- mobilitet i studentëve;
- persona të zgjedhur në tituj që janë në marrëdhënie pune;
- persona të zgjedhur në tituj të cilët nuk janë në marrëdhënie pune;
- profesor viziting;
- profesionistë nga praktika;
- profesor emeritus;
- mobilitet të mësimitdhënësve dhe bashkëpunëtorë;
- punë shkencore dhe punë tjetër të mësimitdhënësve dhe bashkëpunëtorëve;
- projekte shkencore-hulumtuese;
- projekte aplikative;
- veprimtari botuese;
- marrëveshje të lidhura ndërkombëtare;
- evidenca tjera në pajtim me të dhënat që i krijojnë subjektet kompetente.

(4) Subjektet kompetente për mbajtjen e evidencave, përmbajtjen e evidencave, mënyrën dhe procedurën për mbledhjen e të dhënave dhe mbajtjen e bazës së të dhënave i përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e arsimit të lartë me Rregullore për mbajtjen e evidencave për arsimin e lartë.

## Kapitulli i pesëmbëdhjetë

### MBIKËQYRJA E PUNËS SË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË

#### Mbikëqyrja e ligjshmërisë në punë

##### Neni 202

(1) Kur ministri kompetent për punët e arsimit të lartë do të përcaktojë se institucioni i arsimit të lartë punon në kundërshtim me këtë Ligj, me procesverbal do t'i sugjerojë institucionit të arsimit të lartë për paligjshmërinë në punë dhe do t'i caktojë afat prej së paku një muaji për largimin e paligjshmërisë.

(2) Nëse institucioni i arsimit të lartë, në afatin e përcaktuar, nuk vepron sipas dëshmimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, ministri kompetent për punët e arsimit të lartë miraton aktvendim për pezullim të përkohshëm të punës së institucionit të arsimit të lartë dhe për të e njofton themeluesin.

(3) Ministri kompetent për punët e arsimit të lartë para se të marrë aktvendim për ndalim të përkohshëm me punë të institucionit të arsimit të lartë, do të kërkojë mendim nga Këshilli për Akreditim.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni mund të parashtrohet ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosije në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë. Ankesa nuk e prolongon realizimin e aktvendimit.

(5) Kundër aktvendimit të Komisionit Shtetëror për Vendosije në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, mund të parashtrohet padi në Gjykatën Administrative.

(6) Pas plotfuqishmërisë së vendimit të Gjykatës Administrative, Ministri përgjegjës për punët e arsimit të lartë miraton aktvendim për shlyerjen e institucionit të arsimit të lartë nga regjistri i institucioneve të arsimit të lartë.

(7) Nëse ministria kompetente për punët e arsimit të lartë nga sfera e arsimit të lartë konstaton se rregullorja, vendimi, aktvendimi ose akti tjetër i Agjencisë për Kualitet, Këshillit për Akreditim dhe Këshillit për Evalvim është në kundërshtim me dispozitat e ligjit, ministri përgjegjës për punët nga sfera e arsimit të lartë miraton aktvendim për shfuqizimin e aktit të Agjencisë për Kualitet, të Këshillit për Akreditim ose të Këshillit për Evalvim dhe vendos procedurë për përgjegjësi të drejtorit të Agjencisë për Kualitet ose të anëtarëve të Këshilleve para organeve kompetente në vend.

### **Vendimi i paligjshëm i institucionit të arsimit të lartë**

#### Neni 203

(1) Kur ministri kompetent për punët e arsimit të lartë përcakton që institucioni i arsimit të lartë ka marrë vendim që nuk është në përputhje me këtë ligj, do t'i sugjeroj institucionit të arsimit të lartë për paligjshmërinë e vendimit dhe do të përcaktojë afat për mënjanimin e paligjshmërisë, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se një muaj.

(2) Nëse në afatin e caktuar institucioni i arsimit të lartë nuk e mënjanon paligjshmërinë, ministri përgjegjës për punët e arsimit të lartë me aktvendimin do ta heqë ose shfuqizojë vendimin e paligjshëm.

(3) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni, institucioni i arsimit të lartë ka të drejtë të ankesës te Komisioni Shtetëror për Vendosije në Procedurën Administrative dhe Procedurën të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (3) i këtij neni institucioni i arsimit të lartë ka të drejtë të parashtrojë padi në Gjykatën Administrative.

### **Mbikëqyrja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme të institucioneve të arsimit të lartë**

#### Neni 204

(1) Nëse akti i përgjithshëm i institucionit të arsimit të lartë nuk është në pajtim me Kushtetutë ose me ligj, ministri kompetent për punët e arsimit të lartë ka të drejtë të ndërpresë realizimin e tyre dhe është i obliguar, në afat prej tetë ditësh nga dita e miratimit të aktvendimit për ndërprerje, të vendosë procedurë për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të ndërprerë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë.

(2) Ministri kompetent për punët e arsimit të lartë, para se të vendosë procedurë për vlerësim të kuhstetutshmërisë dhe ligjshmërisë, mund ta njoftojë institucionin e arsimit të lartë për ndërprerjen e aktit dhe t'i sugjerojë institucionit të arsimit të lartë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit për ndërprerje, të mënjanojë paligjshmërinë.

(3) Nëse institucioni i arsimit të lartë në këtë afat nuk vepron sipas sugjerimit, ministri kompetent për punët e arsimit të lartë, në afatin e ardhshëm prej tetë ditësh nga dita e skadimit të afatit prej 30 ditësh, vendos procedurë për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të ndërprerë.

### **Mbikëqyrja e lëshimit të diplomave**

#### **Neni 205**

Nëse ministri kompetent për punët e arsimit të lartë në realizimin e të drejtës së mbikëqyrjes së ligjshmërisë së punës përcakton se institucioni i arsimit të lartë ka lëshuar diplomë në kundërshtim me dispozitat të këtij ligji, miraton aktvendim për shfuqizim të diplomës që shpallet në mjetet për informim publik dhe parashtron te prokurori publik kallëzim për ndjekje penale të personit përgjegjës.

### **Mbikëqyrja inspektuese**

#### **Neni 206**

(1) Mbikëqyrjen inspektuese në pajtim me këtë Ligj e kryen Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

(2) Inspektorati Shtetëror i Arsimit është i autorizuar:

1. të anulojë regjistrim të studentit në vitin e parë të studimeve nëpërmjet numrit të studentëve të përcaktuar me aktvendim për akreditim dhe konkurs;

2. të anulojë regjistrim të studentit që është kryer në kundërshtim me këtë Ligj;

3. të ndalojë kryerje të veprimtarisë së arsimit të lartë të personit juridik i cili atë veprimtari e kryen në kundërshtim me ligjin dhe prezantohet si institucion i arsimit të lartë;

4. t'i ndalojë kryerje të veprimtarisë së arsimit të lartë themeluesit i cili ka marrë akreditim të projektit për themelim, kurse ende nuk ka marrë aktvendim për fillim me punë dhe nuk është regjistruar në regjistrin e institucionit të arsimit të lartë dhe në Regjistrin Qendror;

5. të ndalojë reklamim ose cilën do formë të informimit publik për mundësinë e personit juridik i cili nuk ka akreditim, aktvendim për fillim dhe nuk është regjistruar në regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë dhe në Regjistrin Qendror.

6. të ndalojë veprimtari të tjera të personave juridikë të cilët kryejnë punë që janë në kundërshtim me këtë Ligj dhe

7. të marrë masa të tjera për të cilat është i autorizuar me këtë Ligj.

(3) Inspektorati shtetëror i arsimit mund të kryejë mbikëqyrje të ligjshmërisë së procedurave për zgjedhje në tituj mësimorë, mësimorë-shkencorë dhe tituj bashkëpunëtorë dhe të plotësimit të kushteve për zgjedhje në titull dhe të ngrit procedurë në gjykatën kompetente më së voni në afat prej 5 vjetësh nga dita kur është kryer zgjedhja.

### **Kapitulli i gjashtëmbëdhjetë**

#### **DISPOZITAT KUNDËRVAJTËSE**

### **Gjoha për kundërvajtje**

#### **Neni 207**

(1) Gjohë në shumë prej 2000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:



- shfrytëzon emërtime të institucioneve të arsimit të lartë, pa qenë i themeluar si institucion i arsimit të lartë, në pajtim me këtë Ligj (neni 15 paragrafi 4),
- zbaton statut për të cilin nuk është marrë pëlqim nga organi kompetent nga neni 16, paragrafi (3),
- nuk kryen vetevalvim të universitetit, fakultetit, akademisë artistike dhe shkollës së lartë profesionale që janë në përbërje të universitetit dhe shkollës së lartë profesionale të pavarur në mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me status të universitetit, fakultetit, akademisë artistike dhe shkollës së lartë profesionale që janë në përbërje të universitetit dhe të shkollës së lartë profesionale të pavarur (neni 55),
- nuk shpallen në uev faqe rezultatet nga vetevalimi në pajtim me nenin 55 paragrafin (6) të këtij ligji,
- e pengon gjatë punës, refuzon që të i'a japë të gjitha të dhënat e nevojshme për rangimin e personit juridik i cili kryen rangimin (neni 58, paragrafi (4)),
- nuk emërohet ushtrues i detyrës dekan në pajtim me nenin 57 paragrafin (2) të këtij ligji.
- kryen ndryshime statutare pa pëlqimin e themeluesit (neni 75, paragrafi (3)),
- nuk formon qendër për karrierë në pajtim me nenin 86 të këtij ligji,
- nuk shpall zgjedhje për kuvendin studentor të fakultetit në pajtim me nenin 37, paragrafin 6 të këtij ligji,
- nuk shpall zgjedhje për kuvendin studentor të shkollës profesionale të lartë në pajtim me nenin 38, paragrafin (8) të këtij ligji,
- arkëton bursë të studimeve, përkatësisht participim të studentëve mbi shumën e përcaktuar me këtë ligj (neni 126),
- zbaton programe studimore pa akreditim, në pajtim me këtë ligj (neni 132 paragrafi 1),
- regjistron student në kundërshtim me nenin 149 paragrafin (2) të këtij ligji,
- gjatë një viti shkollor mësimdhënësi është përcaktuar mentor i më shumë se 12 kandidatëve për përpunimin e punimeve të magjistraturës (neni 135, paragrafi (14)),
- një mësimdhënës është përcaktuar njëkohësisht mentor i më shumë se 3 kandidatëve për përpunimin e punimeve të doktoraturës (neni 136, paragrafi (15)),
- zbaton program studimor me përmbajtje të ndryshme nga ajo që është akredituar në kundërshtim me nenin 139 paragrafët (3), (4) dhe (6) të këtij ligji,
- nuk organizohet realizim i mësimin për programe studimore të gjuhës angleze nga neni 144 paragrafi (7) të këtij ligji,
- institucioni i arsimit të lartë nuk vepron në pajtim me nenin 146 paragrafin (9) të këtij ligji,
  - nuk shpall konkurs për regjistrim të studentëve së paku pesë muaj para fillimit të mësimin ose nëse i njëjti nuk i përmban komponentët e nevojshëm në pajtim me këtë Ligj ose regjistron në vitin e parë të studimeve studentët që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë Ligj dhe me konkurs (neni 149),
- realizon regjistrim të studentëve më shumë se numri i përcaktuar me vendimin për regjistrim të studentëve ose më shumë nga kapaciteti për të cilin institucioni i arsimit të lartë është akredituar (neni 151),
- nuk jep legjitimacion studentor dhe indeks studentor në pajtim me nenin 155 paragrafin (7) të këtij ligji,
- nuk mban evidencë të të dhënave personale të studentëve (neni 158),
- nuk mban libër amë të studentit të regjistruar dhe libër kryesor të studentëve të diplomuar ose nëse i mban në kundërshtim me formën e përcaktuar dhe mënyrën e udhëheqjes dhe përmbajtjen (neni 159),
- personit të zgjedhur në titullin mësimor - shkencor dhe mësimor i lejon të kryejë ligjërata në më shumë se katër lëndë mësimore të ciklit të parë të studimeve në një ose më shumë universitete gjatë një semestri të vitit shkollor (neni 161 paragrafi (9)),

- personit të zgjedhur në titullin mësimit-shkencor dhe mësimit i lejon të kryejë ligjërata në më shumë se katër lëndë mësimore të ciklit të dytë të studimeve në një ose më shumë universitete gjatë një semestri të një viti shkollor (neni 161 paragrafi (10)),

- angazhon mësime të kryejë veprimtari të arsimit të lartë, përkatësisht veprimtari artistike nga institucionet tjetër të arsimit të lartë pa pëlqim të universitetit dhe në kundërshtim me normativat dhe standardet për kryerje të veprimtarisë së arsimit të lartë (neni 179) dhe

- kryen zgjedhje të mësimeve dhe bashkëpunëtorëve në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (nga neni 166 dhe neni 177).

(2) Gjohë në shumë prej 1000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në person juridik për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Personi juridik i cili do të fillojë kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë pa marrjen e aktvendimit për akreditim dhe aktvendim për fillimin me punë, do të dënohet me dënim me para në shumë prej 5.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë me denarë dhe do t'i shqiptohet masë ndalim për ushtrim të veprimtarisë së arsimit të lartë, kurse personi përgjegjës në person juridik do të dënohet me dënim me para në shumë prej 1000 euro në kundërvlerë me denarë (nenet 69 dhe 145, paragrafët (2), (4) dhe (5)).

(4) Gjohë në shumë prej 1000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit nëpunës i autorizuar nga Ministria e cila e menaxhon procedurën, nëse nuk vendos sipas kërkesës në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 199 paragrafi (1) të këtij ligji).

(5) Gjohë në vlerë prej 1000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet anëtarit të komisionit recensues nëse nuk vepron në pajtim me nenin 173 paragrafin (8) të Ligjit për Arsim të Lartë, përkatësisht gjatë zgjedhjes së kandidatit në titull mësimit-shkencor, të jetë i propozuar si kandidat i cili nuk i plotëson kushtet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsim të Lartë ose nuk është i propozuar kandidat i cili i plotëson kushtet për zgjedhje në titull.

(6) Gjohë në shumë prej 1000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të zgjedhur në titull mësimit-shkencor ose titull mësimit për kundërvajtje, nëse kryen ligjërata në më shumë se katër lëndë mësimore nga cikli i parë i studimeve gjatë një semestri të vitit shkollor nënjë ose më shumë universitete (neni 161 paragrafi (9) të këtij ligji).

(7) Gjohë në shumë prej 1000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të zgjedhur në titull mësimit-shkencor ose titull mësimit për kundërvajtje, nëse kryen ligjërata në më shumë se katër lëndë mësimore nga cikli i dytë i studimeve gjatë të njëjtë semestër të vitit shkollor në një ose të më shumë universitete (neni 161 paragrafi (10) të këtij ligji).

(8) Gjohë në shumë prej 1000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet Drejtorit të Agjencisë për Kualitet nëse në uev faqe të agjencisë:

- nuk e shpall raportin nga neni 48 paragrafi (4),  
- nuk i shpall aktvendimet për akreditim në institucionet e arsimit të lartë nga neni 49 paragrafi (9),

- nuk i shpall raportet nga evaulimi i jashtëm nga neni 51 paragrafi (7),

- nuk e shpall raportin e Këshillit për Evalvim nga neni 53 paragrafi 2 ose

- nuk e shpall raportin dhe aktvendimin për akreditim të programit studimor në pajtim me nenin 145 paragrafi (6) të këtij ligji.

### **Procedura kundërvajtëse**

#### Neni 208

(1) Procedurë kundërvajtëse për kundërvajtjet e parapara në këtë ligj e udhëheq dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

(2) Para parashtrimin të kërkesës për vendosjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtjet e parapara me këtë ligj, ministria kompetente për punët e arsimit të lartë mban procedurë për barazim në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

## Kapitulli shtatëmbëdhjetë

### DISPOZITA KALIMTARE DHE PTË FUNDIT

#### Vazhdimi i punës

##### Neni 209

(1) Institucionet e arsimit të lartë të themeluara dhe akredituara sipas Ligjit për arsim të lartë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 127/2016) vazhdojnë të punojnë në pajtim me akreditimin e dhënë dhe aktvendimin për fillim me punë.

(2) Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë, i themeluar në pajtim me dispozitat e deritanishme për arsim të lartë, vazhdon punën si institucion privat-publik i arsimit të lartë.

(3) Ky ligj në mënyrë përkatëse zbatohet edhe për universitetin nga sfera e mbrojtjes dhe sigurisë, nëse me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

(4) Akreditimi i programeve studimore të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, vlejnë për periudhën për të cilën janë lëshuar.

(5) Këshilli për Evalvim zbaton Evalvim të të gjitha institucioneve të arsimit të lartë dhe programe studimore në afat prej 18 muajsh nga themelimi i tij.

#### Formimi i Këshillit nacional për arsim të lartë

##### Neni 210

(1) Këshilli nacional për arsim të lartë do të formohet në afat prej 1 viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Këshilli nacional për arsim të lartë do t’i miratojë aktet e parapara me këtë ligj më së voni në afat prej gjashtë muajsh nga dita e formimit të tij.

(3) Mbledhjen konstituive e Këshillit Nacional e cakton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë në afat prej 15 ditësh nga zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Nacional nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

#### Formimi i Agjencisë për Kualitet

##### Neni 211

(1) Agjencia për kualitet do të formohet në afat prej 1 viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Aktet e parapara me këtë ligj, Agjencia për Kualitet do t’i miratojë në afat prej 3 muajsh nga dita e formimit të saj.

(3) Deri në formimin e Agjencisë për Kualitet në pajtim me këtë ligj, kompetencat e saj kryhen në pajtim me Ligjin për arsim të lartë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 127/2016).

### **Formimi i Këshillit për Akreditim**

#### Neni 212

(1) Këshilli për Akreditim do të formohet në afat prej 1 viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Aktet e parapara me këtë ligj, Këshilli për Akreditim do t'i miratojë në afat prej 3 muajsh nga dita e formimit të tij.

(3) Deri në formimin e Këshillit për Akreditim në pajtim me këtë ligj, Këshilli për Akreditim dhe Evalvim në arsimin e lartë i formuar sipas Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16, 120/16 dhe 127/2016), vazhdon me punë, me çka do t'i zbatojë dispozitat për akreditim të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve studimore të këtij ligji.

(4) Mbledhjen konstituive të Këshillit për Akreditim e cakton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë në afat prej 15 ditësh nga dita e zgjedhjes përkatësisht emërimi i anëtarëve të tij në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

### **Formimi i Këshillit për Evalvim**

#### Neni 213

(1) Këshilli për Evalvim do të formohet në afat prej 1 viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Aktet e parapara me këtë ligj, Këshilli për Evalvim do t'i miratojë në afat prej 3 muajsh nga dita e formimit të tij.

(3) Deri në formimin e Këshillit për Evalvim sipas dispozitave të këtij ligji, punët e evalvimit në arsimin e lartë do t'i kryejë Këshilli për Akreditim dhe Evalvim në arsimin e lartë, i formuar sipas Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 127/2016), me çka do t'i zbatojë dispozitat për Evalvim të institucioneve të arsimit të lartë dhe programet studimore të këtij ligji.

(4) Mbledhjen konstituive të Këshillit për Evalvim e cakton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë në afat prej 15 ditësh nga dita e zgjedhjes përkatësisht emërimi i anëtarëve të tij në pajtim me dispozitat e këtij Ligji.

### **Harmonizim i akteve të përgjithshme të institucioneve të arsimit të lartë me këtë ligj**

#### Neni 214

(1) Universitetet ekzistuese dhe njësitë në përbërjen e tyre dhe institucionet e pavarura të arsimit të lartë të regjistruara në Regjistrin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Maqedonisë në afat prej 3 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji do të harmonizojnë punën e tyre, do t'i miratojnë statutet dhe aktet tjera të përgjithshme të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Statutet dhe aktet tjera të përgjithshme të institucioneve të arsimit të lartë të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohen pas skadimit të afatit për harmonizim me dispozitat e këtij ligji, në afatin e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Deri në miratimin e statuteve dhe akteve tjera të përgjithshme nga paragrafi (1) i këtij neni, përkatësisht deri në skadimin e afatit për miratimin e tyre, do të zbatohen aktet e përgjithshme ekzistuese.

### **Procedura për themelimin e institucionit të arsimit të lartë**

Neni 215

Procedura për themelimin e institucionit të arsimit të lartë e cila ka filluar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojë sipas dispozitave të ligjit sipas të cilit e njëjta ka filluar.

### **Procedura për akreditim të programeve studimore dhe dhënie të aktvendimeve për fillim me punë**

Neni 216

Procedura për akreditim të programeve studimore dhe për dhënie të aktvendimit për fillim me punë, e filluar deri në miratimin dhe hyrjen në fuqi të akteve të përcaktuara me këtë Ligj, do të përfundojë sipas dispozitave të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" n numër 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 127/2016).

### **Kushte sipas të cilave do të vazhdojë zgjedhja në titull**

Neni 217

(1) Zgjedhja në titullin mësimor-shkencor, shkencor, mësimor dhe bashkëpunëtor e filluar para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojë sipas dispozitave të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 127/2016).

(2) Deri në miratimin e akteve të përgjithshme të institucioneve të arsimit të lartë të përcaktuara me këtë Ligj që kanë të bëjnë me kushtet, procedurën dhe kriteret për zgjedhje të titullit mësimor-shkencor, shkencor, mësimor dhe bashkëpunëtor, zgjedhja në këto tituj do të kryhen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të përgjithshme që kanë qenë në fuqi në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me çka dispozitat e akteve të përgjithshme të institucioneve të arsimit të lartë që janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, nuk do të zbatohen.

### **Profesorë ordinarë dhe këshilltarë shkencorë të zgjedhur në njësi në përbërje të universitetit dhe profesorë të shkollave të larta profesionale**

Neni 218

(1) Profesorët ordinarë dhe këshilltarët shkencor të zgjedhur në njësitë në përbërje të universitetit të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë zgjedhur në atë titull për herë të parë, themelojnë marrëdhënie pune në kohë të papërcaktuar dhe mbajnë titullin e tyre profesor ordinar, përkatësisht këshilltar shkencor përjetësisht.

(2) Profesorët e shkollave të larta të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë zgjedhur në atë titull për herë të parë, themelojnë marrëdhënie pune në kohë të papërcaktuar dhe mbajnë titullin e tyre profesor përjetësisht.

### **Bashkëpunëtorët**

Neni 219

Bashkëpunëtorët e punësuar në institucionet e arsimit të lartë deri në ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008), nëse deri më 15 shtator të vitit 2020 nuk zgjidhen në titull

shkencor-mësimor, shkencor ose mësimor u ndërpritet marrëdhënia e punës, ndërkaq deri atëherë për ata zbatohen dispozitat e Ligjit për arsim të lartë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 35/2008).

### **Asistentë doktorantë**

#### **Neni 220**

Asistentët doktorantë të zgjedhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të punojnë si asistentë doktorantë për periudhën për të cilën janë zgjedhur.

### **Rektori, prorektori, dekani, prodekani, anëtari i senatit, përkatësisht drejtori dhe zëvendësrejtori në shkollë të lartë profesionale i zgjedhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji**

#### **Neni 221**

(1) Rektori, prorektori, dekani, prodekani, anëtari i senatit, përkatësisht drejtori dhe zëvendësrejtori i shkollës së lartë profesionale të zgjedhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë t’i kryejnë funksionet e tyre deri në skadimin e periudhës për të cilën janë zgjedhur.

(2) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni, të cilët janë të zgjedhur në funksionet e tyre për herë të parë në pajtim me Ligjin për arsim të lartë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 127/2016), kanë të drejtë për edhe një mandat sipas këtij ligji.

(3) Rektori, prorektori, dekani, prodekani, anëtari i senatit, përkatësisht drejtori dhe zëvendësrejtori i shkollës së lartë profesionale të zgjedhur në funksionet e tyre në dy mandate para hyrjes në fuqi të këtij ligji sipas dispozitave të cilat kanë qenë të vlefshme para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kanë të drejtë për edhe një mandat sipas këtij ligji.

(4) Zgjedhja e rektorit, prorektorit, dekanit, prodekanit, anëtarit të senatit, përkatësisht drejtorit dhe zëvendësit të drejtorit të shkollës së lartë profesionale të zgjedhur, e filluar para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të mbarojë sipas dispozitave të Ligjit për arsimin e lartë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 127/2016) dhe dispozitat e akteve të përgjithshme të institucioneve të arsimit të lartë sipas të cilit ka filluar.

### **Zgjedhja dhe mandati i kuvendeve studentore dhe përfaqësuesve të studentëve**

#### **Neni 222**

(1) Në afat prej 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji mbahen zgjedhje për përfaqësues në kuvendet studentore dhe kryetarë të kuvendeve studentore.

(2) Kuvendet studentore në afat prej 30 ditëve nga konstituimi zgjedhin përfaqësues në organet për të cilat kjo është paraparë me këtë ligj.

(3) Prona dhe mjetet e organizatave studentore të formuara në pajtim me Ligjin për arsim të lartë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 127/2016), kalojnë në kuvendet përkatëse studentore.

(4) Në afat prej 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji zgjidhen avokati studentor dhe zëvendësavokati studentor.

(5) Mandati i organeve studentore që janë zgjedhur në afatet e këtij neni mund të zgjasë më pak ose më shumë se një vit, por jo më tepër se 18 muaj, varësisht nga termini i caktuar në statutin e kuvendit studentor si periudhë për mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta për organet studentore.

### **Njohja e kualifikimeve të arsimit të lartë të fituara jashtë shtetit**

#### **Neni 223**

Procedura për njohjen e arsimit të lartë të fituar jashtë shtetit që është filluar para miratimit të këtij ligji, do të mbarojë sipas dispozitave të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16, 120/16 dhe 127/2016).

### **Zgjedhja në titull shkencor-arsimor profesor ordinar**

#### **Neni 224**

Dispozita nga neni 166 paragrafi (3) pika 5 të këtij ligji, do të zbatohet pas skadimit të tre viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Akreditimi i mentorëve të studimeve të doktoraturës**

#### **Neni 225**

Akreditimet e mentorëve të studimeve të doktoraturës të pranuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të vlejné edhe pas hyrjes së tij në fuqi.

### **Shfuqizimi**

#### **Neni 226**

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16, 120/16 dhe 127/2016), përveç atyre dispozitave të cilat, në pajtim me këtë ligj, zbatohen dhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kurse deri në skadimin e afateve të parapara me këtë ligj.

### **Vazhdimi i vlefshmërisë së akteve nënligjore**

#### **Neni 227**

Deri në miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të zbatohen aktet nënligjore ekzistuese të miratuara sipas Ligjit për arsimin e lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16, 120/16 dhe 127/2016), me çka dispozitat që janë në kundërshtim me dispozitat të këtij ligji, nuk do të zbatohen.

### **Hyrja në fuqi e ligjit**

#### **Neni 228**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.